



RAPORTI VJETOR

PËR REVIZIONET E KRYERA
DHE PUNËN E ENTIT
SHTETËROR PËR REVIZION

PËR
VITIN
2020

R A P O R T I
V J E T O R

PËR REVIZIONET E KRYERA
DHE PUNËN E ENTIT
SHTETËROR PËR REVIZION

PËR
VITIN
2020

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

657.6(497.7)»2020»(047.31)

RAPORTI vjetor për revizionet e kryera dhe punën e Entit shtetëror
për revizion për vitin 2020. - Shkup : Enti shtetëror i revizionit,
2021. - [161] стр. : илустр. ; 30 см

ISBN 978-9989-2030-8-4

а) Државен завод за ревизија (Скопје) -- 2020 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 54201605

P ë r m b a j t j a

1 PËR ENTIN SHETËROR PËR REVIZION	9
2 MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E ESHR-së	11
3 DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE METODOLOGJIKE	13
3.1 DOKUMENTET STRATEGJIKE	13
3.2 DOKUMENTET METODOLOGJIKE	16
3.3 AKTIVITETET E PROJEKTEVE	17
4 KAPACITETET ADMINISTRATIVE	21
4.1 STRUKTURA E ORGANIZIMIT DHE BURIMET NJERZORE	21
4.2 RRYTJA E NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË REVIZORËVE SHETËROR	23
4.3 BURIMET E TI-së	24
4.4 MJETET FINANCIARE PËR PUNËN E ESHR-së	26
5 KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI	29
5.1 KOMUNIKIMI, TRANSPARENCA NË PUNËN E ESHR-së	29
5.2 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET DHE ASOCIOCIONE PROFESIONALE	33
5.3 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	35
5.4 BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET PREJ TYRE	39

6 AKTIVITETET E REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE **43**

6.1 VLERA E SHUAR E REVIZIONEVE	48
6.2 REKOMANDIMET DHE IMPLEMENTIMI I TYRE	50

7 REVIZIONET E KRYERA **55**

7.1 BUXHETI THEMELOR I RMV-së PËR VITIN 2019	55
7.2 DREJTËSIA	62
7.2.1 GJYKATA KUSHTETUESE	62
7.2.2 GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	64
7.2.3 PROKURORIA PUBLIKE PËR NDJEKJEN E VEPRAVE PENALE TË LIDHURA DHE QË RRJEDHIN NGA PËRMBAJTJA E PËRGJIMEVE TË PALIGJSHËM TË KOMUNIKIMEVE	65
7.2.4 DREJTORIA PËR UDHËHEQJEN E LIBRAVE AMË	66
7.3 SHËNDETËSIA	67
7.3.1 FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I RMV-së	67
7.3.2 INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE	70
7.4 EFEKTET NGA PANDEMIA KOVID-19	71
7.4.1 NDAJJA E MARRËVESHJEVE PËR FURNIZIMET PUBLIKE NGA ANA E INSTITUCIONEVE NË SEKTORIN PUBLIK ME QËLLIM PARANDALIMI DHE MBROJTJEN NGA PANDEMIA TË SHKAKTUAR NGA VIRUSI KORONA – COVID 19	71
7.4.2 MARRJA E NDIHMËS JO FINANCIARE, SHPËRNDARJA DHE SHFRYTËZIMI NGA ANA E INSTITUCIONEVE NË SEKTORIN PUBLIK ME QËLLIM PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA PANDEMIA TË SHKAKTUAR NGA VIRUSI KORONA – KOVID 19	72
7.5 PUNË DHE SOCIALE	75
7.5.1 FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I RMV-së	75
7.5.2 PLANIFIKIMI QEVERITAR – EFIKASITETI I MASAVE QEVERITARE PËR TU PËRBALLUR ME RREZIQET E TREGUT TË PUNËS DHE MËNYRËN E PLANIFIKIMIT TË MJETEVE PËR TEJKAJIMIN E TYRE – REVIZIONI PARALEL NDËRKOMBËTAR	78
7.6 ARSIMI	83
7.6.1 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS	83
7.6.2 BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT	85
7.6.3 ARSIMI I LARTË	85
7.6.4 KONVIKTI STUDENTOR SHTETËROR „TOME STEFANOVIQ SENIQ” – SHKUP	86
7.7 MJEDISI JETËSOR	87

7.71	EFIKASITETI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE PËR SHRYTËZIMIN E LËNDËVE MINERALE DHE PAGESA E KOMPENSIMEVE	87
7.72	TRAJTIMI DHE PËRBALLIMI EFIKAS ME MBETURINAT PLASTIKE	89
7.73	EFIKASITETI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE PËR LËSHIMIN E B-LEJEVE INTEGRUESE	92
7.74	REVIZIONI I MASAVE TË NDËRMARRA (FOLLOW UP), PAS REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA RAPORTI PËRFUNDIMTAR PËR REVIZIONI E SUKSESIT PREJ 12.03.2019, ME TEMË "EFEKTIVITETI I POLITIKAVE, MASAVE DHE AKTIVITETEVE GJATË NDARJES TË SË DREJTËS SË UJIT"	94
7.75	REVIZIONI I MASAVE TË NDËRMARRA (FOLLOW UP), PAS REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA RAPORTI PËRFUNDIMTAR ME TEMË „CILËSIA E AJRIT – REVIZIONI KOOPERATIV"	96
7.8	KULTUR	98
7.8.1	MINISTRIA E KULTURËS	98
7.8.2	DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TRASHIGIMISË KULTURORE	100
7.9	KOMUNIKACIONI, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIME	102
7.9.1	AGJENCIA PËR KOMUNIKIM ELEKTRONIK	102
7.10	VETËQEVERISJE LOKALE	103
7.10.1	NJËSITË E VETËQEVERISË LOKALE	103
7.10.2	TRANSFERET KAPITALE DREJT NJVL NGA BUXHETI I RMV-së	105
7.10.3	EFIKASITETI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE NË FUNKSIONIN E REALIZIMIT TË KOMPETENCEVE BARTËSE TË CILAT FINANCOHEN ME MJETET NGA BLOK DOTACIONET	107
7.10.4	ZBATIMI I LIGJIT PËR VEPRIM ME OBJKTET E NDËRTUARA PALEJE NË KOMUNAT E OHRIT DHE STRUGËS	108
7.10.5	CILËSIA E SHËRBIMEVE QË I OFRON NJVL NËPËRMJET VEB PORTALEVE TË VETA	110
7.11	SHOQËRITË AKSIONARE DHE NDËRMARRJET PUBLIKE TË THEMELUAR NGA NJVL DHE SHTETI	112
7.11.1	NDËRMARRJET PUBLIKE TË THEMELUAR NGA NJVL	112
7.11.2	SHOQËRITË AKSIONARE TË THEMELUAR NGA SHTETI	113
7.12	MBIKQYRJE INSPEKTUESE	114
7.12.1	KAPACITETET INSTITUCIONALE TË INSPEKTORËVE NË RMV	114
7.13	PARTIT POLITIKE DHE FUSHATAT ZGJEDHORE	116
7.13.1	KOMISIONI SHTETËROR ZGJEDHOR	116
7.13.2	PARTITË POLITIKE – PUNA E RREGULLT	117
7.13.3	PARTIT POLITIKE – FUSHAT ZGJEDHORE	118

8 DOBËSITË E SISTEMIT **123**

9 RAPORTET FINANCIARE **141**

Të nderuar,

Viti i kaluar ishte një vit i mbushur me sfida dhe vështirësi në punën e shkaktuar nga pandemia globale, por mund të themi me kënaqësi se Enti Shtetëror i Revizionit arriti të realizonte Programin Vjetor të punës së vitit 2020. Para jush është Raporti Vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2020, në të cilën janë përfshirë gjetjet dhe rekomandimet tona nga 82

raportet e revizionit, përmes të cilave ju ofruam informacione objektive mbi punën e subjekteve të reviduara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Punonjësit në Entin Shtetëror të Revizionit karakterizohen nga vlerat themelore të profesionalizmit, përgjegjësisë dhe besueshmërisë, paanësisë, pavarësisë, ndërgjegjes, etikës dhe punës në ekip dhe në këtë mënyrë kontribuojnë drejtpërdrejt për cilësinë e punës së institucionit tonë. Prandaj, roli i secilit punonjës është i rëndësishëm për punën e suksesshme të Entit Shtetëror të Revizionit.

Në atë drejtim, në vitin 2020 kemi investuar në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit dhe përmirësimin e proceseve të revizionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe në azhurnimin e aftësive profesionale të revizorëve tanë. Pikërisht këto vlera janë parakusht për kryerjen e detyrave të Entit Shtetëror të Revizionit në mënyrë që do t'i sigurojë Kuvendit të RMV-së dhe palëve të tjera të interesuara besim dhe siguri se raportet për revizionet e kryera dhe raportin vjetor në tërësi, përmbajnë informacion të saktë, objektiv dhe të bazuar në fakte, gjetje dhe rekomandime.

Duke pasur parasysh përgjegjësinë e madhe në drejtim të garantimit të vazhdueshëm për nivelin më të lartë të cilësisë së raporteve të revizionit, detyra kryesore e Entit Shtetëror të Revizionit do të mbeten gjetjet e revizionit të jenë të dukshme për publikun e gjerë, ndërsa rekomandimet e dhëna të kenë



efekte pozitive mbi punën e subjekteve në sektorin publik. Ne punojmë çdo ditë për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë në përdorimin e fondeve publike, gjegjësisht përdorimin e fondeve të taksapaguesve, me qëllim që mediat dhe qytetarët të jenë aleatët tanë në realizimin e qëllimeve tona strategjike.

Enti Shtetëror i Revizionit si Institucion Suprem i Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është anëtare e organizatës evropiane dhe ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit, dhe gjithashtu bashkëpunon me organizatat e tjera të rëndësishme ndërkombëtare, si rezultat i së cilës një vëllim i konsiderueshëm i aktiviteteve në vitin 2020 janë zbatuar ndërkombëtarisht.

Duke mbështetur "Agjendën 2030" të Kombeve të Bashkuara, Enti Shtetëror i Revizionit në vitin 2020 zbatoi revizionin e suksesit dhe kontribuoi në plotësimin e objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm, në veçanti Qëllimi numër 4 Arsimi Cilësor dhe Qëllimi numër 6 Uji i Pastër dhe Kanalizimi dhe e dha kontributin e tij në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Në periudhën e ardhshme, ne do të vazhdojmë me përkushtim në përpjekjet për pavarësi kushtetuese dhe pavarësi të plotë financiare dhe operacionale të Entit Shtetëror të Revizionit, do ta vazhdojmë procesin e ruajtjes së besimit, njohjen e punës së ESHR-së dhe mbrojtjen e fondeve të taksapaguesve.

Revizori kryesor shtetëror
mr. Maksim Acevski





1 PËR ENTIN SHTETËROR PËR REVIZION

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është Institucion Suprem i Pavarur i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila më shumë se 20 vite i informon institucionet kompetente dhe publikun në mënyrë transparente, në kohë dhe në mënyrë objektive për gjetjet e revizorëve nga revizionet e kryera. Enti Shtetëror i Revizionit është themeluar në vitin 1997 me miratimin e Ligjit për revizion shtetëror. Revizionet e para janë kryer në vitin 1999.

Si institucion suprem i revizionit, ESHR revizionet i kryen në përputhje me standardet e revizionit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI), ku kualifikimet e larta profesionale dhe trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve janë baza e punës.

Pavarësia e institucionit është përcaktuar me Ligjin për revizion shtetëror, në të cilin janë rregulluar kompetencat e ESHR-së, është përcaktuar mandati i gjerë në kryerjen e revizioneve të rregullshmërisë dhe të suksesit, me qasje në të gjitha informacionet e nevojshme, dokumentacionet, evidencat për zbatimin e revizionit shtetëror. ESHR në mënyrë të pavarur e përcakton Programin Vjetor të Punës, në mënyrë objektive vendos për subjektet lëndë të revizionit dhe mënyrën, përmbajtjen e njoftimit nga revizionet e kryera, pa anshëm dhe i lirë nga ndikimet e pushteti legjislativ dhe ekzekutiv.

Në të njëjtën kohë, Enti Shtetëror i Revizionit, si dhe institucionet e tjera supreme të revizionit kanë rol të rëndësishëm në luftën për parandalimin e korrupsionit dhe me punën e saj është përfshirë në aktivitete të lidhur me këtë fushë, e cila kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjeteve dhe pronës publike nga aktivitetet të paautorizuar dhe të paligjshëm.

Enti Shtetëror i Revizionit është i njohur sipas vlerave të cilat janë vendosur në institucion, të cilat i kultivon dhe i plotëson dhe si vijon:



aftësi profesionale,



kryerjen e detyrave të punës me përgjegjësi,



puna në ekip, etikë profesionale dhe ndërgjegjes,



integritet, dhe



pavarësia e revizorëve të autorizuar shtetëror dhe revizorëve shtetëror në lidhje me subjektet e revizionit, institucioneve shtetërore dhe shfrytëzuesve tjerë të mjeteve publike.



2 MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E ESHR-së

M I S I O N I

Enti Shtetëror i Revizionit është Institucioni Suprem i Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili synon të informojë me kohë dhe në mënyrë objektive Kuvendin, Qeverinë, bartësit tjerë të funksioneve publike dhe publikun për gjetjet revizorëve nga revizionet e zbatuara. ESHR siguron mbështetjen e Kuvendit të RMV-së në përbushjen e kompetencave të saj përmes identifikimit dhe paraqitjes së parregullsive, rasteve të punës të paligjshme dhe rasteve të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimit të funksionit. Përmes rekomandimeve të qarta dhe efektive, ESHR-ja siguron mbështetjen e institucioneve shtetërore dhe shfrytëzuesit e mjeteve publike për avancimin menaxhimit të tyre. Në këtë mënyrë, ESHR kontribuon në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V i z i o n i

Për ta përbushur me sukses qëllimin tonë – mbajtjen e përgjegjësisë për mjetet publike dhe të kontribuojmë për avancimin e menaxhimit me to, vizioni jonë është që duhet të sigurojmë vazhdimisht cilësi në punën tonë me të cilën do të ruajmë epitetin e një partneri të pavarur dhe profesional me integritet të lartë ku në të njëjtën kohë është bartës i progresit në menaxhimin me mjetet publike, llogaridhënies dhe transparencës në shfrytëzimin e tyre.



O b j e k t i v a t :


Duke i pasur parasysht kompetencat ligjore të ESHR-së, aktet nënligjore dhe dokumentet strategjike, në drejtim të realizimit të misionit dhe vizionit të ESHR-së janë përcaktuar objektivat në vijim:

- ✗ sigurimi i pavarësisë së revizionit shtetëror si kategori kushtetues, në pajtim me principet e Deklaratës së Meksikës;
- ✗ arritjen e numrit të përshtatshëm të punësuarve dhe harmonizimin e strukturës organizativ dhe numrit të përgjithshëm të zbatuesve me kompetenca dhe objektiva strategjike të ESHR-së;
- ✗ avancimin e etikës dhe integritetit;
- ✗ ngritje e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së kryerjes së revizionit në pajtim me standardet e revizorit dhe praktikat metodologjike të revizionit shtetëror;
- ✗ përditësimi i akteve metodologjike për revizionin, si dhe përgatitjen e Drejtimeve për revizion të Buxhetit të RMV-së;
- ✗ implementimi i vazhdueshëm i sistemit elektronik për menaxhim të revizionit - Audit Management System – AMS (AMS);
- ✗ do të vazhdon praktika për sigurimin e cilësisë së revizionit, përmes zgjedhjes së revizionit të cilët do të jenë lëndë e kontrollit, me qëllim që të përmirësohet cilësia e punës;
- ✗ ndërtimin e bashkëpunimit me institucionet kompetente (thelloj) në luftë kundër korrupsionit dhe konflikt të interesit.

3 DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE METODOLOGJIKE

3.1 DOKUMENTET STRATEGJIKE

Zhvillimi strategjik i çdo organizate kërkon vizion për të ardhmen e dëshiruar dhe hartimin e planit për ta bërë atë vizion realitet. Prandaj, zhvillimi i dokumenteve strategjike është një nga hapat kryesorë në zhvillimin e ISR-së dhe realizimin e vizionit, misionit dhe objektivave të tij. Në Raportin Vjetor të Progresit të RMV-së së Komisionit Evropian në lidhje me zonën e revizionit të jashtëm, i cili është nën kompetencën e ESHR-së, vuri në dukje aspektet që kanë nevojë për përmirësim, ndërsa në lidhje me:



Duke vepruar në përputhje me rekomandimet e dhëna dhe duke ndërmarrë aktivitete në drejtim të qëllimeve të përcaktuara, ESHR-ja miratoi dokumentet strategjike si vijon:

Strategjia për zhvillimin e ESHR-së 2018 - 2022



Në Strategjinë për zhvillimin e ESHR-së 2018-2022, përshkruhen përpjekjet për të promovuar dhe përmirësuar implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (ISSAI), për të forcuar pavarësinë dhe integritetin që janë parakushtet për arritjen e profesionalizmit dhe besueshmërisë në punë, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të efekteve të revizioneve të kryera dhe shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të përfshira në raportet e revizionit nga ana e subjekteve të reviduara. Qëllimet strategjike u morën parasysht gjatë përgatitjes së Programit Vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2020, për realizimin e të cilit raportojmë në këtë Raport Vjetor.

Strategjia e TI-së së ESHR-së 2018 - 2022



Në vitin 2020, u zbatuan aktivitetet për realizimin e Strategjisë së TI-së së ESHR-së 2018-2022, me qëllim që të rritet efikasiteti i sistemit të informacionit të ESHR-së dhe njëherazi të kontribuojë në implementimin e strategjisë për zhvillimin e ESHR-së 2018-2022.

Strategjia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore 2020 - 2023



Për realizimin e Strategjisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në ESHR 2020-2023, janë ndërmarrë aktivitete për vendosjen e funksionit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ESHR, me të cilin do të sigurohen kushtet për punësimin e personave profesionistë dhe cilësorë me një shkallë të lartë të integritetit, të cilët janë të gatshëm për të kryer në mënyrë efektive funksionet dhe kompetencat e caktuara.

Strategjia e Komunikimit e ESHR-së 2020 - 2023



Në bazë të Strategjisë së Komunikimit të ESHR-së për 2020-2023 të miratuar në mes të shkurtit 2020, ESHR në 2020 ndërmori disa aktivitete me qëllim për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, përfshirë edhe aktivitetet në kuadër të një projekti të financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, ndërsa e zbatuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD), e cila përqendrohet në komunikimet e ESHR-së me mediat dhe gazetarët.

Strategjia për Menaxhim me Rreziqet e ESHR-së 2020-2023

Me Strategjinë për Menaxhim me Rreziqet e ESHR-së rregullohen procedurat dhe aktivitetet për menaxhimin me rreziqet e konstatuar që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave dhe punën e suksesshme të ESHR-së.



Udhëzimi për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve

Udhëzimi për planifikimin strategjik dhe vjetor të revizioneve u përgatit dhe u miratua në vitin 2020 në bazë të rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm të procesit të planifikimit strategjik dhe vjetor të revizioneve të dhëna nga ekspertët në projektin e mëparshëm të Tvingut.

Udhëzimi ishte baza për përgatitjen e **Vendimit për vendosjen e objektivave strategjike për revizionet e ESHR-së për periudhën 2021 - 2023 dhe për fushat prioritare për revizionet e sektorëve që kryejnë**, si dhe për përgatitjen e **Planit strategjik për revizion të ESHR-së për periudhën 2021 - 2023** të miratuar në dhjetor 2020. Në bazë të dokumenteve strategjike të përmendura më parë për revizionet, u përgatit Programi Vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2021.



Plani i veprimit për vitin 2020 për zbatimin e programit për reformën e menaxhimit me financat publike 2018 - 2021

Në përputhje me Planin e Veprimit për vitin 2020 për zbatimin e programit për reformën e menaxhimit me financat publike, janë zbatuar aktivitetet që janë në lidhje me prioritetin 7: Kontrolli i jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare, e cila është në kompetencat e Entit Shtetëror të Revizionit. Qëllimi i këtij prioriteti është forcimi i menaxhimit me financat publike nëpërmjet sigurimit të llogaridhënies në përdorimin e mjeteve publike nëpërmjet forcimit të revizioneve të rregullshmërisë dhe të suksesit të ESHR-së në përputhje me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të revizionit dhe dokumenteve strategjike të ESHR-së, duke vendosur mekanizëm për rishikimin e rolit proaktiv të raporteve të revizorit në Kuvendin e RMV-së dhe forcimin e kapacitetit institucional dhe kapacitetit të burimeve njerëzore në ESHR. Kryerevizori shtetëror, në mënyrë aktive mori pjesë në punën e Këshillit për Menaxhimin me Financat Publike, i cili paraqet trup koordinues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për të monitoruar zbatimin e reformave për menaxhimin me financat publike të paraparë me programin për reformat e menaxhimit me financat publike 2018 - 2021.



3.2 DOKUMENTET METODOLOGJIKE

U përmirësuan aspektet e rëndësishme të procesit të revizionit me miratimin e akteve në vijim:

RREGULLORJA E RE PËR MËNYRËN E KRYERJES SË REVIZIONIT SHETËTOR („GAZETA ZYRTARE E RMV-SË», NR. 264 PREJ 05.11.2020)

e rregullon kryerjen e revizionit shtetëror (planifikimin, kryerjen, njoftimin për kryerjen e revizionit dhe ndjekjen e masave të ndërmarra pas rekomandimeve të dhëna të përfshira në raportin përfundimtar të revizorit të autorizuar shtetëror), në lidhje me pajtueshmërinë e akteve metodologjike me Kornizën e publikimeve profesionale të INTOSAI-të dhe Kodit për sjellje dhe punë etike të Entit Shtetëror të Revizionit;

PROCEDURA PËR MËNYRËN E PUNËS SË TRUPIT PROFESIONAL NË ESHR

të miratuar në mars të 2020 dhe e përgatitur në përputhje me rekomandimet nga Tving projektit i mëparshëm;

PROGRAM PËR REVIZION TË FURNIZIMEVE PUBLIKE

e përgatitur në përputhje me Ligjin e ri për furnizime publike dhe miratuar në mars të 2020, duke siguruar përditësimin e udhëzimeve dhe mjeteve metodologjike për revizorët gjatë kryerjes së këtij aspekti të rëndësishëm të revizioneve;

DORACAKU PËR REVIZIONIN E RREGULLSHMËRISË

u ndryshua dhe u plotësua në dhjetor të 2020, me qëllim të zbatohen rekomandimet prej tvinging projektit të mëparshëm për implementimin e standardeve ISSAI në proceset e revizionit;

PROCEDURA PËR PËRDORIMIN E QASJES FTP PËR NEVOJAT E REVIZIONIT NË ENTIN SHETËTOR TË REVIZIONIT

të miratuar më 25.12.2020, me të cilën rregullohet menyra e përdorimit të shërbimit FTP (File Transfer Protocol - Protokollin për bartjen e kartotekave) për dorëzimin (mbledhjen) e të dhënave elektronike të subjektit lëndë të revizionit, me qëllim që të sigurohet rrjedhshmëria e vazhdueshme e revizionit në kushtet e sapokrijura dhe specifike;

PROCEDURA PËR PËRDORIMIN E PLATFORMËS ZOOM PËR NEVOJAT E REVIZIONIT NË ENTIN SHETËTOR TË REVIZIONIT

të miratuar më 25.12.2020, e cila e rregullon mënyrën e përdorimit të platformës ZOOM për mbajtjen e takimeve nëpërmjet videos me subjektet lëndë të revizionit, takimet në ESHR dhe takimet tjera sipas nevojës, në kushtet ku për shkak të gjendjes së sapokrijuar dhe specifike subjekti nuk është në mundësi të merr pjesë fizikisht në takim.

UDHËZIMET PËR KRYERJEN E REVIZIONIT TË LLOGARISË PËRFUNDIMTARE TË BUXHETIT TË RMV-SË

ESHR ka bashkëpunuar me OECD-SIGMA në fushën e revizionit të buxhetit shtetëror, që rezultoi me përgatitjen e Udhëzimeve për kryerjen e revizionit të llogarisë përfundimtare të Buxhetit të RMV-së.



Kontrolli ricertifikuar

Nga ana e trupit të certifikuar u krye kontrolli i dytë i ricertifikuar, për të cilin u përgatit raporti nga kontrolli, në pajtim me sistemin për menaxhimin e ESHR-së është plotësisht në pajtueshmëri me kërkesat e standardit MKS EN ISO 9001: 2015, me të cilën është zgjatur vlefshmëria e certifikatës me të cilën e përcakton se ESHR-ja e zbaton sistemin për menaxhim në përputhje me kërkesat e standardit ISO.

3.3 AKTIVITETET E PROJEKTIT

Aktivitetet e projektit të ESHR-së në vitin 2020 i referohen dy projekteve të rëndësishëm dhe ato:

- ✘ Tvinging projekti i BE-së "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare" MK 18 IPA FI 03 20, dhe
- ✘ Projekti me Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar me titull "Rritja e llogaridhënies dhe transparencës në Maqedoni përmes implementimit të përmirësuar të rekomandimeve nga Enti Shtetëror i Revizionit", të realizuar në bashkëpunim me Fondacionin Westminster për Demokraci (WFD) në shtet dhe Instituti për Hulumtimin e Zhvillimit Shoqëror RESIS.

Si rezultat i aktiviteteve prej Tvinging projektit të mëparshëm, ESHR-ja ka rekomandime të qarta në lidhje me atë çka është e nevojshme për zhvillimin e një diskutimi cilësor parlamentar për raportet e revizionit dhe si duhet të jetë efekti i pritur nga shqyrtimi i raporteve të revizionit në Kuvend. Këto rekomandime ishin pika fillestare për përgatitjen e „Tvinging dosjes” për Tvinging projektin e ri "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare" MK 18 IPA FI 03 20. Në bazë të publikimit të „Tvinging dosjes” dhe propozimit të arritur për Tvinging projektin nga partneritetet e interesuar të dy ISR të vendeve anëtare të BE-së, si dhe pas zbatimit të mëhershëm të procedurës për zgjedhjen, në dhjetor 2020 u lidh marrëveshja për Tvinging projektin me tvinging partnerët e zgjedhur të ISR-ve të Kroacisë dhe të Bullgarisë. Projekti i Tvingingit filloi të realizohet në shkurt 2021 dhe do të zgjasë për 21 muajt e ardhshëm.

Prioritet edhe në periudhën e ardhshme do të jetë përfundimi efektiv i procedurës për rregullimin e kushtetutshmërisë së Entit Shtetëror të Revizionit

dhe forcimi i pavarësisë financiare dhe operative të ESHR-së, si dhe vendosja e mekanizmit të rregullt dhe efektiv për shqyrtimin e raporteve të revizionit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas shembullit dhe praktikave evropiane. Me projektin e ri të Tvingingit "Përmirësimi i revizionit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare" MK 18 IPA FI 03 20, është planifikuar të bëhet vlerësimi i kornizës ligjore për revizionin e jashtëm dhe të bëhen propozime për arritjen e pavarësisë kushtetuese dhe forcimin e pavarësisë financiare dhe operative të ESHR-së.

ESHR-ja në bashkëpunim me Fondacionin Westminster për Demokraci në vend, realizoi projektin të mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me titull "Përmirësimi i transparencës financiare dhe llogaridhënies në Maqedoni". Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte të rritet mbikëqyrja e financave publike, përmes forcimit të bashkëpunimit ndërmjet ESHR-së, Kuvendit të RMV-së, mediave dhe publikut.

Realizimi i aktiviteteve të projektit ishte baza për vazhdimin e bashkëpunimit të ESHR-së dhe fondacionit që rrjedh në projekt të dytë me titull „Rritja e përgjegjësisë dhe transparencës në Maqedoni përmes implementimit të përmirësuar të rekomandimeve nga Enti Shtetëror i Revizionit”, i realizuar në periudhën qershor / korrik 2018 - mars 2019.

Rezultatet e arritura kryesore të projektit janë:



Vlerësimi i përgjithshëm i procesit të revizionit (para fillimit dhe pas mbarimit të revizionit) dhe identifikimi i mangësive në ciklin e përgjithshëm të revizionit që do të jetë pjesë përbërëse e planit të përmirësimit;



Rritja e kapacitetit të ESHR-së për ndjekjen e rekomandimeve;



Strategjia e komunikimit e ESHR-së si një dokument strategjik, i ndërtuar në planet e punës së institucionit dhe thjeshtimi i raporteve të revizorit për palët e jashtme të interesuar.

Pikërisht për rezultatin e dhënë të tretë të projektit, komunikimi dhe bashkëpunimi i suksesshëm ndërmjet partnerëve të projektit ishte arsyeja dhe rasti për vazhdimin e këtij projekti i cili u realizua në periudhën mars 2020 – mars 2021, kësaj radhe u përqendrua kryesisht në komunikimin e ESHR-së me mediat dhe gazetarët, por edhe me palët tjerë të interesuar siç janë institucionet dhe organizatat qytetare si grupe të synuara për bashkëpunim dhe komunikim të ndërsjellë me ESHR-në.

Si rezultat i projektit rrjedh analiza e proceseve të komunikimit dhe praktikave për informimin publik të ESHR-së dhe u përgatit strategjia e komunikimit e ESHR-së 2020-2023, si dokument strategjik që u miratua në shkurt 2020.





4 KAPACITETET ADMINISTRATIVE

4.1 STRUKTURA E ORGANIZIMIT DHE BURIMET NJERËZORE

Në Raportin e Komisionit Evropian për RMV-në për vitin 2019 në pikën 5.32 kapitulli 32 Kontrolli Financiar, si dhe në Raportin e Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve - Zgjedhjet Presidenciale, 21 Prill 2019, në pjesën e rekomandimeve me prioritet është theksuar nevoja për forcim institucional, respektivisht ESHR duhet të disponon me burimet përkatëse institucionale dhe ekspertizë teknike për ti kryer me kohë kompetencat e veta.

Në Shkurt 2020, u përgatit Analizë Funktionale në nivel të ESHR-së, e cila paraqiste hap nisje në vendosjen e ndryshimeve në strukturën e brendshëm dhe realizues të proceseve të punës në ESHR me qëllim sigurimin më të madhe të

efikasitetit dhe efektivitetit në punë. Analiza dha një pasqyrë gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe thelbësore të kompetencave të ESHR-së që realizohen nga njësitë organizative dhe plotësimin e vendeve të punës sipas nevojës për realizimin e programit vjetor të punës së ESHR-së, respektivisht realizimin e revizioneve shtetëror, me qëllim të njëjtit të jenë më efikas dhe më efektiv.

Si rrjedhojë, hapi i parë në forcimin e strukturës së kuadrit është vendosja e një strukture adekuate organizative në nivelin e sektorëve dhe njësisive ndërsa pastaj edhe sistematizimin e vendeve të punës në ESHR.


Aktet e rijnë për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm u miratuan në gusht të 2020.

BURIMET NJERZORE


Përfaqësimi sipas gjinisë



Struktura Udhëheqësia / profesionale / ndihmëse - teknike



Përfaqësimi Etnik



4.2 R R I T J A E N J O H U R I V E D H E A F T Ě S I V E T Ě R E V I Z O R Ě V E S H T E T Ě R O R

ESHR si institucioni suprem i revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si një nga prioritetet e tij strategjike gjithmonë i ka kapacitetet e revizorëve shtetërorë dhe ndërtimi dhe përsosja e tyre profesionale. Si të gjithë ISR-të, ashtu edhe ESHR në përputhje me kërkesat e INTOSAI dhe ISSAI miratoi Planin Vjetor për PVP për vitin 2020, me të cilën u parapanë një numër i madhë i trajnimeve për trajnime të vazhdueshme profesionale të punonjësve në ESHR. Përveç kushteve të krijuara si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga virusi, plani u realizua plotësisht dhe u zbatuan trajnime për fushat e mëposhtme:

- ✘ revizioni;
- ✘ metodologjia dhe praktika e revizionit;
- ✘ ndarja e marrëveshjeve për furnizimet publik;
- ✘ komunikimet dhe
- ✘ mënyra e përdorimit të AMS-it, etj.

Rritja e njohurive dhe aftësive të punonjësve në ESHR bëhet edhe duke marrë pjesë në punëtori dhe ngjarje të organizuara nga shoqata të tjera profesionale dhe subjekte juridikë privatë që ofrojnë arsimim në më shumë fusha.

Gjatë vitit 2020, u mbajtën më shumë ngjarje të organizuar nga Qendra e ekselencës në financat - CEF (Center of Excellence

in Finance - CEF) nga Sllovenia. Disa nga revizorët shtetërorë morën pjesë në trajnimin online për revizionin e TI-së me temë që ka të bëjnë me konceptet e kontroleve të TI-së si kontrollet e aplikimeve, kontrollet e përgjithshme, rreziqet e TI-së, objektivat e kontrollit, si dhe përvojat në pjesën e kryerjes së revizionit të TI-së, dhe zhvillimet e fundit në TI.

Gjithashtu, trajnime të shenjestruara dhe të veçanta u organizuan nga ana e CEF, me të cilat përfituan përvoja dhe informacione të reja në fushën e standardeve IPSAS, menaxhimin me mjetet publike, zbatimin e kontabilitetit menaxhues dhe kontabilitetin financiar në kushtet KOVID - 19 , si dhe zbatimin e vlerësimeve të PEFA-s në nivelin subnacional.

Në organizim të Bankës Botërore në periudhën prej 03.02 derimë 06.03.2020 përfaqësues nga ESHR murrën pjesë në trajnimin për Vlerësimi i suksesit të menaxhimit me borxhin publik - Debt Management Performance Assessment (DeMPA) dhe u përvetësuan me certifikata përkatëse.

4.3 BURIMET E TI - s ë

Përdorimi i teknologjisë së informatikës në procesin e revizionit, ishte sfidë e veçantë në vitin 2020, për shkak të pandemisë Covid-19. U deshën hapa urgjentë dhe specifike për të mbuluar të gjitha detyrat e punës (përdorimi i aplikacioneve, përdorimi i burimeve për takimet, kryerja e revizionit të subjektet etj.) Sidoqoftë, këto sfida u tejkaluan lehtësisht, falë monitorimit të vazhdueshëm të zhvillimit të teknologjisë së informatikës dhe investimit të rregullt në ripërtëritjen e teknologjisë së informatikës për kryerjen e revizionit pa pengesë.

Sistemi i menaxhimit me procesin e revizionit (AMS), si dhe aplikacionet tjera (arkivimi, sistemi i integruar i informacionit financiar, sistemi i analizës së të dhënave të raportit të revizorit) ishin të kapshëm për stafin për punën në distancë. Duke pasur parasysh që të gjithë revizorët përdorin laptopë dhe qasje të largët VPN, cilësia e kryerjes së detyrave të tyre nuk u vu në dyshim.

Për më tepër, u siguroi platforma për mbajtjen e video konferencave dhe takimeve, për punonjësit e ESHR-së dhe për komunikimin me subjektet, lëndë të revizionit. Gjithashtu, u zbatua sistemi elektronik për mbledhjen e dokumenteve në formë elektronike nga subjektet, lëndë të revizionit, i cili do të përdoret në mënyrë aktive me programin vjetor të ESHR-së për vitin 2021. Për kryerjen e aktiviteteve të revizorit pa pengesë, për secilin ekip të revizionit i sigurohet: qasja në internet mobile nga pajisja e unifikuar mobile e siguroar nga ESHR-ja, pajisja portative për sigurimin digjital të provave, si dhe qasja e pandërprerë dhe e sigurt e VPN në sistemin e informacionit të ESHR-së.

Teknologjia e informatikës të cilën e përdorin gjithnjë e më shumë subjektet, lëndë të revizionit ka kontribuar në përdorimin e teknikave të revizionit të ndihmuara nga kompjuteri të njohura si CAAT's në procesin e revizionit. ESHR-ja në revizion e përdor softuerin IDEA për të analizuar të dhënat nga të cilat gjenerojnë raportet financiare dhe për të zgjedhur shembull për nevojat e procesit të

revizionit. Ky softuer është ripërtërirë me versione të reja në fund të vitit 2020.

Në vitin 2020, u realizuan dhe u zbatuan prokurimet e printerëve lazer, licencat për pakon softuerike për punë në zyrë, licencat e pakove softuerike për vizualizimin e proceseve të revizionit dhe prezantimin e rezultateve të revizionit. Me mjetet e siguruara nga projektet është filluar me furnizimin e laptopëve për revizorët, për modernizimin e sistemit të TI-së në ESHR në lokacionin primar dhe sekondar, realizimi i të cilit pritet të jetë në vitin 2021.

Sigurohet funksionimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së sistemit të informacionit dhe aplikacioneve, duke u kujdesur për parimet dhe rregullat për: të dhënat e kapshme të përdoruesit të autorizuar, besueshmërinë, integritetin, ruajtjen e sigurt të të dhënave në vend qendror, pajtueshmërinë me ligjet, bërjen e rregullt të kopjeve rezervë (backup), mbrojtja nga qasja fizike dhe logjike e të dhënave.

Përdorimi i teknologjisë së informatikës, veçanërisht në revizionin shtetëror, bazohet në monitorimin e qëndrueshëm të Politikës së Sigurisë së Sistemit të Informacionit të Entit Shtetëror të Revizionit, si dhe zbatimi i procedurave të sigurisë së TI-së dhe procedurave të TI-së për implementimin e Sistemit të Menaxhimit me Procesin e Revizionit (AMS). Të njëjtit u nënshtrohen analizave vjetore me qëllim që gjithnjë të jenë në hap me zgjidhjet e reja në fushën.

4.4 MJETET FINANCIARE PËR PUNËN ESHR - s ë

Në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror, mjetet financiare për punën e Entit Shtetëror të Revizionit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.


Buxheti i përgjithshëm për vitin 2020 ishte 103,258 mijë denarë, prej të cilëve është aprovuar plani në shumën e përgjithshëm prej 100.234 mijë denarë. Prej tyre, 97.658 mijë denarë ose 94,57% janë mjete të siguruara nga buxheti themelor në llogarinë (637) dhe 5,600 mijë denarë ose 5,42% nga llogaria e buxhetit themelor (631) të cilat i referohen të hyrave të mbledhura nga revizionet e kryera para hyrjes në fuqi të Ligjit për revizion shtetëror në vitin 2010.

Plani financiar i aprovuar për vitin 2020 në llogarinë 637 në vlerë totale prej 94,721 mijë denarë, është realizuar në vlerë totale prej 93,954 mijë denarë, përkatësisht përqindja e realizimit të mjeteve është 99,19%.

Nga aspekti i strukturës së shpenzimeve të Entit Shtetëror të Revizionit, 78,849 mijë denarë ose (83,92%) u referohen pagave dhe kompensimeve të punëtorëve, 13,014 mijë denarë ose (13,64%) u referohen mallrave dhe shërbimeve dhe 2,091 mijë denarë ose (2,22%) për shpenzimet kapitale.

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË LLOGARISË 637

- rrogat
- shpenzime për revizionet në terren
- shërbime komunale
- shpenzime tjera administrative
- shpenzime kapitale



Në vitin 2020, në strukturën e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, pjesëmarrjen më të madhe e kanë shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti ku kap vlerën prej 3,486 mijë denarë, për udhëtime dhe shpenzime ditore, janë realizuar mjete në vlerë prej 1,811 mijë denarë, për materiale dhe inventar të vogël 1,145 mijë denarë, 2,337 mijë denarë janë shpenzuar për riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme, 3,084 mijë denarë janë shpenzuar për shërbime me kontratë, 957 mijë denarë janë shpenzuar për shpenzime të tjera rrjedhëse dhe 191 mijë denarë janë shpenzuar për transferime të ndryshme. Në shpenzimet kapitale, janë realizuar mjete në shumën totale prej 2,091 mijë, të cilat i referohen prokurimit të pajisjeve të zyrës dhe informatikës dhe investimeve në mjete jofinanciare

Për vitin 2020, nga llogaria e buxhetit themelor 631, shpenzimet totale janë bërë në vlerë prej 193 mijë denarë.

Të hyrat në këtë llogari janë 2,709 mijë denarë, prej të cilave 550 mijë denarë janë transferuar të ardhura të tepërta nga viti paraprak dhe 2,159 mijë denarë janë mbledhur të hyra në bazë të kërkesave të papaguara dhe vendimeve gjyqësore ekzekutive. Teprica e transferuar e të ardhurave në fund të periudhës raportuese arrin në 2,516 mijë denarë.

Duke mbështetur të gjitha organet kompetente në luftën kundër pandemisë, Enti Shtetëror i Revizionit në kuadër të mundësive të saj ka paguar mjete në vlerë totale prej 100 mijë denarë në llogari të veçantë të caktuar të Ministrisë së Shëndetësisë në mbështetje të aktiviteteve të kryera për të trajtuar kërcënimin e shëndetit publik të qytetarëve të vendit tonë të shkaktuar nga virusi Covid-19.

Gjithashtu, bazuar në përpjekjet e tyre për t'iu përmbajtur të gjitha masave të planifikuara për mbrojtjen e punonjësve të tyre, gjatë vitit 2020 në mënyrë të vazhdueshme ka siguruar pajisje mbrojtëse për punonjësit për t'u ballafaquar me situatën për KOVID-19, për të cilat janë shpenzuar mjete në vlerë prej 250 mijë denarë.

Duke u kujdesur për vazhdimësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar nga njëra anë dhe nga ana tjetër për përmirësimin e kushteve të punës punonjësve në procesin e kryerjes së aktiviteteve të revizionit. Enti Shtetëror i Revizionit aplikoi për grant për vazhdimësinë e Institucioneve Supreme të Revizionit gjatë kohës së KOVID-19, brenda të cilit Komiteti për Politikë, Financa dhe Administratë (PFAC) miratoi grant prej 614 mijë denarë në llogarinë 785. Këto mjete u përdorën për të blerë laptopë të reja të klasit të biznesit për nevojat e revizorëve. Këta kompjuterë u përdorën për të zëvendësuar laptopët e vjetër që për shkak të performancës së tyre të kufizuar nuk janë në gjendje të ofrojnë mbështetje efikase dhe cilësore për kryerjen e revizionit nga largësia.

Raportet financiare të Entit Shtetëror të Revizionit i revidon kompania e jashtme e revizionit në bazë të marrëveshjes për furnizime publike të ndarë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Raporti nga revizioni i kryer i Entit Shtetëror të Revizionit nga revizori i pavarur, i cili është pjesë integrale e raportit vjetor, e shqyrton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së bashku me raportin vjetor për revizionet e kryera për punën e Entit Shtetëror të Revizionit.

5

KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI

5.1 KOMUNIKIMI, TRANSPARENCA NË PUNËN E ESHR-së


ESHR-ja gjatë vitit 2020, vazhdoi të forcojë përpjekjet e saj dhe të intensifikojë aktivitetet në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në punën e saj. Informimi profesional dhe në kohë i të gjitha palëve të jashtme të prekura (mediat, gazetarët hulumtues, organizatat qytetare, opinionin e gjerë) për rezultatet e arritura nga kryerja e revizionit shtetëror mbetet edhe më tej një nga përcaktimet më të rëndësishme strategjike të ESHR-së në vitin 2020. Duke u udhëhequr nga përcaktimi strategjik të cilat janë theksuar në "Strategjinë e komunikimit të ESHR-së 2020-2023", objektivi i ESHR-së ishte të nxisë komunikimin në të cilin mediat, qytetarët dhe organizatat qytetare të jenë aleatë në arritjen e qëllimeve strategjike dhe

rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në veprimet e shfrytëzuesve të buxhetit për mënyrën e përdorimit të mjeteve publike.

Bashkëpunimi ndërmjet ESHR-së dhe medimeve, organizatave qytetare dhe gazetarëve rrjedhë përmes rrugës së njoftimeve dhe përgjigjeve të pyetjeve të parashtruara. Gjithashtu, është forcuar edhe mënyra e informimit në kohë dhe e vazhdueshme për afërsisht 190 palë të jashtme të interesuar nëpërmjet publikimit të raporteve përfundimtare të revizorëve në faqen e internetit të ESHR-së, deklaratat për media dhe publikimi i Abstrakteve nga raportet e revizorëve në të cilat përmbahen gjendjet e konstatuara kryesore.

LISTA-MEJLING E ESHR-SË DHE KOMUNIKIMI ME **190 PALË** TË JASHTËM TË INTERESUAR

11



Agjenci lajmesh

7

Gazeta



3

Revistë
Javore

20



Televizione

2



Radiodifuzione

30



Portale të internetit

62



Gazetarë

50



Organizata qytetare

5



Institucione

Kjo praktikë u vendos me qëllimin e vetëm për të thjeshtuar "leximin" dhe kuptimin e raporteve të revizorit dhe për të dërguar mesazhe sa më specifike dhe të qarta për gjendjet e konstatuara nga revizionet e zbatuara.

Gjatë vitit 2020, si rezultat i angazhimit të forcuar të ESHR-së për t'u "hapur" ndaj medimeve dhe gazetarëve hulumtues, u evidentuan gjithsej **231 njoftime për medimet** (televizionet, portalet në internet), të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen nga publikimet e raporteve përfundimtare të revizorit të ESHR-së.

Transparenca aktive e shtuar e ESHR-së e nxitë dhe e rriti interesin e profesionit gazetar në


lidhje me tema të caktuara ose gjendje të konstatuara në raportet përfundimtare të revizorit. Për dukshmërinë dhe hapjen e ESHR-së flet edhe numri i madh i ftesave për pjesëmarrje në disa shtëpi mediatike dhe agjenci të lajmeve në vend të drejtuar kryerevizorit shtetëror.

Si rezultat i praktikës së vendosur për informimin e palëve të jashtme të interesuar për publikimin e raportit përfundimtar të revizorit, gjatë vitit 2020, është vërejtur një trend i rritjes së vizitorëve në faqen tonë të internetit. Vitin e kaluar, gjithsej janë evidentuar **48,184** vizita në faqen e internetit të ESHR-së (me një mesatare prej **4,015** vizita në muaj), dhe për **345,000** faqe ose përmbajtje të hapura.

VIZITA NË FAQËN E INTERNETIT WWW.DZR.MK



PËRMBAJTJE TË VIZITUARA



5.2 BASHKËPUNIMI ME SHOQATAT DHE INSTITUCIONET PROFESIONALE

Për të arritur qëllimet e tij strategjike, ESHR-ja në 2020 vendosi praktikën e zhvillimit të marrëdhënieve me organizatat e tjera të cilat nuk janë ISR, me qëllim të shkëmbimit të përvojave pozitive. Është krijuar bashkëpunimi me shoqatat dhe institucionet e shumta profesionale vendase dhe me disa prej tyre janë lidhur memorandume për bashkëpunim.

Instituti i Revizorëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë

Me Memorandumin e nënshkruar është shprehur gatishmëria për bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve në pjesën e:

- ✘ sigurimit të shkëmbimit të vazhdueshëm të të dhënave dhe informacioneve në kuadër të kompetencave të tij ligjore,
- ✘ dhënies së ndihmës profesionale nga aspekti i metodologjisë dhe zbatimit të standardeve sipas të cilave punojnë revizorët (INTOSAI dhe Standardet Ndërkombëtare për Revizion - SNR),
- ✘ bashkëpunimit në fushën e kontabilitetit dhe revizionit, si dhe
- ✘ shkëmbimit të literaturës profesionale, doracakëve dhe materialeve të tjera të nevojshme për procesin e kryerjes së revizionit.

Gjatë vitit 2020, me implementimin e memorandumit, përfaqësuesit e IORRM morën pjesë në trajnime të organizuara nga ESHR-ja, ndërsa në të njëjtën kohë dhe për herë të parë u organizua trajnimi i përbashkët i organizuar nga Instituti i Revizorëve të Autorizuar (IRARM) me temë "Sfidat në profesionin e revizorit", në të cilin gjithashtu fjalim patën edhe kryerevizori shtetëror dhe punonjësit e ESHR-së. Përveç kësaj u realizua edhe bashkëpunimi në pjesën e shkëmbimit të literaturës profesionale dhe materialeve të tjera të nevojshme për procesin e kryerjes së revizionit.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)

Implementimi i Memorandumit të lidhur ndërmjet ESHR-së dhe SHGM-së, krijoi bazë për ndërtimin e partneritetit të ESHR-së me mediet, në mënyrë që do të mundësojë informimin më të mirë, në kohë dhe më cilësor të qytetarëve për temat që janë me interes të veçantë publik, të cilat do të kontribuojnë në shikueshmëri më të madhe për punën e ESHR-së. Një bashkëpunim i tillë gjithashtu do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së punës së ESHR-së nëpërmjet dhënies së informacioneve dhe konstatimeve të përfshira në raportet përfundimtare të revizorit, në drejtim të realizimit të qëllimeve strategjike të ESHR-së.

Enti Gjeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me këtë memorandum forcohet bashkëpunimi që mundëson shkëmbimin e ndërsjellë të të dhënave, përvojave dhe ekspertizës ndërmjet dy institucioneve për të arritur efektivitetin dhe efikasitetin e masave dhe aktiviteteve për zbatimin e kërkimit gjeologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm të lëndëve minerale, si dhe shkëmbimin dhe përgatitjen e analizave, hulumtimeve dhe akteve të tjera të nevojshme për procesin e revizionit.

5.3 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

ESHR si dhe ISR-të tjera, është aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar. Me të mundësohet rritja e njohurive dhe aftësive të punonjësve, shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të revizionit.

Për shkak të situatës së imponuar nga pandemia COVID-19, ngjarje të shumta të planifikuara për vitin 2020 u anuluan ose u shtynë për në 2021 dhe 2022, duke përfshirë edhe Kongresin XI të EUROSAT dhe Konferencën Rinore YES të EUROSAT. Ata që mbetën në rendet e ditës të EUROSAT, INTOSAT dhe grupet e tyre të punës u realizuan në distancë, përmes video konferencave dhe në formën e ueb konferencë. Mundësia e mbajtjes së ngjarjeve ndërkombëtare virtuale u mundësoi atyre të ndiqen nga një numër më i madh i punonjësve të ESHR. Përveç temave të rregullta aktuale në fushën e revizionit, tema të reja

u shfaqën në rendin e ditës të këtyre ngjarjeve, në lidhje me sfidat me të cilat përballen ISR-të për sa i përket funksionimit të tyre dhe lëndëve të revizionit në kushtet e pandemisë së virusit korona COVID-19.

Pjesëmarrja në revizionet kooperative me institucionet tjera supreme të revizionit nga BE dhe më gjerë mbetet një nga përparësitë e institucionit duke pasur parasysh faktin se ky lloj bashkëpunimi kontribuon ndjeshëm në forcimin e vazhdueshëm të aftësive të revizionit dhe përmirësimin e cilësisë së revizioneve të suksesit.

ESHR është pjesëmarrëse aktive në disa grupe operative dhe pune ndërkombëtare, mes të cilave dhe:



Grupi i punës për mjedisin
jetësor të EUROSAT (WGEA)



Grupi i punës i EUROSAT për TI (ITWG)



Grupi operativ i EUROSAT
për revizion dhe etikë (TFA & E)



Grupi operativ i EUROSAT për
revizion të komunave (TFMA)



Grupi i punës i INTOSAT për borxhin publik (WGPD)

Një nga mënyrat për të shpërndarë progresin dhe porosin e revizorëve anëtarëve të EUROSAI-it dhe ISR-të tjerë është botimi i teksteve dhe punimeve relevante. Ashtu si në vitet e mëparshme, ESHR kontribuoi duke botuar tekste mbi temat aktuale dhe qasjet inovative të revizionit në buletinet dhe revistat profesionale të grupeve të punuese EUROSAI (WGEA dhe TFMA) të cilët janë në lidhje me efektivitetin e politikave, masave dhe aktiviteteve gjatë eksploatimit të rërës dhe zhavorr nga shtrati i lumit Vardar dhe për detyrimet financiare dhe financiare (paqëndrueshmëria) të NJVL-së.

Gjatë vitit 2020, ESHR morri pjesë në **30 ngjarje ndërkombëtare** (takime, punëtori, konferenca), nga të cilat 22 u realizuan përmes lidhjes video.

Gjithsej 84 pjesëmarrës patën mundësinë të informohen për praktikën më të mira dhe të marrin pjesë në rrjetëzim si një mundësi për të zgjeruar njohuritë dhe aftësitë e tyre në disa fusha:

- ✘ bashkëpunimi me kuvendin;
- ✘ revizioni i mjedisit jetësor;
- ✘ Mbështetja e TI-së dhe revizioni i TI-së;
- ✘ avancimi i punës të ISR-së;
- ✘ borxhi publik;
- ✘ financimi i partive politike;
- ✘ pandemia COVID-19 si një sfidë dhe mundësi për të rritur ndikimin e ISR-së.



Kontributi i ESHR-së në realizimin e aktiviteteve të grupeve të punës dhe programeve të EUROSAI, gjatë vitit 2020 u zhvillua vazhdimisht, në përputhje me kushtet e imponuara nga COVID - 19.

Përfaqësuesit e ESHR-së i realizuan aktivitetet e planifikuara në kuadër të dy revizioneve kooperative të EUROSAI të cilat kanë lidhje me fushat:

- ✘ " **Fuqia punëtore 2030 - a është vendi juaj gati** " dhe
- ✘ " **Mbeturinat plastike** ", përfundimi i të cilave pritet në 2021 me botimin e një raporti të përbashkët nga zbatimi i revizionit.

Koordinatorët e këtyre revizioneve janë ISR-të e Finlandës dhe Izraelit, gjegjësisht ISR-ja e Polonisë. Përfitimet nga bashkëpunimi me ISR-të tjerë janë të shumëfishta, dhe ne veçanti i theksojmë mundësinë

që e kanë revizorët të ndërtohen në mënyrë profesionale në formën e aktiviteteve kolegjiale (peer-to-peer), qasje fleksibile dhe përdorimin e përvojave të pjesëmarrësve të tjerë dhe forcimin e vetëbesimit në kapacitetin e vet për kryerjen e revizionit të suksessit.

Në kuadër të grupit punues për mjedisinë jetësor të EUROSAI (WGEA), përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në Seminarin Pranveror të Energjisë së Qëndrueshme dhe i takimit të 18-të Vjetorit të grupit të mbajtur në shtator 2020, ku shkëmbyen përvojat nga revizionet e kryera për cilësinë e ajrit dhe trafikut urban. ESHR e prezantoi gjendjen dhe aktivitetet e ndërmarra nga ana institucioneve kompetente shtetërore pas rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

ESHR tregoi aktivitet të veçantë në punën e grupit operativ të EUROSAL për revizionin e komunave (TFMA), veçanërisht në pjesën e realizimit të planit aksional për 2020/21. Në takimin e katërt vjetor të grupit, të mbajtur në mënyrë virtuale në shtator 2020, ESHR mori pjesë me dy prezantime dhe shprehu gatishmërinë që të jetë bartës i dy aktiviteteve të rëndësishme:

- ✘ koordinator i revizionit kooperativ me temën: "**Të hyrat personale të komunave në kushtet e pandemisë për sigurimin e shërbimeve cilësore të qytetarëve**" dhe
- ✘ për të përgatitur një analizë me temë "**Mbledhja e të dhënave për mënyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve në raportet e revizorit për NJVL**" për të cilat ESHR më parë ka përgatitur një pyetësor të veçantë dhe ua ka dorëzuar të gjitha institucioneve supreme të revizionit, anëtarë të këtij grupi operativ.

Në pritje të Kongresit XI të EUROSAL që duhet të mbahet në Pragë në qershor 2020, ISR e Republikës Çeke organizoi takimin e parë të përfaqësuesve të ISR-të Evropian në Pragë në mars 2020 (i ashtuquajtur i 1st Hackathon). Në ngjarjen, në të cilën morri pjesë edhe ESHR, pjesëmarrësit kishin për qëllim të gjejnë zgjidhje për përdorimin e aplikacioneve ose vizualizimin për të përmirësuar efektivitetin e proceseve të revizionit të ISR-së duke kursyer shpenzimet dhe thjeshtësuar punën e revizorëve.

Grupi i punës për TI (ITWG) organizoi një seminar virtual për të zhvilluar aftësitë dhe kapacitetin e TI-së për kryerjen e revizioneve të TI-së, të cilat i

ndoqën revizorët e ESHR-së. Shkathtësitë e TI-së po bëhen më të rëndësishme në kushtet e shkaktuara nga risitë në ICT (information & communication technology) dhe ndryshimet në punën e ISR-së për shkak të pandemisë.

Si përgjigje të zhvillimeve të shkaktuara nga KOVID-19, ndërsa në kuadër të planit strategjik të EUROSAL 2017-2023, me iniciativë të ISR-së të Finlandës dhe Gjykatës Evropiane të Revizorëve, u formua një grup i ri i projektit me titull "**Përgatitja për rreziqet në të ardhmen dhe krizat klimatike: Është koha për shqyrtim më afatgjatë të revizionit**", së cilës iu bashkuan 21 ISR ndërmjet të cilëve edhe ESHR. Në takimet përgatitore, ku morën pjesë edhe përfaqësues të ESHR-së, u përcaktuan aktivitetet e ardhshme, të cilat do të synojnë mbledhjen e informacioneve relevante nga revizionet e mëparshme të kryera mbi këtë temë dhe ndarjen e tyre me anëtarët tjerë të grupit.

Çështjet në lidhje me sfidat me të cilat përballen ISR-të në situatën e re për shkak të KOVID-19, ishin në fokus të konferencës së përbashkët virtuale EUROSAL-OLACEFS dhe vebinarit të organizuar nga Komiteti Mbikëqyrës për Çështje të Reja të INTOSAI - SCEI të mbajtur në shtator 2020 në organizim të ISR-së të Hungarisë, d.m.th ISR-së të Federatës Ruse. Në të dy ngjarjet u theksua se momentum i shkaktuar për shkak të virusit korona, duhet të shfrytëzohet nga ISR në drejtim që të nxjerrë në pah rolin dhe ndikimin e tij si ruajtës i parave publike duke e përqendruar në punën e tij të revizionit të lidhura me KOVID-19.

INTOSAI



Në thirrjen e hapur të Sekretariatit të grupit punues të INTOSAI për mjedisin jetësor, ESHR një tekst për përvojën e vendit tonë në trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve plastike. Duke vlerësuar punën si interesante dhe duke merituar një vëmendje më të gjerë, Sekretariati i kërkoi ESHR-së të bënte një prezantim të shkurtër në sesionin mbi mbetjet plastike në kuadër të takimit virtual të Asamblesë së GP të INTOSAI-t për mjedisin jetësor, të mbajtur më 19-21 janar 2021. Sekretariati i grupit të punës për mjedisin jetësor të INTOSAI-t, duke iu përmbajtur praktikës, promovoi prezantimin e ESHR-së gjatë takimit në rrejtët sociale, nën moton "Le ta Riciklojmë Sjelljen Tonë ndaj Mbetjeve Plastike" - "Le të Riciklojmë Sjelljen Tonë të Mbetjeve Plastike".

Bashkëpunimi me grupin e punës së INTOSAI për borxhin publik (WGPD) ishte në drejtim të realizimit të projekteve, të iniciuar në planin e punës të WGPD për 2020-2022. ESHR shprehu gatishmërinë për të qenë mbartës, përkatësisht anëtar aktiv i dy projekteve nga ky plan:

- ✘ kompendium- Përmbledhje e procedurave praktike në revizionin e autorizimit të borxhit, lidhjen e marrëveshjes dhe kornizën juridike të borxhit publik dhe
- ✘ hartimi i mandateve të ISR-së për revizionin e borxhit publik.

Takimi vjetor i WGPD i cili u mbajt në mënyrë virtuale në gusht 2020, ishte në shenjë të zhvillimeve të reja, respektivisht rolin e revizorëve të borxhit publik në dritën e KOVID - 19.

Në vitin e KOVID -19 , një seri vebinarësh të organizuar IDI mbi temën e qasjeve inovative të institucioneve supreme të revizionit në proceset e revizionit dhe Komisionin për Standardet Profesionale të INTOSAI-t (INTOSAI PSC) në të cilën u diskutua për zbatimin e kuadrit për publikimet profesionale (IFPP) nga ana e ISR-së.

Përfaqësuesi i ESHR-së mori pjesë në punëtorin INTOSAI në Tiranë, në shkurt 2020, të organizuar nga ISR i Shqipërisë në rolin e ekspertit-moderatorit dhe i vebinarit mbi kornizën për matjen e suksesit të ISR-së që e zbatoi IDI.



Si anëtar shumëvjeçarë i rrjetit të ISA të vendeve kandidatë dhe kandidatëve potencialë për anëtarësim në BE dhe Gjykatën Evropiane të Revizorëve, ESHR është i përfshirë në mënyrë aktive dhe jep kontribut të rëndësishëm në realizimin e aktiviteteve të rrjetit që synojnë përgatitjen e strukturave të revizionit në vendet që janë rrugës për tu anëtarësuar në familjen evropiane. Aktivitetet e rrjetit rrjedhin me mbështetjen e grupi punues për aktivitete e përbashkëta të revizionit, të formuar nga Komiteti i Kontaktit i Vendeve të BE-së, anëtarë tjerë të ISR-së të BE-së dhe SIGMA.

Delegacioni i ESHR-së, i udhëhequr nga kryerevizori shtetëror, mori pjesë në konferencë me temë „**Bashkëpunim me parlamentet për të përmirësuar ndikimin e revizionit**” e cila u mbajt në Malë të Zi me 20-21 Shkurt 2020. Konferenca e organizuar nga ISR i Malit të Zi dhe e mbështetur nga OECD - SIGMA, i mbledhi ISR-të e vendeve kandidatë dhe kandidatë potenciale për anëtarësim në BE, së bashku me anëtarët dhe stafin profesional të komisioneve parlamentare relevante. Konferenca ofroi përvoja dhe shembuj të praktikës së mirë nga disa shtete anëtare të BE-së dhe vendet anëtare të rrjetit për dy temat kryesore:

- ✘ zbatimi i mjeteve praktike - mekanizmat për shqyrtimin e raporteve të revizionit me theks të veçantë në mbajtjen e diskutimeve parlamentare efikase për gjetjet dhe rekomandimet kyçe të revizionit, dhe
- ✘ përdorimi i sistemit të raportimit për shqyrtimin më efektiv të raporteve të revizionit nga ana komisioneve parlamentare.

Pas përfundimit të konferencës, delegacioni i ESHR-së pati një takim pune me përfaqësuesit më të lartë të ISR-të e Malit të Zi, në të cilin u dakorduan drejtimet e bashkëpunimit të ardhshëm ndërmjet dy institucioneve.

Në vitin 2020, u mbajt vebinari i parë i serisë së re të punëtorive virtuale, të iniciuar dhe organizuar nga OECD-SIGMA për vendet e rrjetit me temën KOVID - 19 dhe ndikimi i tij në punën e ISR-së, planet e ardhshme për punën dhe efektivitetin e revizioneve të lidhur me shpenzimet e bëra në sektorin publik si rezultat i pandemisë KOVID-19.

Në vitin që e shënoj KOVID - 19, një revizor e përfundoi programin për praktikë në Gjykatën Evropiane të Revizionit në Luksemburg, ndërsa programi që do të fillonte në 1 mars 2020, për shkak të virusit korona dhe masave restriktive të miratuara për mbrojtje në nivel global, ESR e pezulluan edhe të gjithë kandidatët - praktikant ndërmjet të cilëve edhe një revizor nga ESHR-ja u kthyen në vendet e veta.

Gjatë vitit 2020, përfaqësuesit e ESHR-së morën pjesë në punëtoritë në fushën e financimit të partive politike, të mbajtura në Pragë dhe Shkup, të organizuara nga IFES (Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore). Punëtoritë ishin pjesë e Programit për administratë rajonale të zgjedhjeve, forcimin e proceseve politike dhe sistemeve zgjedhore të hartuar dhe mbështetur nga USAID.

5.4 BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMPETENTE PËR REVIZIONET DHE EFEKTET E TYRE

Në mënyrë që të arrihet qëllimi themelor i revizionit - kujdesi për mjetet publike dhe avancimi i menaxhimit të tyre, zbulimi në kohë i devijimeve nga standardet e pranuar dhe kundërvajtjet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomisë në menaxhimin me mjetet publike, ESHR-ja jep rekomandime të qarta dhe efektive, në mënyrë që të merren hapa për të parandaluar ose përkeqësuar devijimet dhe kundërvajtjet në të ardhmen. Masat korigjuese për zbatimin e rekomandimeve mundësojnë që udhëheqësia e subjektit, lëndë e revizionit, të përmirësojë efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomicitetin në punën.

Enti Shtetëror i Revizionit edhe në vitin 2020 përmes informacioneve të qarta, reale, objektive dhe në kohë për parregullsitë e konstatuara, mospërputhjet me rregulloret ligjore, veprimi i paligjshëm me mjetet publike dhe rastet e mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare, kontribuuan në përmbushjen e një pjese të kompetencave të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

ESHR-ja i kushton vëmendje të obliguar përpunimit dhe analizës së informacionit që rrjedhë nga raportet përfundimtare të revizorëve të autorizuar shtetërorë. Ai i përpunon këto të dhëna rregullisht me aplikacion softuer që është i integruar, autonom dhe funksional për përpunimin dhe analizimin e të dhënave nga raportet përfundimtare të revizionit. Në këtë mënyrë janë siguruar informacione relevante, të besueshme, të azhurnuar dhe në kohë për nevojat e ESHR-së, organet kompetente dhe palët tjerë të interesuar.

Me dorëzimin e rregullt të raporteve përfundimtare të revizionit në Kuvend dhe organet kompetente, ESHR-ja e fokuson vëmendjen e saj në dobësitë e konstatuara në punën e subjekteve të reviduara.

Në vazhdimisht i evidentojmë, monitorojmë dhe analizojmë informacionet kthyes të marra nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, MF-Drejtoria e Policisë Financiare, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zëvendëskryetari për Luftë kundër Korrupsionit dhe Krimin, Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Burimeve Njerëzore, për të vepruar sipas raporteve përfundimtare të revizionit të dorëzuar atyre.

Efekti nga gjendjet e konstatuara që tregojnë parregullsi dhe paligjshmëri në punën e subjekteve në menaxhimin më të mirë të mjeteve publike mund të pritet vetëm nëse institucionet kompetente i ndër-marrin masat e nevojshme për tejkalimin e tyre.

Monitorimi dhe informimi në lidhje me aktivitetet e ndërmarra të institucioneve kompetente për tejkalimin e parregullsive dhe paligjshmërive të konstatuara në punën e subjekteve është një nga qëllimet strategjike të ESHR-së.

Aktivitetet e ESHR-së në lidhje me parandalimin e korrupsionit kryhen në përputhje me kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara me Ligjin për revizion shtetëror, Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të intereseve dhe rregullativat e tjera ligjore relevante.

Në kuadër të realizimit të Programit Vjetor të punës së ESHR-së për vitin 2020, raportet përfundimtare të revizionit u dorëzuan në institucionet e mëposhtme kompetente:

- ✘ Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë Veriore janë dorëzuar 16/ gjashtëmbëdhjetë/ raporte përfundimtare të revizionit për 13/ trembëdhjetë/ subjekte të reviduara (revizione).
- ✘ Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë dorëzuar 4/ katër/ raporte përfundimtare të revizionit për 4/ katër/ subjekte të reviduara (revizione).
- ✘ Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë dorëzuar 4/ katër/ raporte përfundimtare të revizionit për 3/ tre/ subjekte të reviduara (revizione).
- ✘ Drejtoria e Policisë Financiare janë dorëzuar 2/ dy/ raporte përfundimtare të revizionit për 2/ dy/ subjekte të reviduara (revizione).
- ✘ Zëvendëskryetari i Qeverisë për Luftë kundër Korrupsionit dhe Krimin, Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Burimeve Njerëzore, janë dorëzuar 7/ shtatë/ raporte përfundimtare të revizionit për 6/ gjashtë/ subjekte të reviduara (revizione)

Më 12.02.2021 me nr. të arkivit 18-350 / 1, ESHR-ja te Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzoi Kërkesë për informata kthyesë për masat e ndërmarra nën juridiksionin e saj në lidhje me raportet përfundimtare të revizionit të dorëzuar në përputhje me Programet Vjetore të punës së ESHR-së për vitet 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2020.

Më 02.04.2021 me nr. të arkivit 18-350 / 2, te Prokuroria Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut është dorëzuar Urgjencë për marrjen e informatave kthyesë pas dorëzimit të Kërkesës më parë prej 12.02.2021. Deri në publikimin e këtij Raporti Vjetor, asnjë përgjigje nuk u mor nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në 12.02.2021 me nr. të arkivit 18-351 / 1, ESHR-ja te MF-Drejtoria e Policisë Financiare i dorëzoi Kërkesë për informata kthyesë për masat e ndërmarra nën juridiksionin e saj në lidhje me raportet përfundimtare të revizionit të dorëzuar në përputhje me Programet Vjetore të punës së ESHR-së për vitet 2018 dhe 2020.

Më 23.03.2021 me nr. të arkivit. 18-351 / 2, nga MF-Drejtoria e Policisë Financiare është marrë përgjigje kthyesë për të vepruar në përputhje me kompetencat ligjore dhe autorizimet.

Në 12.02.2021 me nr. të arkivit 18-350 / 1, ESHR-ja te Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut i dorëzoi Kërkesë për informata kthyesë për masat e ndërmarra nën juridiksionin e saj në lidhje me raportet përfundimtare të revizionit të dorëzuar në përputhje me Programet Vjetore të punës së ESHR-së për vitet 2018 dhe 2020.

Me 30.03.2021 me nr arkivi. 18-352 / 2 nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është marrë përgjigje kthyesë për të vepruar në lidhje me Kërkesën e paraqitur, si vijon: 4/ katër/ raporte përfundimtare u dorëzuan në Prokurorinë Publike Themelore Shkup, nga ku u morën informacione se 2/ dy/ janë dorëzuar për veprime të mëtutjeshëm te MF- Drejtorinë e Policisë Financiare.

Enti Shtetëror i Revizionit bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjitha organet shtetërore me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e korrupsionit, në kuadër të Protokollit për Bashkëpunim për Parandalimin dhe Represionin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesit.

Enti Shtetëror i Revizionit merr pjesë në realizimin e Programit Nacional për miratimin e së drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) përmes aktiviteteve të parashikuara në Kapitullin 3.23. Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale, Rajoni - Politika e Antikorrupsionit dhe Kapitulli 3.32 Kontrolli Financiar, Rajoni – Revizioni i Jashtëm, si dhe në punën e organeve dhe trupave tjerë për parandalimin e korrupsionit.

6 AKTIVITETET E REVIZIONIT PËRMES NUMRAVE

Rezultatet nga aktivitetet e revizionit të përcaktuar me Programin Vjetor për punën e ESHR-së për 2020 janë të përfshirë në shqyrtimin më poshtë, si vijon:

65

Raportet e revizorit për revizionin e rregullshmërisë

7

Raportet e revizorit për revizionin e suksesit

7

Revizioni i pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit

1

Revizioni i TI-së

2

Revizionet Follow - up

82

Raportet e revizionit të dorëzuar te përfaqësuesi ligjor i subjektit që ka qenë lëndë e revizionit

16

Raportet e revizionit të dorëzuar Prokurorisë Publike të RMV-së

4

Raportet e revizionit të dorëzuar Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit në RMV.

82

Raportet e revizionit të dorëzuar Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

481

Subjektet e përfshira me revizion

1.014

Gjetjet në raportet e revizionit

604

Rekomandimet në raportet e revizionit

347.295

Të hyrat publike të përfshira me revizion (në milion denarë)

184.432

Shpenzimet publike të përfshira me revizion (në milion denarë)

24

Në vitin 2020 janë kryer kontrolle për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up)

41

Janë lëshuar raportet për kontrollet e zbatuara për përcaktimin e statusit të rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të revizionit (follow up)

Revizionet e planifikuara

Enti Shtetëror i Revizionit në Programin Vjetor për vitin 2020 planifikoi dhe kreu 58 revizione prej të cilave

- ✘ 42 revizione të rregullshmërisë,
- ✘ 6 revizione të pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit,
- ✘ 7 revizione të suksesit,
- ✘ 2 revizione për ndjekjen e rekomandimeve të zbatuara (revizione followup) dhe
- ✘ 1 revizion i TI-së.

Gjetjet

Gjetjet në raportet e revizionit nga të cilët:	1.014
Gjetjet me revizionin e Buxhetit Themelor	39
Gjetjet me revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë	737
Gjetjet me revizionin e suksesit	171
Gjetjet me revizionin e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizionit	65
Gjetjet nga revizioni follow up	2

Furnizimet publike

Në vitin 2020 me revizionet janë përcaktuar 48 gjetje të furnizimeve publike prej të cilave më të përfaqësuara janë këto parregullsi të cilat më së shumti përsëriten në raportet e revizionit:

- ✘ Dobësia në fazën e vlerësimit dhe propozimit të dhënë për zgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm;
- ✘ Dobësi në fazën e planifikimit të FP;
- ✘ Dobësi në fazën e lidhjes së marrëveshjes me ofertuesit e zgjedhur;
- ✘ Dobësia në fazën e realizimit të marrëveshjes së lidhur sipas FP dhe
- ✘ Dokumentacioni i tenderit i cili në veti përmban elemente kufizuese në lidhje të konkurrencës dhe krijimit të mundësisë për favorizimin e OE të caktuar.

MENDIMET E REVIZORIT

Në raportet e revizionit për raportet financiare për vitin 2019, janë shprehur:

- ✘ 16 mendime pa rezervë (mendime pozitive)
- ✘ 20 mendime me rezervë;
- ✘ 25 mendime negative dhe
- ✘ 4 të përmbajtur në shprehjen e mendimit.

Për pajtueshmërinë me ligjet dhe rregullat për 2019 janë shprehur:

- ✘ 14 mendime pa rezervë (mendime pozitive);
- ✘ 26 mendime me rezervë;
- ✘ 15 mendime negative dhe
- ✘ 7 të përmbajtur në shprehjen e mendimit.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET

Vlera e përgjithshme e të hyrave të reviduara të cilat janë përfshirë me revizionet e kryera në pajtim me Programin Vjetor për vitin 2020 është 347.295 milion denarë, ndërsa të hyrat e përgjithshme të reviduara për vitin e kaluar është 247.997 milionë denar, që paraqet 40% më shumë të hyra publike të reviduara. Struktura e të hyrave të reviduara në vitet 2020 dhe 2019 sipas grupeve të shfrytëzuara janë shfaqur në tabelën si vijon,

Shqyrtimi i të ardhurave publike të reviduara (në milion denarë)				
Të ardhurat publike të reviduara sipas llojit të përdoruesve	PV 2020		PV 2019	
	Të ardhurat	Pjesëmarrja në %	Të ardhurat	Pjesëmarrja në %
Buxheti Qendror i RMV-së	161.101	46	172.101	69
Buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale	2.048	1	1.775	1
Buxhetet e fondeve	109.548	32	70.206	28
Përdoruesit e mjeteve nga buxheti i FSSH (ISHP-spitalet, klinikat....)	555	0	858	0
Partitë politike	642	0	637	0
Ndërmarrjet publike	303	0	20	0
institucionet tjera	1.317	0	2400	2
Përfshirja e të ardhurave publike me revizionet e suksesit	71.386	21	0	0
Përfshirja e të ardhurave publike me revizionet e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizioneve	395	0	0	0
Gjithësej	347.295	100	247.997	100

Shuma e përgjithshme e shpenzimeve publike të reviduara të cilat janë përfshirë me revizionin e kryer në pajtim me Programin Vjetor për vitin 2020 është 184.432 milion denarë, ndërsa shuma e përgjithshme e shpenzimeve të reviduara për vitin e kaluar është 161.586 milion denarë, që paraqet se 14% janë reviduar më shumë shpenzime publike. Struktura e shpenzimeve publike të reviduara në vitet 2020 dhe 2019 sipas llojit të shfrytëzuesve është shfaqur në tabelat si vijon.

Shqyrtimi i shpenzimeve publike të reviduara (në milion denarë)				
Shpenzimet publike të reviduara sipas llojit të përdoruesve	RV 2020		RV 2019	
	Shpenzimet	Pjesëmarrja në %	Shpenzimet	Pjesëmarrja në %
Buxheti Qendror i RMV-së	2.535	2	47.597	29
Buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes lokale	1.651	1	1.737	1
Buxhetet e fondeve	107.048	58	99.966	62
Përdoruesit e mjeteve nga buxheti i FSSH (ISHP-spitalet, klinikat...)	552	0	847	1
Partitë politike	550	0	613	0
Ndërmarrjet publike	292	0	24	0
Institucionet tjera	1.134	1	3.191	2
Përfshirja e shpenzimeve publike me revizionet e suksesit	69.863	38	4.906	3
Përfshirja e shpenzimeve publike me revizionet e pajtueshmërisë si lloj i veçantë i revizioneve	807	0	2.705	2
Gjithsej	184.432	100	161.586	100

Shuma e buxhetit të përgjithshëm të realizuar në pajtim me llogarinë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 është 217.447 milion denarë, ndërsa shpenzimet e reviduara të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 është 129.202 milion denarë, që paraqet përfshirje prej 59% nga buxheti i realizuar përmes shpenzimeve të reviduara.

Përfshirja e Buxhetit përmes shpenzimeve të reviduara me PV të ESHR-së për vitin 2020

Shpenzimet e reviduara sipas llojeve të buxhetit në lidhje me buxhetet e përgjithshme	(në milion denarë)		
	Buxheti i realizuar për vitin 2019	Të reviduar	Pjesëmarrja në %
1	2	3	4 (3/2)
Shpenzimet e buxhetit të RMV-së për vitin 2019 (Llogaria përfundimtare e Buxhetit të RMV-së për vitin 2019 Gazeta Zyrtare e RMV-së 89/2021)	217447	129.202	59
Buxheti i Njërive të Vetëqeverisjes Lokale	33.843	1.651	5

6.1 VLERAT E SHTUAR E REVIZIONEVE

Me Programin Vjetor për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2020 janë konstatuar qëllimet dhe detyrat për punën, të cilat janë në drejtim të realizimit të qëllimeve strategjike. Aktivitetet e ndërmarra për realizimin e qëllimeve strategjike sigurojnë përfshirje përkatëse të mjeteve publike të reviduara, përmirësimin e kapaciteteve të punonjësve për zbulimin e parregullsive, si dhe kryerjen e revizioneve të suksessive në programet dhe projektet e ndryshme që janë në funksion të realizimit të objektivave të revizionit, përkatësisht përgjegjësisë dhe menaxhimit të mirë, rishikimit të rezultateve në bazë të aktiviteteve ekonomike, efikase dhe efektive të sektorit publik.

Rezultatet kryesore nga puna e Entit Shtetëror të Revizionit në vitin 2020 përbëhen nga:

- ✘ dhënia e rekomandimeve të qarta dhe efektive për institucionet shtetërore dhe të tjera nga sektori publik në avancimin e menaxhimit me mjetet publike;
- ✘ duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së përdorimit të fondeve publike / fondeve të tatimpaguesve, ndërsa me to edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes shërbimeve të ofruara me respektimin

e parimeve të sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit, transparencës, qasjes dhe shërbimit universal, mbrojtjes së përdoruesve dhe qytetarëve;

- ✘ gjendja e konstatuar e evazionit fiskal, mospagimi i detyrave dhe shtesave publike në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me çka ESHR-ja siguron kthimin më të vogël të fondeve të investuara nga Buxheti i RMV-së në ESHR. Në të njëjtën kohë, autoritetet kompetente u njoftuan për të ndërmarrë aktivitete për arkëtimin e fondeve më pak të paguara në Buxhetin e RMV-së;
- ✘ revizioni në ndarjen e marrëveshjeve për FP me theks të veçantë në ndarjen e marrëveshjeve për FP në kushtet e pandemisë dhe sigurimi i informacionit të saktë për qytetarët dhe publikun e gjerë për mënyrën e përdorimit të ndihmës (nga brenda dhe jashtë vendit) për t'u marrë me pandeminë. Gjithashtu në drejtim të përshtatjes së sistemit për furnizime publike për sfidat e ardhshme dhe ballafaqimi i organeve kompetente me kriza dhe pandemi të ngjashme, revizioni sugjeroj nevojën për rregullimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga fusha e furnizimeve publike.

Disa nga rezultatet kryesore shfaqen grafikisht:

VLERA E
SHTUAR E
REVIZIONEVE

670.767

Shuma e përgjithshme nga
parregullsitë e konstatuar te FP

1.501.621

Përfshirja e FP me revizionet

582.600

Të papaguara/ taksë publike më pak të paguara/
Kompensime në Buxhetin e RMV-së

743.103

Përdorimi i paligjshëm i
mjeteve

68.629.885

Gjithsej aktiva / pasiva

në 000 denarë

6.2 REKOMANDIMET DHE ZBATIMI I TYRE

Përveç misionit themelor të Entit Shtetëror të Revizionit si Institucion Suprem i Revizionit për t'i informuar në kohë dhe në mënyrë objektive bartësit e funksioneve publike dhe publikun në lidhje me gjetjet e revizionit nga revizionet e kryera, gjithashtu qëllimi i revizionit është të bëjë të qartë dhe efektive rekomandimet me çka ESHR-ja siguron mbështetje për institucionet shtetërore dhe përdoruesit e mjeteve publike për avancimin në menaxhimin e tyre.

Në përputhje me Ligjin për revizion shtetëror, përfaqësuesi ligjor i subjektit është i detyruar të informojë Entin Shtetëror të Revizionit dhe organin përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin, për masat e ndërmarra në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet në raportet e revizionit në afat prej 90 ditëve nga pranimi i raportit përfundimtar.

Enti Shtetëror i Revizionit e ndjek zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e revizionit në kuadër të kryerjes së revizioneve të rregullta, revizioneve të veçanta dhe kontrollin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe përmes informacionit të marrë nga subjektet.

Me revizionet e kryera për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve (follow-up) në vitin 2020 përvetësuam informacione për zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportin përfundimtar nga vitet e kaluara, duke pasur parasysh statusin e zbatimit të rekomandimeve azhurnohet në mënyrë permanente në bazat për monitorimin e rekomandimeve të ESHR-së në

pajtim informacionet relevante të reja të marra. Në pajtim me këto informacione, nga gjithsej 755 rekomandime të dhëna në raportet përfundimtare të kryera sipas Programit Vjetor për punën e ESHR-së për 2018 për të cilën është vërtetuar statusi, janë ndërmarrë masa për zbatimin e 596 rekomandime, që paraqet 79% veprim sipas rekomandimeve.

Në pajtim me Programin Vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2019, nga gjithsej 429 rekomandime për të cilët është vërtetuar statusi i zbatimit, masat e ndërmarra për 352 rekomandime respektivisht veprime sipas rekomandimeve është 82%.

Me revizionet e kryera nga Programi Vjetor për punën e ESHR-së për vitin 2020, Enti Shtetëror i Revizionit lëshoi 604 rekomandime. Deri në ditën e përgatitjes së Raportit Vjetor për vitin 2020, për 410 rekomandime të dhëna, nuk ka kaluar afati ligjor i njoftimit për masat e ndërmarra. Nga gjithsej 194 rekomandime për të cilat ka skaduar afati i fundit për marrjen e informatave kthyesë për zbatim, 59 janë zbatuar plotësisht, për 83 rekomandime zbatimi është duke vazhduar, 22 rekomandime nuk janë zbatuar, ndërsa 6 rekomandime nuk janë të zbatueshme, dhe për 24 rekomandime statusi nuk është vërtetuar, d.m.th nuk është marrë asnjë përgjigje nga subjekti për të vepruar sipas rekomandimeve.

Në pasqyrat e mëposhtme janë dhënë të dhënat për kategoritë e statusit të masave të ndërmarra pas rekomandimeve të dhëna për vitet 2018, 2019 dhe 2020:


STATUSI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RAPORTET PËRFUNDIMËTARE SIPAS PROGRAMIT VJETOR			
PËR PROGRAMIN VJETOR 2018			
STATUSI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA	Numri i rekomandimeve	Pjesëmarrja në %	
1	Rekomandimet sipas të cilave është vepruar (Zbatuar)	254	34
2	Rekomandimet që zbatimi i tyre është në rrjedh	342	45
3	Rekomandimet sipas të cilave është vepruar pjesërisht (Pjesërisht të zbatuar)	0	0
4	Rekomandimet të cilët nuk janë zbatuar	136	18
5	Rekomandimet të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të rrethanave të ndryshuara (e pazbatueshme)	23	3
Rekomandimet totale për të cilat është vërtetuar statusi i rekomandimeve të dhëna		755	100
6	Rekomandimet për të cilat nuk është vërtetuar statusi Препораки за кои не е утврден статусот (Rekomandimet për të cilat subjekti nuk ka dhënë informata kthyesë për masat e ndërmarra/ nuk janë bërë rishikimet e kontrollit/ revizori nuk ka pas informata të mjaftueshme për ta vërtetuar statusin e rekomandimit).	42	5
Rekomandimet për të cilat afati prej 90 ditëve ka kaluar për dorëzimin e informatave kthyesë		797	
GJITHSEJ REKOMANDIME TË DHËNA		797	

PËR PROGRAMIN VJETOR 2019

PËR PROGRAMIN VJETOR 2019		
STATUSI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA	Numri i rekomandimeve	Pjesëmarrja në %
1 Rekomandimet sipas të cilave është vepruar (Zbatuar)	143	33
2 Rekomandimet që zbatimi i tyre është në rrjedh	209	49
3 Rekomandimet sipas të cilave është vepruar pjesërisht (Pjesërisht të zbatuar)	0	0
4 Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar	73	17
5 Rekomandimet të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të rrethanave të ndryshuara (e pazbatueshme)	4	1
Rekomandimet totale për të cilat është vërtetuar statusi i rekomandimeve të dhëna	429	100
6 Rekomandimet për të cilat nuk është vërtetuar statusi (Rekomandimet për të cilat subjekti nuk ka dhënë informata kthyesë për masat e ndërmarra/ nuk janë bërë rishikimet e kontrollit/ revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme për ta vërtetuar statusin e rekomandimit).	69	14
Rekomandimet për të cilat afati prej 90 ditëve ka kaluar për dorëzimin e informatave kthyesë	498	
GJITHSEJ REKOMANDIME TË DHËNA	498	

PËR PROGRAMIN VJETOR 2020

PËR PROGRAMIN VJETOR 2020		
STATUSI I REKOMANDIMEVE TË DHËNA	Numri i rekomandimeve	Pjesëmarrja në %
1 Rekomandimet sipas të cilave është vepruar (Zbatuar)	59	35
2 Rekomandimet që zbatimi i tyre është në rrydh	83	49
3 Rekomandimet sipas të cilave është vepruar pjesërisht (Pjesërisht të zbatuar)	0	0
4 Rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar	22	13
5 Rekomandimet të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të rrethanave të ndryshuara (e pazbatueshme)	6	3
Rekomandimet totale për të cilat është vërtetuar statusi i rekomandimeve të dhëna	170	100
6 Rekomandimet për të cilat nuk është vërtetuar statusi (Rekomandimet për të cilat subjekti nuk ka dhënë informata kthyesë për masat e ndërmarra/ nuk janë bërë rishikimet e kontrollit/ revizori nuk ka pasur informata të mjaftueshme për ta vërtetuar statusin e rekomandimit).	24	12
Rekomandimet për të cilat afati prej 90 ditëve ka kaluar për dorëzimin e informatave kthyesë	194	
Rekomandimet për të cilat afati prej 90 ditëve nuk ka kaluar për dorëzimin e informatave kthyesë	410	
GJITHSEJ REKOMANDIME TË DHËNA	604	



7

REVIZIONET E KRYERA

7.1 BUXHETI THEMELOR I RMV-së PËR VITIN 2019

Kemi kryer revizionin e pajtueshmërisë së Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 në pjesën e:

- ✘ procedurës për përgatitjen, miratimin dhe menaxhimin e Buxhetit të RMV-së në përputhje me rregullativën ligjore;
- ✘ planifikimit, evidentimit dhe realizimit të shpenzimeve, të daljeve, të ardhurave dhe të hyrjeve të tjera në buxhetin, të paraqitura në raportin financiar bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve;
- ✘ mënyrës së planifikimit dhe mbledhjes së një pjese nga tatimet dhe kapitalet e të ardhurave, evidencat dhe kontrollin e realizimit të tyre, si dhe mënyrën e shkëmbimit të të dhënave me Ministrinë e Financave;
- ✘ procedurave të kontrollit të sistemeve të TI-së për administrimin e tatimeve dhe detyrave të tjera publike të Drejtorisë së të Ardhurave Publike dhe Drejtorisë Doganore të RMV-së, si dhe të Llogarisë së Thesarit dhe të dhënave.

Buxheti Themelor i RMV-së paraqet planin vjetor të të ardhurave, të të hyrave tjera dhe mjeteve të aprovuara nga buxheti, me qëllim që të financohen kompetencat themelore të përdoruesve të buxhetit. Qëllimi kryesor gjatë përgatitjes dhe realizimit të buxhetit është stabiliteti makroekonomik dhe zhvillimi i qëndrueshëm dhe stabil i ekonomisë nacionale.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e pajtueshmërisë së Buxhetit Themelor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me të cilën janë përfshirë përgatitja, miratimi, menaxhimi dhe realizimi i Buxhetit të RMV-së për vitin 2020.

Me Ligjin për buxhete është rregulluar procedura për përgatitjen dhe miratimin e Buxhetit të RMV-së, është përcaktuar mënyra dhe afatet për miratimin e dokumenteve themelore, si instrumente kryesore të cilat paraprijnë për miratimin e Buxhetit të RMV-së.

PËRGADITJA DHE MIRATIMI I BUXETIT TË RMV-SË




Me kryerjen e inspektimit të procedurës për planifikimin dhe miratimin e Buxhetit të RMV-së për vitin 2019, revizioni i konstatoi këto gjendje:

- ✘ rregullativa ligjore e përhershme nuk parashikon pjesëmarrjen e Kuvendit të RMV-së, respektivisht të trupit të pavarur të emëruar nga Kuvendi në procesin e aprovimit dhe miratimit të Strategjisë Fiskale;
- ✘ afati i fundit për dorëzimin e kërkesave buxhetore në Ministrinë e Financave është më i shkurtër për 20 ditë nga afati përfundimtar i përcaktuar me ligj;
- ✘ 76% e përdoruesve të buxhetit kanë dorëzuar plane strategjike si shtojcë të kërkesave buxhetore;
- ✘ te kërkesat buxhetore nuk i kanë bashkëngjitur planet për programet e zhvillimit, të aprovuara nga Qeveria e RMV-së, për shkak të futjes në fuqi të Formularit të ri për konstrukcion financiar të projekteve kapitale shumëvjeçare dhe;
- ✘ Propozimi i Buxhetit të RMV-së për vitin 2019, Qeverisë së RMV-së i është dorëzuar në pasqyrë tabelare, pa Raport për kërkesat e buxhetit jo të miratuar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe përdoruesve të buxhetit.
- ✘ Buxheti i RMV-së për vitin 2019 është miratuar në vlerë prej 155,820,123 mijë denarë, që është për 20,823,141 mijë denarë ose 12% më i ulët në lidhje me mjetet e kërkuara nga përdoruesit e buxhetit, ndërsa në lidhje me buxhetin për vitin 2018, e njëjta gjë është më e lartë për 1%.

Struktura e shpenzimeve në llogaritë e buxhetit themelor në kuadër të Buxhetit të RMV-së për vitin 2019, sipas klasifikimit funksional të shpenzimeve është treguar në grafikun vijues:


Pjesëmarrja e shpenzimeve buxhetor të buxhetit themelor sipas klasifikimit funksional, të paraparë me Buxhetin e RMV-së për 2019



Gjatë vitit 2019, u krye rebalanci i buxhetit, me të cilën janë zvogëluar mjetet e aprovuar për 0.6%, të cilat në pjesën më të madhe përfaqësojnë rialokime të mjeteve ndërmjet përdoruesve të buxhetit. Revizioni rekomandoi gjatë përcaktimit të nevojës për rebalanc të buxhetit të ndiqen përcaktimet e qëllimeve strategjike të Qeverisë.

Të ardhurat totale dhe hyrjet në vitin 2019 janë realizuar në vlerë prej 160,421,708 mijë denarë, pra me 5% më pak krahasuar me vitin 2018 ose 4% më pak krahasuar me shumën e planifikuar për vitin 2019. Përqindja e llojeve individuale të të hyrave dhe të ardhurave tjera në lidhje me të ardhurat totale të realizuara dhe hyrjet në Buxhetin Themelor të RMV-së për vitin 2019 tregohet në grafikun vijues:

Struktura e të hyrave në Buxhetin Themelor të RMV-së për vitin 2019



Pjesë më të madhe në Buxhetin Themelor të RMV-së kanë të hyrat tatimore nën juridiksionin e Drejtorisë Doganore dhe Drejtorisë së të Ardhurave Publike (DAP), të cilat janë realizuar në shumën totale prej 113,734,588 mijë denarë, që është 71% pjesëmarrje në të hyrat e Buxhetit Themelor. Në lidhje me vitin 2018, të ardhurat individuale nga tatimi u rritën, përveç tatimit mbi fitim, i cili u realizua me 22% më pak.

Duke pasur parasysh kompetencat e DAP-së në lidhje me administrimin dhe kontrollin e të ardhurave tatimore dhe detyrimeve publike, imponohet nevoja për të forcuar kuadrin dhe burimet teknike, si dhe avancimin e sistemeve të TI-së së DAP-së.

Me revizionin u konstatua se TVSH-ja e pa mbledhur në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 është më e ulët për 31%, që tregon kohë më të madhe dhe me kohë të mbledhjes së TVSH-së nga tatimpaguesit në shtet. Kërkesat nga ana e tatimpaguesit në lidhje

me kthimin e TVSH-së në vitin 2019 në lidhje me vitin 2018 janë rritur për 72%, që tregon mundësinë që të ardhurat e TVSH-së në vitin 2020 të jenë më të ulëta.


Akcizat, si të hyra nga tatimet, në vitin 2019 janë mbledhur në shumën totale prej 24,708,402 mijë denarë, që është 4% më shumë krahasuar me vitin 2018. Pjesa më e madhe e akcizave nga derivatet e naftës dhe produktet e duhanit.

Në vitin 2019, u kryen vetëm tre kontrolle të obligacioneve të akcizës, gjë që tregon nevojën për të forcuar sistemin e kontrollit të jashtëm.

Me vendosjen e sistemit të TI-së për përpunimin e dokumenteve doganore dhe akcizës, duke filluar nga 01.01.2020, pritet që shumica e dobësive në sistemin e kontrollit të tejkalohen.

Doganat dhe detyrimet doganore në vitin 2019 në Buxhetin Themelor janë mbledhur në vlerë prej 6,032,619 mijë denarë, që është 7.6% më shumë krahasuar me vitin 2018. Grumbullimi në periudhën 2016-2019 tregon një trend në rritje, i cili është rezultat i rritjes së importit të mallrave:

Arkëtimi i doganës dhe detyrimet doganore në periudhën prej 2016-2019



Gjithashtu, u konstatua nevoja për institucionet përgjegjëse për planifikimin dhe mbledhjen e një pjese të të ardhurave kapitale dhe tatimeve, si dhe të ardhurave publike të Buxhetit të RMV-së, për të vendosur evidencën e plotë dhe kontrollin mbi realizimin e tyre, duke monitoruar mbledhjen në kohë, të mbështetur me dokumentacion të kompletuar dhe të besueshëm.

Huamarrja në vend kryet nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë afatshkurtra ose afatgjata, me qëllim mbledhjen e parave. Hyrjet nga huamarrja e brendshme në vitin 2019 janë zvogëluar krahasuar me vitet e mëparshme, përmes së cilës zbatohet politika për emetimin e obligacioneve shtetërore me afate më të gjata, të parashikuara në Strategjinë Fiskale të RMV-së për vitet 2019-2020, me qëllim optimizimin e pagesave dhe të zvogëlojë rrezikun për refinancim.

Të hyrat në lidhje me huamarrjet jashtë vendit u ulën me 75% krahasuar me vitin 2018, kur u evidentuan të hyrat e Eurobondit të lëshuar nga RMV-ja në tregun ndërkombëtar të kapitalit.

Në strukturën e shpenzimeve të kryera dhe daljeve të Buxhetit Themelor të RMV-së për vitin 2019, pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet për transfertat rrjedhëse drejt fondeve jashtëbuxhetore me 22.34%, shpenzimeve për paga, mëditjeve dhe shtesave me 17.83% si dhe transfertave tek njësitë e vetëqeverisjes lokale me 12.57%.

Në kuadër të shpenzimeve dhe daljeve të kryera, rritja më e konsiderueshme është regjistruar në shpenzimet kapitale, respektivisht ato janë realizuar me 33% më shumë krahasuar me vitin 2018, 28% në rezervat dhe shpenzimet e papërcaktuara dhe 18% në mallra dhe shërbime, ndërsa më e rëndësishmja është rënia ripagimet e kapitalit, të cilat janë ulur me 43% krahasuar me vitin 2018, për shkak të shlyerjes së hershme të një pjese të Eurobondit në vitin 2018.

Gjatë vitit 2019 në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, janë transferuar mjete në shumë prej 28,103,027 mijë denarë, respektivisht për 4,40% më pak krahasuar me vitin 2018.

Pjesëmarrja e mjeteve nga Buxheti i RMV-së për mbulimin e deficitit të fondit për pagimin e pensioneve në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2019, ndryshon nga të paktën 23% në vitin 2011 deri 37% në vitin 2017, ndërsa e njëjta në vitin 2019 është 26 %. Deficiti në vitin 2019 ka rënë për 10% krahasuar me vitin 2018, e cila është rezultat i rritjes së normës së kontributit për pensionet dhe sigurimin invalidor në vitin 2019 prej 18% në 18.4%, që tregon sigurimin e të ardhurave më të qëndrueshme për pagesën e pensioneve. Përkundër zvogëlimit të ndjeshëm të deficitit aktual të Fondit, struktura e burimeve të mjeteve për pensionet tregon nevojën për mbështetje financiare të fondit për pagimin e pensioneve në vend me mjete nga Buxheti i RMV-së.


Nga Buxheti Themelor i RMV-së në vitin 2019 përmes ministrive kompetente, si transferta aktuale në NJVL janë realizuar dotacione në shumën totale prej 19,097,285 mijë denarë, që është 12.57% nga shpenzimet totale për vitin 2019, gjatë së cilës pjesëmarrjen më të madhe e kanë bllok-dotacionet me 86.76 %. Komisioni për monitorimin e zhvillimit të

sistemit të financimit të komunave, nuk e monitoron shpërndarjen e dotacioneve si dhe përdorimin e tyre të synuar, në përputhje me kompetencat e përcaktuara, me të cilën nuk siguron kontribut të mjaftueshëm në zhvillimin e sistemit për financimin e komunave.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere në vitin 2019 marrin pjesë me 12.08% në buxhet. Shpenzimet me vlerë më të rëndësishme janë për mbështetjen e bujqësisë, tërheqjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e zonës së lirë ekonomike, mbështetjen financiare të investimeve vendore të fushës së gjelbër, zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, aktivitetet e zgjedhjeve presidenciale në vitin 2019, kthimi i 15% të TVSH-së për qytetarët, duke subvencionuar kontributet e sigurimeve sociale të detyrueshme.

Në Buxhetin Themelor të RMV-së për vitin 2019 janë evidentuar shpenzimet kapitale në vlerë prej 10,166,327 mijë denarë, të cilat janë rritur për 33% krahasuar me vitin 2018, ndërsa realizimi është 86% nga shuma e parashikuar për këtë qëllim. Te shpenzimet kapitale për periudhën 2015-2019, ka tendencë në rënie të shpenzimeve për objektet e tjera të ndërtimit dhe trend në rritje në investimet e mjeteve jofinanciare.

Shpenzimet kapitale të realizuara nga Buxheti Themelor i RMV-së në periudhën 2015-2019



GJITHËSËJ

2019	10.166.327	2017	9.279.236
2018	7.664.861	2016	9.683.179
		2015	10.850.006

Nga maji 2018, Ministria e Financave publikon në faqen e saj të internetit raporte përmbledhëse të detyrimeve të raportuara nga ana e subjekteve. Në vitin 2019, Sektori për Inspektim Financiar nuk ka kryer mbikëqyrjen e detyrimeve të raportuara.

Lidhur me stabilitetin financiar të komunave, u konstatua se në vitin 2019 nuk ishte dorëzuar asnjë vendim për deklarimin e paqëndrueshmërisë financiare nga asnjë komunë, megjithëse 12 komuna i kanë të bllokuara llogaritë, për shkak të të cilave Ministria e Financave nuk ka krijuar trup koordinues për t'i tejkaluar paqëndrueshmëritë financiare të komunave. Kjo situatë kontribuon që komunat të gjenerojnë detyrime të reja, të fillojnë projekte të reja kapitale, të cilat mund të ndikojnë

në përqendrimin e likuiditetit të tyre dhe gjendjen e përgjithshme financiare në të ardhmen, ndërsa me atë edhe mundësinë e nevojës shtesë për të alokuar mjete nga Buxheti i RMV-së si mbështetjen financiare të tyre.

Gjithashtu, revizioni në raportin përfundimtar të revizionit njoftoi për ndikimin e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia globale e virusit KOVID-19 në Buxhetin e RMV-së për vitin 2020, gjegjësisht ndikimi i të ardhurave, shpenzimeve, të hyrave dhe daljeve si dhe i deficitit të shtetit në periudhën e ardhshme, derisa të tejkalohet plotësisht gjendja.

7.2 D R E J T Ë S I A

7.2.1 GJYKATA KUSHTETUESE


Me revizionin e kryer të raporteve financiare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë është konstatuar nevoja për vendosjen e revizionit të brendshëm, kryerjen e regjistrimit të mjeteve të parapara me rregullativën ligjore, evidentimin e materialeve gjatë pranimit dhe dhënies së tyre, si dhe zbatimin e procedurës për furnizime publike gjatë furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve për nevojat e gjykatës.

Procedurat para Gjykatës Kushtetuese fillojnë me iniciativën e një qytetari, një grupi qytetarësh, institucionesh, shoqatash, si dhe mbi vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese për nevojën e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së një ligji dhe kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e rregullores ose aktit tjetër të përgjithshëm. Duke pasur parasysh që Gjykata Kushtetuese nuk ka program dhe orar të punës, nuk përdor softuer

për shpërndarjen automatike të rasteve, nuk ka përcaktim të afatit për caktimin e seancave përgatitore, diskutimeve publike dhe afateve për vendimin përfundimtar për iniciativat e marra, ne përfunduar se nuk janë krijuar kushtet e plota për monitorimin e pandërprerë të efektivitetit në veprimin e iniciativave të marra, efektivitetin në veprimin e secilit gjykatës individual kushtetues si dhe punën e përgjithshme të Gjykatës Kushtetuese.

Është kryer analiza e rishikimeve të punës së Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2015-2019 dhe është arritur në përfundimin se numri mesatar i rasteve të përfunduara është rreth 60%, d.m.th rreth 40% janë raste të papërfunduara nga numri i përgjithshëm i rasteve të pranuar për veprim në këtë periudhë, mandej numri i lëndëve të përfunduara / të papërfunduara sipas viteve tregohet në grafikun vijues:

Statusi i lëndëve për punën e Gjykatës Kushtetuese për periudhën prej 2015 deri vitin 2019



Theksam gjendjen në lidhje me plotësimin e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese të miratuar në tetor 2020, e cila në të ardhmen mund të ketë implikime financiare dhe ndikim në punën e Gjykatës Kushtetuese, me të cilën parashihet se përveç së drejtës së pagës dhe shtesave tjera, gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese të kenë të drejtë për një shtesë për kushtet e veçanta të punës, të ekzistencës së rrezikut të lartë dhe konfidencial.

7.2.2 GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019 së bashku me revizionin e pajtueshmërisë dhe i konstatoi gjendjet si vijon:

Gjendjet kryesore të konstatuara në punën e Gjykatës Supreme të RMV-së kanë të bëjnë me sistemin e AKMIS-it dhe nevojës për të intensifikuar aktivitetet për furnizimin e pajisjeve shtesë të TI-së dhe plotësimin e zgjidhjes softuerike dhe forcimin e burimeve njerëzore për menaxhimin e tij.

Sistemi i AKMIS-it është sistem kompjuterik i automatizuar për menaxhimin me lëndët gjyqësore, i cili përdoret nga të gjitha gjykatat në RMV si aplikacion i vetëm, i unifikuar, me të cilën mbahen evidencat e procedurave gjyqësore, duke filluar nga marrja e dokumenteve, shpërndarja automatike e lëndëve për gjykatësit, deri te arkivimi i secilës lëndë. Për nevojat e sistemit AKMIS, në Gjykatën Supreme është themeluar Qendra e Informatikës, si bazë e të dhënave qendrore për të gjithë avokatët, noterët, përmbaruesit, ndërmjetësit, administratorët e falimentimit, gjykatat, etj., të cilat përsëriten në bazat e të dhënave lokale të AKMIS-it të gjykatave. Gjithashtu, një pjesë përbërëse e këtij sistemi duhet të jetë pjesa e informacionit që

duhet të përdoret për shpërndarjen automatike dhe elektronike të lëndëve në prokuroritë publike, por i njëjti ende nuk është vendosur.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij sistemi, për të gjithë sistemin gjyqësor në vend, revizioni tregon nevojën për të intensifikuar aktivitetet për furnizimin e pajisjeve shtesë të TI-së dhe plotësimin e zgjidhjes softuerike, forcimin e burimeve njerëzore për menaxhimin e tij, integrimin e prokurorive publike në zbatimin e tij, kanë për qëllim funksionimin dhe zbatimin papengësë të sistemit AKMIS nga të gjitha gjykatat dhe prokuroritë në vend.

Gjatë vitit 2020, u miratua Ligji për menaxhim me lëvizjen e lëndëve në gjykata, gjatë të cilit u krye analiza e të dhënave për numrin e lëndëve gjyqësore të pazgjidhura nga vitet e mëparshme, të sapopranuara, të zgjidhura gjatë vitit, si dhe numrit të lëndëve gjyqësore të tjera të pazgjidhura, për periudhën 2017 - 2019 dhe është konstatuar trendi i rritjes së numrit të lëndëve të zgjidhura, i cili nga 59% në vitin 2017 u rrit për 4% dhe në vitin 2019 është 63% i numrit të përgjithshëm të lëndëve për punë, të treguar në detaje për vitet në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	2017	2018	2019
Lëndë të pazgjidhura nga viti paraprak	1.956	1.726	1.422
Lëndë të reja që janë pranuar	2.317	2.189	2.002
Lëndë të zgjidhura	2.542	2.499	2.167
Lëndë tjera të pazgjidhura	1.741	1.416	1.257

Rekomandohet të themelohet trup pune për menaxhimin me lëvizjen e lëndëve në Gjykatën Supreme, funksionimi i të cilit pritet të rrisë efikasitetin në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore.

7.2.3 PROKURORIA PUBLIKE PËR NDJEKJEN E VEPRAVE PENALE TË LIDHURA DHE QË RRJEDHIN NGA PËRMBAJTJA E PËRGJIMEVE TË PALIGJSHËM TË KOMUNIKIMEVE

Me kërkesë të Prokurorisë Themelore Publike për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, kemi kryer revizionin e pajtueshmërisë me temë "Pagat dhe shtesat e pagave dhe shtesat tjera në Prokurorinë Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe që rrjedhin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve (PSP)", për periudhën 2015 - 2019.

Revizioni është kryer me qëllim që të miratohet përfundimi nëse aktivitetet dhe informacioni në lidhje me ushtrimin e së drejtës së pagës, shtesave të pagave dhe shtesave të tjera, saktësia e llogaritjes, evidentimi dhe pagesa e tyre për periudhën prej vitit 2015 deri në vitin 2019, janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret që e rregullojnë këtë fushë.

PSP-ja ishte prokuroria e veçantë në kuadër të sistemit gjyqësor në vend, e pavarur dhe autonome nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kompetencat e PSP-së ishin të kufizuara në vepra penale të lidhura dhe të cilat rrjedhën nga përmbajtja e përgjimeve të paligjshme, të periudhës ndërmjet vitit 2008 dhe vitit 2015.

PSP-ja është themeluar nga Ligji për Prokurorinë Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhën nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve, të miratuar nga Kuvendi i RMV-së më 15 shtator të 2015. Me miratimin e Ligjit për Prokurorinë Publike, më 16.02.2020, të botuar në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" nr. 42/2020, i cili filloi të zbatohet prej 30 qershorit të 2020, Ligji për Prokurorinë Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rrjedhën nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve u shfuqizua, që nënkupton shfuqizimin e PSP-së si subjekt juridik.

Në lidhje me revizionin e kryer, është konstatuar që realizimi i së drejtës së pagës, saktësia e llogaritjes, evidentimi dhe pagesa janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me rregullativën ligjore përkatëse dhe aktet interne.

Gjithashtu u konstatua se përveç shtesave të pagave për vitin 2015, realizimi i së drejtës së shtesave të pagave, saktësia e llogaritjes, evidentimi dhe pagesa janë në përputhje me të gjitha aspektet materiale, me rregullativën ligjore përkatëse dhe aktet interne. Shtesat e paguara për vitin 2015 tejkalojnë shumën e mjeteve të paguara për pagën bazë për person.

Në lidhje me realizimin e së drejtës së shtesave tjera, saktësia e llogaritjes, evidentimi dhe pagesa janë konstatuar se ato nuk janë në përputhje, me të gjitha aspektet materiale, me rregullativën ligjore përkatëse dhe aktet interne. Për periudhën janar 2016 deri në shtator 2019, në lidhje me shtesat tjera që kanë të bëjnë me respektimin e parimit të konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e veçantë të privatësisë, janë paguar mjete në shumën totale prej 282,896 mijë denarë, për të cilat revizioni nuk ka siguruar kriteret të përshtatshme ligjor. Gjendja që ka të bëjë me realizimin e së drejtës për shtesa tjera kanë shkallë të klasifikimit, për të cilën në përputhje me nenin 29 të Ligjit për revizion shtetëror u përgatit raporti i veçantë, në përputhje me Ligjin për informata të klasifikuara.

7.2.4 DREJTORIA PËR MBAJTJEN E LIBRAVE AMË

Është kryer revizioni i raporteve financiare në Drejtorinë për Mbjajtjen e Librave Amë për vitin 2019, bashkë me revizionin e pajtueshmërisë, përmes të cilit konstatuam se edhe në Drejtori në vitin 2012 ka filluar projekti për vendosjen e softuerit për regjistrin amë elektronik, me qëllim të lidhjes elektronike të të gjitha njësive rajonale. Përfundimisht më 31.12.2019, nga gjithsej 175 njësive amë në të cilat mbahen librat amë të të lindurve, të të vdekurve, si dhe librat amë të të martuarve, vetëm 90 janë të lidhur në mënyrë elektronike. Kjo situatë ngadalëson centralizimin e të dhënave për qytetarët, i cili duhet të mundësojë tërësinë e të dhënave si dhe sigurimin në kohë të shërbimeve për qytetarët nga secili vend në shtet, në mënyrë që të shkurtohet koha dhe të ulet kostoja e marrjes së një kërkesë.

Gjatë vitit 2019, Drejtorja lëshoi gjithsej 530,000 certifikata të të lindurve, të të martuarve dhe të të vdekurve, regjistrimin e një të porsalinduri dhe lëshimin e certifikatës së të lindurit nga libri amë, kurorëzimin dhe lëshimin e certifikatës së martesës nga libri amë, kurorëzimin jashtë hapësirave zyrtare të Drejtorisë, regjistrimin e personit të vdekur dhe lëshimin e certifikatës së vdekjes nga libri amë dhe ka realizuar të ardhura në vlerë totale prej 36,254 mijë denarë. Drejtorja nuk ka miratuar procedurë të brendshme me të cilën do të rregullohet procedura për lëshimin e certifikatave dhe kryerjen e shërbimeve të tjera në të mirë të qytetarëve të RMV-së, nëpërmjet definimit të rrjedhjes së aktiviteteve që do të duhet t'i kryejnë punonjësit në Drejtori, me qëllim që të veprojnë në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në procesin e kryerjes së shërbimeve të kërkuara.

Gjatë lëshimit të certifikatës, bëhen gabime gjatë shtypjes së tyre. Numri i përgjithshëm i certifikatave të lëshuara gabimisht në vitin 2019 është 21,957 certifikata, gjegjësisht 4% e certifikatave totale të lëshuara. Drejtorja nuk e ka përcaktuar përgjegjësinë për kompensimin e shpenzimeve në rast të gabimit të bërë gjatë lëshimit të certifikatës, për shkak të të cilave për këto certifikata në vitin 2019 nuk janë realizuar të ardhura të plota në vlerë prej 3,295 mijë denarë (në llogari të Drejtorisë shuma prej 1,099 mijë denarë dhe të hyra për taksë administrative në Buxhetin e RMV-së në vlerë prej 2,196 mijë denarë).

Gjithashtu, Drejtorja nuk disponon me të dhëna për furnizimet dhe lëshimet totale të certifikatave, certifikat totale të gabuara dhe rezervat totale të certifikatave sipas numrit serik, si dhe nuk është përcaktuar përgjegjësia e kompesimit të shpenzimeve në rast të gabimit të bërë gjatë lëshimit të certifikatës, për shkak të këtyre certifikatave në vitin 2019 janë konstatuar të ardhura më të ulëta në llogarinë e Drejtorisë në vlerë prej 901 mijë denarë.

Për një pjesë të procedurave për furnizime publike konstatuam se nuk është siguruar transparencë dhe konkurrencë e plotë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Në pjesën e Theksimit të çështjes së pasigurisë dhe vazhdimësisë zbuluam se gjatë zbatimit të procedurës për furnizimet publike është e nevojshme që Drejtorja në dokumentacionin e tenderit të parashih vetëm dokumentacione dhe kriteret minimale, me qëllim që të sigurohet se operatori ekonomik është në gjendje të ekzekutojë kontratën, gjatë së cilës të gjitha kushtet duhet të jenë të lidhura drejtpërdrejt dhe proporcionale me lëndën e furnizimit publik, përmbajtjen dhe vlerën e saj.

7.3 SHËNDETËSIA


7.3.1 FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR I RMV-së

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2019 të të gjitha çështjeve financiare të Fondit për Sigurim Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSSH).

Me revizionin e kryer është konstatuar dobësia në pjesën e kontrolleve të brendshme që kanë të bëjnë me konfirmimin e realitetit dhe objektivitetit të numrit të faturuar dhe llojeve të kryera të ndërhyrjeve mjekësore të realizuar nga institucionet private shëndetësore, me të cilat Fondi ka lidhur marrëveshje.

Janë përcaktuar parregullsi dhe dobësi në zbatimin e procedurave për trajtimet jashtë vendit për të cilat gjatë vitit 2019 ishin paguar gjithsej 415,012 mijë denarë. Shuma e mjeteve të paguara për këtë qëllim për 6 vitet e fundit është dhënë në grafikun më poshtë.

Shpenzimet e paguara të Fondit për Sigurim Shëndetësor për mjekim në vendet e jashtme të siguruarve (2014-2018)



Burimi: FSSHM

Procedura për trajtimin jashtë vendit është komplekse dhe afatgjate, ku zakonisht është shfaqja e vonesave në vendimet e komisioneve që vendosin në lidhje me kërkesat për trajtim mjekësor jashtë vendit të paraqitur nga pacienti. Duke qenë se këta janë zakonisht persona që kanë probleme serioze shëndetësore, vonesat e tilla janë absolutisht të pajustificuara, pavarësisht nga arsyet për to. Janë konstatuar raste në të cilat komisionet, pa bazë ligjore, i udhëzojnë pacientët për ekzaminime shpesh dhe të panevojshme në institucionin shëndetësor privat (ISHP) në vend që në mënyrë plotësuese e zgjat procedurën, megjithëse me kërkesat e paraqitura komisionet i kanë të gjitha dokumentacionet e nevojshme mjekësore për pacientin specifik në lidhje me të cilin mund të marrin vendimin përkatës. Formimi ligjor i komisioneve që vendosin për kërkesat e marra për trajtim mjekësor nuk siguron mbrojtjen ligjore përkatëse për aplikuesit, ndërsa për këtë procedurë nuk është vendosur sistemi për monitorimin e statusit të trajtimit mjekësor jashtë vendit në afat të gjatë dhe nuk bëhen analizat e suksesit të trajtimit mjekësor në spitalet individuale.


Është konstatua se zbatimi i regjistrimit të mjeteve, kërkesave dhe detyrimeve nuk është i plotë gjithashtu nuk është siguruar futja e të gjitha të dhënave në


listën e regjistrimit dhe harmonizimit të kontabilitetit me gjendjen faktike.


Është zbuluar gjendja që ka të bëjë me mënyrën e përcaktimit të buxhetit vjetor të institucioneve shëndetësore publike (ISHP), dhe në lidhje me raportin e pazgjedhur midis nivelit të shërbimeve të kryera dhe shtesës të tyre nga Fondi, për shkak të të cilave nuk ka blerje reale të shërbimeve nga institucionet shëndetësore publike në mënyrë të parashikuar me Ligjin për sigurim shëndetësor. Gjegjësisht, Fondi është i detyruar të sigurojë fonde për funksionimin e plotë të atyre ISHP-ve që nuk janë në gjendje të realizojnë vëllim të mjaftueshëm të shërbimeve ose të përshtaten në sistemin ekzistues të vlerësimit të shërbimeve shëndetësore, në vend që të kompensojë shërbimet shëndetësore të kryera aktualisht. Si rezultat i kësaj, ISHP-të nuk janë në gjendje të shërbejnë plotësisht dhe në kohë detyrimet e tyre ndaj furnizuesve që çojnë në krijimin e borxhit.

Në mënyrë që të përcaktohet efekti i pandemisë aktuale të KOVID - 19 kemi kryer analizë të borxhit të ISHP-së që nga shtatori i vitit 2020, që është paraqitur në infografikën si vijon:

Lëvizja e borxhit të maturuar bashe me borxhin dhe detyrimet e pamaturuar të ISHP për periudhën 2014 -2020



 Lëvizja e borxhit të maturuar 2014-2020 shtator

 Lëvizja e borxhit dhe detyrimet e pamaturuar 2014- 2020 shtator

+15%

Përfshirë shtatorin 2020 konstatuam rritje të borxhit të maturuar të ISHP për 15% në krahasim me 2019

-12%

Përfshirë shtatorin 2020 konstatuam zvogëlimin e borxhit dhe detyrimeve të pamaturuar të ISHP për 12% në krahasim me 2019.

7.3.2 INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE

Me Programin Vjetor për punën e Entit Shtetëror të Revizionit për vitin 2020 u përfshin ISHP-të nga kujdesi dytësor shëndetësor të ofruar përmes spitaleve të përgjithshme në fushën e: mjekësisë interne me kardiologji, kirurgjisë së përgjithshme, gjinekologjisë dhe obstetrikës, sëmundjes pediatrike, urologjisë, ortopedisë dhe traumatologjisë, infektologjisë dhe neuropsikiatrisë, si dhe veprimtarisë konsultative dhe spitalore të specialistit në fushën e sëmundjeve të mushkërive tek fëmijët.

Në kushtet e pandemisë të shkaktuar nga virusi korona këto ISHP përkundër aktiviteteve të rregullta të punës gjatë vitit 2020 si qendra Covid, një pjesë e punës së tyre u ridedikua në trajtim të pacientëve me virusin KOVID - 19.

Me revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së ISHP-ve për vitin 2019, ndër të tjera u konstatua gjendja që në pjesën më të madhe përsëritet si dhe në periudhën e mëparshme raportuese dhe i referohen:

- ✘ dobësive në sistemin e kontroleve të brendshme në pjesën e procedurave të shkruara për konfirmimin e vërtetësisë dhe objektivitetit të dokumentacionit financiar, aktiviteteve të kontrollit gjatë lidhjes së marrëveshjeve për furnizimet publik, llogaritjen dhe pagimin e pagave dhe kompetencave dhe përgjegjësisë të definuara të personave të përfshirë në proces;
- ✘ parregullsive në regjistrimin e zbatuar të mjeteve dhe detyrimeve;
- ✘ mungesës së evidencës së plotë dhe të azhurnuar të pajisjeve mjekësore dhe sistemit të vendosur efikas për monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre;
- ✘ parregullsive në mënyrën e evidentimit të mjeteve të marra përmes donacionit; parregullsive në evidentimin e barnave të mbetura dhe materialit të shpenzuar mjekësor;
- ✘ të drejtës së papërcaktuar për përdorim të përhershëm të objekteve të ndërtimit dhe tokës dhe mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për përdorim dhe disponim me sende në pronësi

shtetërore dhe me sende në pronësi komunale gjatë dhënies me qira të ndërtesave;

- ✘ plotësisë së pasigurt të të hyrave për shërbimet shëndetësore të kryera;
- ✘ shërbimeve shëndetësore të kryera dhe të paguara për pacientët privatë dhe të huaj pa akt / listë çmimesh të miratuar nga personi udhëheqës dhe pajtimit të siguar nga ministri kompetent;
- ✘ mosprezantimit të Dokumentacionit të rregulluar dhe të besueshëm (raporteve fiskale mujore, tremujore dhe vjetore) për mjetet e evidentuara dhe të mbledhura në thesar në lidhje me shërbimet e dhëna shëndetësore;
- ✘ nuk janë marrë aktivitete për pagesën në kohë të kërkesave për shërbimet shëndetësore të kryera;
- ✘ pagesave jo në kohë të detyrimeve;
- ✘ nuk është siguruar respektimi i qëndrueshëm i dispozitave të Ligjit për furnizime publike në procedurat për dhënie e marrëveshjeve për furnizime publike dhe monitorimin e realizimit të marrëveshjeve të lidhura.

Në pjesën e theksuar të çështjes për pasiguri dhe vazhdimësi, revizioni njofton për kërkesat e papaguara të ISHP-ve nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimet shëndetësore të kryera sipas Programit për Mbrojtje Shëndetësore nga vitet e mëparshme për të cilat me Programet për vitin 2019 nuk janë paraparë mjete për pagimin e kërkesave nga vitet e kaluara për shkak të të cilave pagesa e këtyre kërkesave nga ministria kompetente në periudhën e ardhshme është e pasigurt.

7.4 EFEKTET NGA PANDEMIA KOVID - 19

7.4.1 NDARJA E MARRËVESHJEVE PËR FURNIZIMET PUBLIKE NGA INSTITUCIONET NË SEKTORIN PUBLIK ME QËLLIM PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA PANDEMIA TË SHKAKTUAR NGA VIRUSI KORONA - KOVID - 19

Në kushtet e pandemisë dhe gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur nga organet kompetente, shkaktoi që sistemi për furnizime publike të mos ishte përjashtim nga ndryshimet që ndodhën në shumë fusha, si në jetën e përditshme, ashtu edhe në funksionimin e institucioneve të sektorit publik. Njëherazi, kjo gjendje ka rritur përgjegjësinë gjatë zbatimit të furnizimeve publike, sepse mbrojtja e shëndetit dhe jetës së qytetarëve varet drejtpërdrejt prej tyre, për shkak të së cilës institucionet në një periudhë të shkurtër kohore zbatuan furnizime urgjente me shfrytëzimin e procedurës me bisedime pa shpallur konkurs. Duke e pasur parasysh këtë Enti Shtetëror i Revizionit në Programin Vjetor për vitin 2020 konstatoi revizionin e pajtueshmërisë me temë: Ndarja e marrëveshjeve për furnizime publike nga institucionet në sektorin publik me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen nga pandemia të shkaktuar nga virusi korona - KOVID-19.

Organet kontraktuese në kushte të tilla përdorin zgjidhje jo standarde duke kryer furnizime urgjente që rrisin rrezikun e mosrespektimit të disa prej parimeve themelore gjatë ndarjes së marrëveshjeve për furnizime publike, respektivisht sigurimin e ekonomisë, efikasitetit, konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, transparencës, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe proporcionalitetin gjatë ndarjes së marrëveshjeve për furnizime publike.

Në bazë të revizionit të kryer të procedurave për furnizime publike të cilat janë ndarë në periudhën prej 01.03.2020 deri më 01.10.2020 me qëllim të mbrojtjes dhe parandalimit nga virusi korona KOVID-19, si dhe analizës së kushteve të punës gjatë kohës së pandemisë me të cilën përballen institucionet në sektorin publik, u konstatua kjo si vijon:

- ✘ 88% e furnizimeve janë zbatuar me shfrytëzimin e procedurës me bisedime pa e publikuar shpalljen. Në mungesë të definimit të saktë të kriterëve për "urgjencën" e furnizimeve dhe llojin e mallrave, shërbimeve dhe punëve që mund të furnizohen në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme / krizës nuk mund të konfirmohet plotësisht justifikimi i urgjencës së disa pjesëve të procedurave;
- ✘ Për shkak të natyrës urgjente të furnizimit, faza e planifikimit të procedurave nuk mund të kryhej në kohën sipas nevojës, gjë që ndikon në dorëzimin e ftesave për të biseduar me një numër më të vogël të operatorëve ekonomikë, pa analiza të hollësishme të llojit dhe sasive të mjeteve dhe pajisjeve për mbrojtje të disponueshme në treg;
- ✘ Në mungesë të definimit të qartë të karakteristikave të pajisjeve mbrojtëse që do të përdoren nga personeli mjekësor në ISHP, lloje të ndryshme të pajisjeve u shfaqën në treg dhe u blenë për të cilat ekziston rreziku që ato të mos kenë karakteristika dhe cilësi për mbrojtjen dhe parandalimin përkatës në proceset e punës të cilat zhvillohen gjatë kohës së pandemisë;
- ✘ disa pjesë nga dokumentet e tenderit janë përgatitur në mënyrë që nuk u siguron operatorëve ekonomikë informacion të plotë dhe të saktë në lidhje me mënyrën e zbatimit të procedurave për furnizime publike;
- ✘ mënyra e vendosjes së zbatimit të procedurave me negociimin pa publikimin e shpalljes nuk mundëson trajtim dhe konkurrencë të barabartë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Në të vërtetë, për disa pjesë nga procedurat për furnizime publike janë zbatuar bisedimet me një operator ekonomik;

- ✘ disa nga institucionet gjatë zbatimit të procedurave nuk kanë publikuar njoftim në sistemin elektronik për furnizimet publike për transparencë vullnetare paraprake dhe as për njoftimin e anulimit të procedurës për furnizime publike që ndikon në përgjegjësinë dhe integritetin në procedurat për furnizime publike;
- ✘ janë konstatuar gjendje të cilat ndikojnë në objektivitetin gjatë vlerësimit të ofertave, në pikëpamje të kushteve dhe kërkesave të organeve kontraktuese, që ndikon në trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe kufizimin e konkurrencës;
- ✘ janë konstatuar mospajtueshmëri ndërmjet marrëveshjeve të ndara për furnizimet publike dhe dokumentacionit të tenderit dhe specifi-

kimeve teknike, që e vështirëson monitorimin e realizimit nga aspekti nëse janë çmimet e faturuara në përputhje me kontraktuesit;

- ✘ Gjatë realizimit të disa marrëveshjeve, nuk është vendosur sistemi përkatës i kontrollit me të cilin do të sigurojë se aktivitetet e parapara janë realizuar plotësisht.

Për tejkalimin e gjendjes së konstatuar, ndër të tjera, ESHR-ja propozon për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për furnizime publik, me të cilin do të siguronte zbatimin e shtuar të parimeve themelore gjatë ndarjes së marrëveshjeve për furnizimet publike.

7.4.2 MARRJA E NDIHMËS JO FINANCIARE, SHPËRNDARJA DHE PËRDORIMI NGA INSTITUCIONET NË SEKTORIN PUBLIK ME QËLLIM PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA PANDEMIA TË SHKAKTUAR NGA VIRUSI I KORONËS - COVID-19

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e pajtueshmërisë me temë "Marrja e ndihmës jo financiare, shpërndarja dhe përdorimi nga institucionet në sektorin publik me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen nga pandemia të shkaktuar nga virusi i koronës COVID-19" për periudhën prej 01.03.2020 deri më 30.11.2020, ndërsa çështje dhe ngjarje të caktuara janë përfshirë dhe mbuluar deri në ditën e njoftimit nga revizioni i kryer.

Paraqitja e pandemisë të shkaktuar nga virusi i koronës COVID-19 shkaktoi çrregullime të konsiderueshme të rrjedhave shoqërore ku me kapacitetet ekzistuese në sistemin shëndetësor duhet të përgjigjet dhe parandalohet përhapja e pandemisë.

Në kushte të tilla te sistemi shëndetësor u rrit nevoja për mjetet mbrojtëse mjekësore dhe pajisjeve mjekësore që nga ana e një numri të madh të qytetarëve, personave juridikë, dhuruesve

të jashtëm dhe organizatave ndërkombëtare kanë dhënë solidaritet me dhurimin e pajisjeve, mallrave dhe parave në mbështetje të trajtimit të situatës së shkaktuar nga pandemia.

Për të konfirmuar gjendjen e dhurimeve të marra të destinuara për trajtimin e virusit të koronës COVID-19, mënyrën e përdorimit dhe trajtimit të tyre, evidentimin dhe kontrollin mbi to, me revizion u përfshin institucionet si vijojnë: Ministria e Shëndetësisë (MSH), Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (SSO), Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE) si dhe 23 institucione të shëndetit publik.

Me revizionin e kryer të realizimit të aktiviteteve, masave dhe politikave në pjesën e planifikimit, pranimin, shpërndarjes, evidentimit dhe kontrollit mbi ndihmën e marrë jo-financiare tek institucionet kompetente, u konstatua:

- ✘ Ligji për mbrojtje dhe shpëtim nuk e rregullon mbrojtjen e popullatës nga paraqitja e epidemive, epizootikëve, epifitozës, me të cilat

zvogëlon mundësinë e përcaktimit të rreziqeve nga fusha, identifikimin e burimeve ekzistuese dhe planifikimin e nevojës për sigurimin e tyre, përfshirë edhe ndihmën nga donatorët ndërkombëtarë;

- ✘ Asnjë Strategji Nacionale për Mbrojtjen dhe Shpëtimin nuk është miratuar me plan veprim që synon parandalimin, zvogëlimin e pasojave dhe gatishmërinë e sistemit për mbrojtjen dhe shpëtimin;
- ✘ Plani për gatishmërinë gjatë trajtimit me emergjencat, gjendjes së krizave dhe katastrofave të miratuar nga MSH-ja si aktivitet i rëndësishëm nuk rezultoi në zbatimin aktiv të aktiviteteve të planifikuara para fillimit të pandemisë;
- ✘ Mungesa e përgjegjësive të përcaktuara qartë nga institucionet e përfshira në procesin e pranimit, menaxhimit (ruajtjes, sigurimit) dhe kontrollit të dhurimeve të huaja për t'u përballur me pasojat e COVID-19 ndikon në mundësinë e trajtimit joadekuat dhe keqpërdorimit të tyre;
- ✘ Nuk është vendosur evidentimi i kontabilitetit dhe materialeve në MSH dhe DBSH për donacionet e marra për trajtimin e pandemisë së virusit COVID-19;
- ✘ Është kryer shpërndarja e donacioneve pa përcaktimin e kriterëve që shkakton se dhënia e donacioneve nga DBSH të mos jetë në përputhje me përcaktimet e shpërndarjes nga MSH-ja;
- ✘ Nuk është vendosur mekanizmi i vetëm qendror për marrjen e donacioneve nga donatorët e huaj në nivelin nacional;
- ✘ ISHP-ja nuk i ka azhurnuar rregullisht të dhënat për pajisjet mjekësore në kuadër të sistemit nacional të informacionit shëndetësor, i cili duhet të kontribuojë në vlerësimin dhe planifikimin e nevojave të dhurimit si përgjigje gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, emergjencave ose krizave;
- ✘ Ekipimi i pamjaftueshëm i kuadrit brenda një-sive organizative për menaxhimin e dhurimeve në MSH dhe DBSH, mungesa e autorizimeve

me kompetenca të vendosura në SÇE, si dhe demarkacioni i pamjaftueshëm i detyrave të punonjësve të përfshirë në procesin e marrjes, kontrollit dhe shpërndarjes së dhurimeve;

Nga aspekti i ISHP-së si përdorues i donacioneve të marra dhe të shpërndara, revizioni i konstatoi gjendjet si vijojnë:

- ✘ në disa raste nuk janë lidhur marrëveshje për dhurim dhe nuk janë përgatitur raporte për dhurimet e marra;
- ✘ një pjesë e ISHP-së nuk kanë caktuar person përgjegjës për trajtimin, shpërndarjen dhe kontrollin mbi përdorimin e dhurimeve të marra;
- ✘ nuk është përgatitur akti për mënyrën e marrjes dhe trajtimit me dhurimet e marra të pajisjeve dhe mjeteve mbrojtëse mjekësore për trajtimin me virusin COVID-19;
- ✘ disa nga ISHP-të nuk kanë vendosur evidentimin e kontabilitetit të dhurimeve të marra për trajtimin me pandeminë e COVID-19, ndërsa disa mbajnë të dhëna të kontabilitetit dhe / ose evidentimin e materialeve vetëm për dhurimet për të cilat kanë marrë vlerë, ndërsa për disa janë vendosur evidencë vetëm sipas sasive.

Gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme dhe krizave, transparencja përfshin spektër të gjerë të aktiviteteve të informimit publik dhe në kohë. Ndarja në kohë e informacioneve është jashtëzakonisht e rëndësishme për shkak të presionit të pritur nga mediet, veçanërisht në kushtet e gjendjes së urgjencës, të jashtëzakonshme dhe të krizës.

Në pjesën e transparencës së informacioneve për donacionet e marra jofinanciare nga institucionet, u përcaktua se palë të interesuara dhe qytetarë nuk kanë pasqyrë të plotë në të dhënat për donacionet e marra jo-financiare në vend të dedikuar për përballimin me pandeminë e theksuar, me të dhëna për dhuruesin, lëndën e dhurimit, vlerën financiare si dhe për qëllimin e dhurimit.

Për tejkalimin e gjendjes së konstatuar, është e nevojshme të ndërmerren aktivitete për: rregullim të qartë dhe të saktë të sistemit për të vepruar në gjendje krize me përcaktimin e institucioneve kompetente dhe koordinimin e tyre të ndërsjellë në drejtim të gatishmërisë së shtetit gjatë paraqitjes së gjendjes së krizës, vendosjen e mekanizmit të vetëm qendror për dhurimet e marra nga donatorë të huaj, vendosjen e evidencës së kontabilitetit dhe materialeve për donacionet, si dhe kontrollin mbi dispozicionin e donacioneve të marra nga donatorët vendas dhe të huaj.



7.5 PUNË DHE SOCIALE

7.5.1 FONDI PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR I RMV-së

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, me çka konstatoi:

- ✘ sistemi i kontrolleve të brendshme në procesin e ushtrimit të të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor (SPI) dhe procesi i pagesës së të ardhurave nga pensioni është rregulluar me disa akte dhe procedura të brendshme individuale me të cilat nuk janë përfshirë të gjitha hapat për organizimin dhe mënyrën e kryerjes së punëve. Mungon ndarja e plotë e kompetencave dhe përgjegjësi të punonjësve të përfshirë në proceset për shkak të mungesës së punonjësve, ndërsa vendosjet e kontrolleve të brendshme nuk ofrojnë gjithmonë konfirmimin e të dhënave të futura me saktësi dhe në kohë në procedurë. Për shkak të së theksuarës rritet rreziku nga parregullsitë në procedurën për njohjen e të drejtave nga SPI-ja, si dhe rreziku i pagimit të pensionit edhe pas skadimit të së drejtës së përcaktuar ligjërisht;
- ✘ Fondi po përballet me mungesë të kapaciteteve të kërkuara të kuadrit si: aktuarë, punonjës të TI-së dhe mjekë specialistë në Komisionin për Vlerësimin e Aftësisë së Punës;
- ✘ Dobësitë në ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave në evidentimin amë e pamundësojnë verifikimin e besueshmërisë dhe plotësisë së të dhënave të regjistruara, të nevojshme për realizimin e të drejtave nga SPI-ja. Gjithashtu, është cenuar dhe vihet në dyshim realizimi i të drejtave personale dhe materiale afatgjata të disa prej personave të siguruar që nuk kanë mekanizma për të dëshmuar kontributin e paguar për një periudhë të caktuar në sigurim;
- ✘ Për shkak të mosmarrjes së të dhënave të përshtatshme për punësimin dhe regjistrimin e obligacioneve, si dhe gabimeve gjatë futjes së të dhënave nga institucionet tjera, në llogarinë e pagesës të destinuar për mbledhjen e mjeteve nga kontributi i mbledhur për SPI, nuk është kryer shpërndarja e mjeteve në vlerë prej 141,855 mijë denarë të cilat Fondi nuk mund t'i përdorë, ndërsa i siguruari nuk mund të ushtrojë të drejtat nga SPI-ja;
- ✘ Mekanizmat e pamjaftueshëm për mbledhjen e detyruar të dëmeve të përcaktuara për shkak të pagesës së pabazuar të pensioneve për të cilat evidentohen kërkesat nga qytetarët dhe përqindja e ulët e kthimit të mjeteve të më shumë të paguara, udhëzon në pasiguri për pagimin e tyre në periudhën e ardhshëm;
- ✘ evidentimi i papërgjegjshëm i tokës dhe objekteve ndërtimore, si dhe të vendimeve për shlyerjen e kërkesave në bazë të kontributeve të papaguara ka efekt të paraqitjes joreale dhe jo-objektive të mjeteve në raportet financiare;
- ✘ Shkalla dhe intensiteti i pamjaftueshëm i dixhitalizimit dhe arkivimit elektronik të dokumenteve nga shiritat e mikrofilmit në periudhën e kaluar ndikon në përdorimin racional të mjeteve.


Në pjesën e theksimit të pyetjes për pasiguri dhe vazhdimësi, revizioni zbuloi për:

- ✘ gjendjen e dobët financiare në të cilën gjenden ndërmarrjet për hotelieri, pushim dhe rekreacion të pensionistëve Borec në Manastir, themeluesi i së cilës është Fondi dhe
- ✘ tërheqjen e pabazë të mjeteve nga llogaria e Fondit në vitet 2018 dhe 2019 në shumën totale prej 19,056 mijë denarë nga përmba-ruesit në bazë të urdhrave të ekzekutimit, në të cilat si detyrues u paraqiten përdoruesit e pensioneve.

Në pjesën Çështje të tjera është njoftuar për strukturat dhe niveli i të ardhurave të realizuara në periudhën njoftuese gjegjësisht rritjen e tyre si rezultat i ndryshimeve në Ligjin për SPI dhe zvogëlimin e pjesëmarrjes së mjeteve të transferuara nga Buxheti i RMV-së, të cilat tregohen në grafikun vijues:

Struktura e të ardhurave të Fondit

në 000 denarë



Të ardhurat nga kontributet e paguara për SPI në vitin 2019 janë rritur për 10% në krahasim me atë të mëparshmen, gjë që ndikohet ndjeshëm nga ndryshimet në Ligjin për SPI nga dhjetori 2018, në përputhje të cilit janë realizuar të hyrat në shumën totale prej 4,354,800 mijë denarë në bazë të kontributeve të rimbursuara me kthime nga kompanitë private të pensioneëve. Rritja e realizuar e të ardhurave në vitin 2019 ende nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për beneficionet sociale, të cilat gjithashtu po rriten nga viti në vit. Pikërisht, shpenzimet për beneficionet sociale (pagesa e të ardhurave nga pensioni së bashku me kontributin për sigurimin shëndetësor të pensionistëve, transferimet në shtyllën e dytë pensionale dhe invalidore) në vitin 2019 arrijnë në 72,708,394 mijë denarë për gjithsej 333,722¹ përdorues të pensioneëve të pranuar dhe të njëjtit janë për 6,7% më e lartë në krahasim me vitin 2018.

Për të mbuluar deficitin e mjeteve për pagimin e pensioneëve në vitin 2019, janë transferuar mjete nga Buxheti i RMV-së në vlerë prej 28,098,207 mijë denarë, përmes:

- ✘ Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në vlerë totale prej 27,644,110 mijë denarë, prej të cilave 15,644,110 mijë denarë për të mbuluar deficitin e Fondit për pagimin e pensioneëve dhe 12,000,000,000 denarë për të mbuluar detyrimet ligjore në bazë të SPI² dhe
- ✘ Ministrisë së Mbrojtjes, në vlerë prej 454,097 mijë denarë³.

Revizioni në vazhdimësi i ka theksuar dobësitë në vendosjen e sistemit për përcaktimin, kontrollin dhe mbledhjen e kontributeve të cilat prej vitit 2009 janë kryer nga ana DAP-së pa u bërë sigurimi i plotë i azhurnimit dhe integritetit të saktë dhe shkëmbimit në kohë të të dhënave nga institucionet. Për shkak të së theksuarës Fondi nuk ka të dhëna të plota dhe të sakta për kërkesat në bazë të kontributit të papaguar nga SPI dhe nuk kanë kompetenca për pagesën e tyre, që ndikon në të ardhurat e kompletuara dhe realizimit të së drejtës nga SPI të personave të siguruar për të cilët nuk janë paguar kontributet.

- 1 324,039 përdorues të pensionit, 9,597 përdorues të kompensimit me para për lëndime të lehta trupore dhe 86 përdorues të kompensimit me para me aftësinë e punës të mbetur.
- 2 Mjete për pagimin e pensioneëve për përdoruesit e pensioneëve minimale bujqësore, pensionet ushtarake dhe përdoruesit tjerë, si dhe për transferime në shtyllën e dytë të pensioneëve.
- 3 Mjete për pagimin e pensioneëve për përdoruesit me beneficione të përvojës së punës, në përputhje me Ligjin për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

7.5.2 PLANIFIKIMI I QEVERISË - EFIKASITETI I MASAVE TË QEVERISË PËR BALLAFAQIMIN ME RREZIQET E TREGUT TË PUNËS DHE MËNYRËN E PLANIFIKIMIT TË MJETEVE PËR TEJKALIMIN E TYRE - REVIZIONI PARALEL NDËRKOMBËTAR

Revizioni i suksesit me temë "Planifikimi i Qeverisë - Efektiviteti i masave qeveritare për ballafaqimin me rreziqet e tregut të punës dhe mënyrën e planifikimit të mjeteve për tejkalimin e tyre", për periudhën 2017 - 2020, është zbatuar në disa institucione, si vijon: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (APRMV), Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH), Enti Shtetëror i Statistikës, Oda Ekonomike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Kryetarit të Qeverisë së RMV-së, Ministria e Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë Shkup dhe Ministria e Ekonomisë.

Revizioni është pjesë përbërëse e aktiviteteve të përcaktuara me revizionin paralel ndërkombëtar me temë: **"Fuqia punëtore 2030 - A është vendi juaj gati?"** ndërsa iniciativa për fillimin e revizionit paralel rrjedhë nga Plani Strategjik 2017 - 2023 i EUROSAL. Në revizionin paralel morën pjesë gjithsej 8 (tetë) Institucione Supreme të Revizionit, si vijon: Izraeli, Finlanda, Italia, Bullgaria, Polonia, Republika e Maqedonisë së Veriut, Gjykata Evropiane e Revizionit (ECA) dhe Koreja e Jugut.

Qëllimi i revizionit ishte t'i përgjigjej pyetjes: **A janë politikat, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente efektive dhe**

kontribuojnë në rritjen e punësimit, përmirësimin e aftësive në përputhje me kërkesën e tregut të punës dhe mbajtjen e stafit duke ofruar mundësi cilësore për punësime duke pasur parasysh burimet e disponueshme të institucioneve dhe mënyrën e përdorimit të tyre?".

Lëvizjet e tregut të punës janë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe punësimin në RMV. Qeveria e RMV-së i përcakton përparësitë strategjike, politikat dhe masat e zhvillimit, si dhe mënyrën e financimit të përparësive strategjike në mënyrë që t'i tejkalojë ndryshimet ndërmjet kërkesës dhe ofertës së fuqisë punëtore, ndërsa me të dhe të zvogëlojë papunësinë.

Informacioni themelor statistikor i nevojshëm për analizën dhe monitorimin e ndryshimeve në tregun e punës janë të dhënat për popullsinë totale që punon, popullsinë aktive, punësimin dhe papunësinë në RMV. **Shkalla e papunësisë në RMV në vitin 2019 ishte 17.3%** e cila ra për 5.1% në krahasim me vitin **2017, e cila** është pjesërisht për shkak të niveleve të ulëta të aktivitetit.

Shkalla e papunësisë në RMV, krahasuar me shkalla e papunësisë në rajonin, BE, si dhe vendet e Eurozonës, janë të paraqitura në grafikun vijues:

Shkallë e papunësisë								
Viti	BE	Evro-zonë	Serbia	Bullgaria	Shqipëria	Greqia	Kroacia	Maqedonia e Veriut
2017	7,6%	9,1%	13,5%	6,2%	13,8%	21,5%	11,2%	22,4%
2018	7,3%	8,2%	12,8%	5,2%	12,3%	19,3%	8,5%	20,7%
2019	6,7%	7,6%	10,5%	4,2%	12,3%	17,3%	6,6%	17,3%


Ndikimi i COVID-19 në gjendjen e tregut të punës

Përkundër trendit të zvogëlimit gradual të shkallës së papunësisë në vitin 2019, me shfaqjen e pandemisë COVID-19, kushtet në tregun e punës ndryshojnë ndjeshëm dhe marrin tregues plotësisht të ri. Pandemia COVID-19 është intensifikuar dhe zgjeruar në drejtim të shtrirjes së saj globale, me ndikime të mëdha në shëndetin publik dhe goditje të papara në ekonominë dhe tregjet e punës. Pandemia po shkakton një ndikim të fortë edhe

në zhvillimin ekonomik në RMV. Kriza ka ndikimin më të madh në bizneset e vogla dhe të mesme, veçanërisht ato që merren me artizanat, tregti, turizëm, hotelieri, etj.

Reduktimet e paparashikuara të aktivitetit ekonomik shkaktojnë ulje të punësimit, përkatësisht hyrjen te personat e papunë nga më shumë sektorë. **Sipas aktivitetit mbizotërues të punëdhënësit** struktura është si vijon:

Fluksi i PERSONAVE TË PAPUNË sipas veprimtarisë me gjendjen e ngarkuar të 31.08.2020



Me revizionin e kryer janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

Në fushën e kornizës juridike, dokumenteve strategjike dhe vendosjes së institucioneve në krijimin dhe zbatimin e politikave të tregut të punës, u konstatuan gjendja si vijon:

- ✘ Në kuadër të Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë, i cili rregullon çështjet për shkëmbimin e punës, përgatitjet, mbajtësin / institucionin kompetent dhe periudhën e miratimit të planit operativ si dokument vjetor operativ për programet dhe masat aktive të punësimit nuk janë rregulluar plotësisht;
- ✘ Te dokumentet themelore strategjike që krijojnë politikën në fushën e tregut të punës dhe sistemit arsimor që synojnë rritjen e punësimit dhe cilësinë e vendeve të punës, ka zbatim jo të plotë të qëllimeve të vendosura strategjike, si rezultat i realizimit të pamjaftueshëm në lidhje me vendosjen e treguesit në disa aktivitete të planifikuara në kompetencën e APRMV-së dhe MASH-it.


Në fushën e masave, aktiviteteve dhe efekteve për përmirësimin e punësimit në RMV janë përcaktuar gjendjet si vijojnë:

- ✘ Gjatë inspektimit të planifikimit dhe krijimit të masave dhe aktiviteteve për tregun e punës, është konstatuar se nuk janë miratuar procedurat të brendshme ose udhëzues për rregullimin dhe përshkrimin më të hollësishëm të procesit të planifikimit. Planifikimi nuk bazohet në analiza të hollësishme për qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e programeve dhe masave aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës të cilat janë realizuar në vitet e kaluara me të cilat do të konfirmonin përfitimet ose dobësitë e tyre;

- ✘ Zhvillimi i Observatorit të shkathtësive si mjet në MASH përmes të cilit është planifikuar të analizohet përshtatshmëria e aftësive të cilat i posedojnë nxënësit dhe studentët në lidhje me nevojat e tregut të punës është përfunduar, por e njëjta nuk prodhon të dhëna dhe pavarësisht që fillimi me punë dhe gjenerimi i raporteve parashikohet çdo vit në periudhën prej 2017-2020 në kuadër të planifikimit, programit dhe dokumenteve strategjike të MASH, por edhe në shumë dokumente të tjera të rëndësishme strategjike. Vonesa në zbatimin e aktiviteteve të parapara me Observatorin e shkathtësive si mjet strategjik për analizimin e përshtatshmërisë së aftësive në korrelacion me nevojat e tregut të punës reflektohet në krijimin e politikave arsimore dhe të punësimit;
- ✘ Të rinjtë në RMV përballen me vështirësi gjatë tranzicionit nga arsimi në tregun e punës, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të papunë në afat të gjatë, me çka i humbin njohuritë dhe aftësitë e fituara, produktiviteti i tyre ulet, dhe kështu mundësitë për të gjetur punë. Arsimi cilësor i bazuar në analizën e nevojave për njohuri, aftësi dhe kompetenca është i nevojshëm për të zvogëluar mospërputhjen e aftësive me nevojat e tregut të punës. Duke pasur parasysh të theksuarën është e nevojshme të ndërmerren aktivitete shtesë për të forcuar më tej reformat në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në mënyrë që të prodhojmë personel që do të plotësojë nevojat e tregut të punës.

Duke analizuar periudhën e pritjes deri në punësimin e të rinjve, u zbulua se rreth 70% e njerëzve janë të punësuar për një periudhë deri në 11 muaj, ndërsa 24% e të rinjve janë duke pritur për punësim për një periudhë prej 1 deri në 3 vjet.

PERIUDHA E PRITJES PËR PUNËSIM



- ✘ Revizioni konstatoi se ekziston një qasje mjaft e koordinuar dhe sistematike për krijimin e politikave dhe monitorimin e procesit të zbatimit të qëllimeve dhe aktiviteteve të parashikuara që synojnë tejkalimin e trendit të daljes së vazhdueshme të personelit me arsim të lartë i cili bëhet një problem serioz që ndryshon furnizimin e fuqisë punëtore dhe kontribuon në rritjen e mos pajtueshmërisë me kërkesën e fuqisë të punës.

Në fushën e përdorimit të burimeve dhe aktiviteteve të kontrollit gjatë zbatimit të politikave dhe masave aktive për punësime u konstatuan gjendjet si vijojnë:

- ✘ numri i madh i vendeve të lira të punës në shërbimin qendror të APRMV-së dhe ngarkesa me lëndë, e imponon nevojën për të forcuar kapacitetin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e tyre të vazhdueshëm për zbatimin e suksesshëm të politikave dhe masave të punësimit dhe për të arritur rezultatet dhe efektet e dëshiruara në tregun e punës në tërësi;
- ✘ mjetet financiare janë parakusht i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të masave dhe shërbimeve të planifikuara aktive në tregun e punës. Edhe përkundër faktit se kanë trend në rritje në nivel vjetor, pjesëmarrja e tyre në shpenzimet totale të APRMV-së po zvogëlohet, për llogarinë e mjeteve të realizuar për Masat Pasive të Punësimit;
- ✘ dobësitë në pjesën e tërësisë së provave dhe mungesa e kontrolleve të rregullta në terren në disa nga lëndët e testuar për masat dhe politikat aktive (APM) udhëzojnë te gjendja që devijojnë nga aktivitetet e parapara të rregulluara me Udhëzimet Operative dhe marrëveshjet e lidhura me të cilat rregullohet secila masë. Asnjë aktivitet nuk është ndërmarrë për të rregulluar kompetencën për të kryer monitorimin, si dhe për të futur vlerësimin e detyrueshëm të programeve, masave dhe shërbimeve në kuadër të ligjit ekzistues.

Si rezultat i gjendjes së konstatuar, revizioni e nxori përfundimin si vijon:

Politikat, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk janë mjaft efektive për të siguruar punësim dhe aftësi në përputhje me kërkesën në tregun e punës dhe për tejkalimin e trendit nga largimet e vazhdueshme të personelit nga vendi. Ekziston nevoja për veprim të koordinuar dhe forcimin e aktiviteteve të institucioneve kompetente në fushën e krijimit të politikave dhe masave në drejtim të rritjes së punësimit, përmirësimin e aftësive në përputhje me kërkesën e tregut të punës dhe mbajtjen e stafit duke ofruar mundësi pune cilësore.



7.6 ARSIMI

7.6.1 MINISTERIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS


Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e elementeve të raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, të cilat përbëhen nga elemente të Bilancit të të Ardhurave dhe Shpenzimeve: Shpenzimet kapitale, Programi T - Investimet në arsim në pjesën e Programeve për ndërtimin dhe rikonstruimin e shkollave fillore dhe të mesme, konvikteve të studentëve dhe të nxënësve, nga llogaria e buxhetit themelor (637) për vitin 2019.

Revizioni konstatoi dobësi në mënyrën e definimit të programeve për ndërtimin dhe rikonstruimin e shkollave fillore dhe të mesme, konvikteve të studentëve dhe të nxënësve, përkatësisht të njëjtit nuk përbajnë të dhëna për llojin e objekteve,

llojin e aktiviteteve investuese dhe vlerën e tyre individuale. Zgjedhja e projekteve bëhet pa kritere të qarta, të matshme dhe jo-diskriminuese, të cilat do të përcaktojnë përparësitë në aktivitetet e infrastrukturës, duke përcaktuar: nevojën për ndërhyrje, faktorin demografik përkatësisht numrin e nxënësve, kushtet e punës, nivelin e zhvillimit të rajonit dhe tregues të tjerë të cilat do të krijojnë kushte për zgjedhje objektive.

Për ndërtimin dhe rikonstruimin e shkollave fillore dhe të mesme, konvikteve të studentëve dhe të nxënësve, në vitin 2019 janë realizuar aktivitete në vlerë prej 115,850 mijë denarë, që paraqet 36% shfrytëzim në krahasim me mjetet e aprovuara të buxhetit prej 321,895 mijë denarë për këto dedikime.

Investime të planifikuara dhe të realizuara në Nënprogramet në vitin 2019



TA - Ndërtimin e shkollave fillore, **TB** - Rikonstruimi i shkollës fillore, **TG** Ndërtimin e shkollave të mesme, **TD** - Rikonstruimi i shkollave të mesme, **TK** - ndërtimin dhe rikonstruimin e konvikteve studentor, **TI** - Rikonstruimin e konvikteve të nxënësve

Kushtet e pasiguruara për fillimin në kohë të punëve të ndërtimit, mospasiguri në kohë të lejes për ndërtim, ndërprerjet e punimeve të ndërtimit, punimet e paparashikuara, lëshimet e projektuesit dhe revidentit, e komplikojnë procesin e realizimit të planeve dinamike dhe e prolongojnë afatin për realizimin e punëve të ndërtimit edhe për disa vite. Zbatimi i dobët i aktiviteteve të programit ka ndikim në arritjen e qëllimeve themelore strategjike për të cilat është dedikuar financimi, ndërsa ato janë përmirësimi i kushteve për mësimdhënie në arsimin fillor dhe të mesëm dhe përmirësimi i kapacitetit për akomodim në konviktet e studentëve dhe të nxënësve.

Revizioni konsideron se Departamenti i Investimeve Kapitale në kuadër të ministrisë, i cili kontrollon dhe monitoron zbatimin e programeve të investimeve, ka nevojë për ekipim me persona profesionalistë për të kontrolluar punën e bërë nga fazat e instalimeve termike dhe elektrike, të cilat në pjesën më të madhe përfaqësohen në punimet e ndërtimit.

Për shkak të parregullsive në veprimin me materialin e dokumentuar dhe të arkivuar në ministri, nuk është siguruar mbikëqyrja sistematike e dokumenteve, menaxhimi, ruajtja dhe përdorimi i tyre, që krijon rrezikun e humbjes së dokumentacionit.

Për tejkalimin e gjendjes së konstatuar personat përgjegjës në ministri duhet të ndërmarrin aktivitete në drejtim të: rafinimit të programeve, vendosjes së procedurës me kritere të qarta për zgjedhjen objektive të objekteve, sigurimin e kushteve për zbatimin e plotë dhe në kohë të ndërtimeve, riekupimin e Departamentit për Investimet Kapitale dhe vendosjen e punës së arkivimit në përputhje me dispozitat ligjore.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve për pasiguri dhe vazhdimësi, ne theksuam situatën se realizimi i punimeve të ndërtimit pa zgjidhje të përshtatshme afatgjata, materiale ndërtimore cilësore dhe zgjidhje funksionale kanë efektin e performancës së dobët, për shkak të së cilës, në periudhë të shkurtër kohore paraqitet nevoja për përsëritjen e rikonstruimit/ sanimit, ndërsa me to edhe shpenzimet e papërshtatshëm të mjeteve buxhetore.

7.6.2 BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2019, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, janë konstatuar, në pjesën e zbatimit të kompetencave të Byrosë në pjesën e zhvillimit dhe avancimit të edukimit dhe arsimit në shtet, si dhe në pjesën e veprimtarisë botuese në lidhje me zhvillimin e veprimtarisë edukativo-arsimore, është konstatuar:

- ✘ Byroja nuk ka vendosur sistem të informacionit dhe bazën e të dhënave për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm, arsimin special, arsimin për nxënësit me nevoja të veçanta dhe arsimin për të rritur, si detyrim e cila rrjedh nga Ligji për Byronë për Zhvillimin e Arsimit, që ndikon në mundësinë për shkëmbimin dhe përdorimin e

informacionit dhe të dhënave nga institucionet kompetente, në mënyrë të avancimit të cilësisë së sistemit arsimor në shtet;

- ✘ Byroja duhet të botojë revistë shkencore-profesionale "Reflektime Arsimore" të paktën dy herë në vit, me punime shkencore dhe profesionale në fushën e arsimit, por që nga viti 2012 nuk është përgatitur dhe botuar, që ndikon në mundësinë e rezultateve të kërkimeve shkencore në fushën e arsimit të paraqitet para publikut shkencor, në mënyrë të rritjes së transparencës për arritjet shkencore në fushën e arsimit dhe zbatimit të tyre në sistemin arsimor në shtet.

7.6.3 ARSIMI I LARTË

Gjatë vitit 2020 Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2019 në tre njësi të Universitetit Shën Cirili dhe Metodi, përkatësisht tre fakultete, si vijon: Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, Fakulteti i Shkencave të Informatikës dhe Inxhinierisë Kompjuterike dhe Fakulteti i Farmacisë, Shkup. Me revizion u konstatuan gjendjet si vijojnë:

- ✘ Janë konstatuar dobësitë në sistemin e kontrolleve të brendshme për monitorimin dhe kontrollin e dokumentacionit të kontabilitetit pa kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë dhe të definuar në lidhje të konfirmimit të plotësisë dhe besueshmërisë së transaksioneve dhe nuk janë miratuar procedura për lëvizjen e dokumentacionit. Gjithashtu, nuk është miratuar procedura për përcaktimin dhe mbledhjen e të ardhurave të realizuara në baza të ndryshme në

kuadër të veprimtarisë së arsimit të lartë. Kjo gjendje është karakteristikë për tre subjektet e reviduara.

- ✘ Janë konstatuar dobësi në llogaritjen dhe pagimin e pagave në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore dhe Fakultetin e Farmacisë. Te Fakulteti i Shkencave të Informatikës dhe Inxhinierisë Kompjuterike janë konstatuar dobësi në pagimin e mëditjeve për udhëtimet zyrtare jashtë vendit.
- ✘ Te Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore janë konstatuar dobësi nga aspekti i kontabilitetit si dhe regjistrimit të mjeteve të kryera në mënyrë jo të plotë, kërkesave dhe detyrimeve në përputhje me dispozitat ligjore, regjistrimi jo i plotë i kryer është karakteristikë edhe për Fakultetin e Shkencave të Informatikës dhe Inxhinierisë Kompjuterike.

Në tre fakultetet e reviduara nuk është vendosur politika e kontabilitetit për evidentimin e pranimit dhe daljes së materialeve, respektivisht materialeve të blera nuk janë evidentuar përmes llogarive të tepricës së materialeve dhe kapitalit të mbetur. Për të njëjtit nuk bëhen detyrime dhe kthimi i materialeve që nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Kontabilitetin e Buxheteve dhe Përdoruesve të Buxhetit dhe Rregullores për Kontabilitetin e Buxheteve dhe Përdoruesve të Buxhetit. Nuk është kryer regjistrimi i tepricave të materialeve për gjendjen më 31.12.2019 me të cilën nuk është konfirmuar gjendja e tepricave me të cilat disponojnë fakultetet.

Janë konstatuar dobësitë në zbatimin e Ligjit për furnizime publike, të cilat i referohen dokumentacionit të nevojshëm të pasiguar për të provuar aftësinë personale të operatorëve ekonomikë në Fakultetin e Farmacisë.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve për pasigurinë dhe vazhdimësinë, revizioni e paraqiti gjendjen e miratimit të parakohshëm të statuteve dhe akteve të tjera të përgjithshme që rrjedhin prej tij, përkatësisht pajtueshmërinë e tyre jo në kohë me ndryshimet në rregullativën ligjore që krijon mundësi për punën e jo pajtueshmërinë e punës së universiteteve dhe njërive të përhershme në përbërjen e tyre.

7.6.4 KONVIKTI SHTETËROR I STUDENTËVE "TOME STEFANOVSKI SENIQ" - SHKUP

Me revizionin e kryer të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2019 u konstatua si vijon:

- ✘ e drejta e papërcaktuar e shfrytëzimit të përhershëm të tokës dhe objekteve të ndërtruara;
- ✘ zbatimi jo i plotë i regjistrimit të mjeteve dhe detyrimeve;
- ✘ parregullsitë në zbatimin e normativave për përgatitjen e ushqimit për përdoruesit e shërbimeve të KSHS-së;
- ✘ zbatimi joadekuat i rregullave ligjore me të cilën rregullohet mënyra e llogaritjes dhe pagesës së pagave dhe shtesave të pagës;
- ✘ mosrespektimi i parimit të kontabilitetit të deklarimit të pareve;
- ✘ kërkesa të paevidentuara të studentëve në evidencën e kontabilitetit;
- ✘ zbatimi jo i rregullt i akteve për përcaktimin e

çmimit për akomodim dhe ushqim të studentëve;

- ✘ nuk është vendosur sistemi i evidentimit të kontabilitetit kronologjik dhe të azhurnuar të tepricës së materialeve;
- ✘ evidentimi jo i plotë i kërkesës për TVSH-në e paguar më shumë;
- ✘ parregullsitë në pagesën e shtesave të anëtarëve të KD-së;
- ✘ parregullsitë në zbatimin e akteve ligjore, gjegjësisht akomodimin e shfrytëzuesve / punëtorëve të jashtëm në objektet e dedikuara për studentët dhe nxënësit;
- ✘ Mossigurimi i respektimit të denjë të dispozitave të Ligjit për furnizime publike në procedurat e zbatuara.

7.7 M J E D I S I J E T Ë S O R

7.7.1 EFIKASITETI I MASAVE DHE I AKTIVITETEVE PËR SHFRYTËZIMIN E LËNDËVE MINERALE DHE ARKËTIMIN E KOMPENSIMEVE

Është kryer revizioni i suksesit me temë **"Efektiviteti i masave dhe i aktiviteteve për shfrytëzimin e lëndëve minerale dhe arkëtimin e kompensimeve"**

me qëllim që t'i përgjigjet pyetjes: "A sigurohet efektiviteti me masat dhe aktivitetet për përdorimin e lëndëve minerale dhe arkëtimin e kompensimeve në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm"?

Përfshirja dhe provat të cilat janë siguruar përmes zbatimit të teknikave dhe metodologjisë nga revizioni, ofrojnë bazë për të shprehur përfundimin si vijon:

Masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk janë të mjaftueshme për të siguruar menaxhim efektiv të lëndëve minerale, në lidhje me shfrytëzimin optimal të tyre dhe arkëtimin efikas të kompensimeve të koncesionit, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Mungesa e planifikimit strategjik afatgjatë, ndryshimet dhe plotësimet e shpeshta të dispozitave ligjore, mungesa e akteve nënligjore, bashkëpunimi i pamjaftueshëm institucional dhe


vendosja jo e plotë e bazës së të dhënave elektronike nuk sigurojnë bazë stabile për udhëheqjen e politikave efektive.

Afatet jo të sakta dhe marrëveshjet e lidhura jo në kohën e duhur e shtyjnë kohëzgjatjen e procedurave prej të cilave ndahen koncesionet për lëndët minerale, që ka implikime negative në interes të subjekteve, ndërsa rregullimi i pasaktë i detyrimeve kontraktuese për koncesionarët nuk sigurojnë mbrojtje juridike të koncesionarit, në rast të mosrespektimit të tyre.

Sistemi i vendosur për arkëtimin dhe evidentimin e kompensimeve të koncesionit nuk siguron plotësinë e të ardhurave dhe nuk ofron mundësi për të kontrolluar llogaritjet, që është kufizim në kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit të plotësisë dhe besueshmërisë së të ardhurave nga kompensimet e koncesionit.



Numri i koncesioneve dhe arkëtimi i shtesave në bazë të sasisë së eksploatuar



Si rezultat i kësaj gjendjeje, për periudhën 2016 - 2020, u konstatuan më pak kompensime të arkëtuara të koncesionit në vlerë prej 32,562 mijë denarë ose 529,018 euro, nga të cilat: 13,582 mijë denarë në bazë të hapësirës dhe 18,980 mijë denarë në bazë të lëndës minerale të eksploatuar.

Për të njëjtën periudhë, jo në kohë, gjegjësisht, me vonesë janë arkëtuar gjithsej 695,202 mijë denarë, pra 11,294,584 euro (83,487 mijë denarë në bazë të hapësirës dhe 611,715 mijë denarë në bazë të eksploatimit të lëndëve minerale), për të cilat Ministria e Ekonomisë nuk ka llogaritur interesin e parazgjedhur ligjërisht as për një koncesionar.

Prej katër lëndëve koncesionare të kontrolluar, tre kryejnë gërmimin e lëndëve minerale jashtë lejes për eksploatim që e posedon në sipërfaqe totale prej 25,546 m².

Koncesionarët përdorin llogaritje të ndryshme, gjegjësisht disa prej tyre nuk tregojnë dhe paguajnë kompensimin për sasinë e metalit të argjendit dhe në koncentratin e plumbit dhe zinkut, që ka për efekt më pak kompensime të llogaritura dhe të paguara koncesionit.

Kryerja e mbikëqyrjes inspektuese pa definuar kritere për zgjedhjen e subjekteve, realizimi jo i plotë i mbikëqyrjes së inspektimeve të rregullta të planifikuara, pjesërisht të kryera të mbikëqyrjeve inspektuese pas vendimeve të lëshuara për eliminimin e parregullsisë, mungesa e laboratorit të pavarur të akredituar, mungesa e mjeteve financiare dhe e pajisjeve nuk sigurojnë kushte për kontrollin efektiv.

Në drejtim të tejkalimit të gjendjeve të konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes në pjesën e: vendosjes juridike dhe institucionale të sistemit të menaxhimit me lëndët minerale, funksionalitetit dhe efektivitetit të procedurave për ndarjen / marrjen e koncesioneve për lëndët minerale, arkëtimin e kompensimeve të koncesionit dhe mekanizmin e vendosur për mbikëqyrjen dhe kontrollin në punën e koncesionerëve, ndërsa me qëllim shfrytëzimin optimal të lëndëve minerale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

7.7.2 TRAJTIMI DHE MENAXHIMI EFIKAS ME HEDHURINAT PLASTIKE

Revizioni i suksesit me temë "Trajtimi dhe menaxhimi efikas me hedhurinat plastike" është pjesë nga revizioni kooperativë e cila është zbatuar në koordinim me institucionet tjera supreme të revizionit⁴. Iniciatori për zbatimin e revizionit është EUROSAT WGEA⁵, ndërsa në vitin 2021 do të botohet raporti i përbashkët. Revizioni e përfshinë periudhën 2017-2019.

Qëllimi i revizionit të suksesit është t'i përgjigjet pyetjes "A menaxhohet me hedhurinat plastike në mënyrë që e mundëson atë të zvogëlohet dhe arrijtes së qëllimeve të vendosura"?

Parimet kryesore në menaxhimin e hedhurinave janë:

- 1 parimi i hierarkisë
- 2 zhvillimi i qëndrueshëm
- 3 "Ndotësi paguan"
- 4 parimi i kujdesit
- 5 parimi i përgjegjësisë së prodhuesit
- 6 parimi i ciklit jetësor të produktit.



Zgjedhja më e mirë



Zgjedhja më e keqe

Hierarkia e menaxhimit të hedhurinave

Në sistemin për menaxhimin me hedhurinat plastike janë përfshirë më shumë institucione, si vijon: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor - Drejtoria e Mjedisit Jetësor, Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, Qendrat Rajonale për Menaxhim me Hedhurinat, Ndërmarrjet Publike, Personat Juridikë dhe Fizikë të Formuar për Kryerjen e Veprimtarive Komunale, Grumbulluesit Individualë të Hedhurinave, Përpunuesit e Hedhurinave, Personat Juridikë për të vepruar me hedhurinat nga paketimet, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor dhe institucionet e tjera.

- 4 Pjesëmarrësit në projekt janë institucionet supreme të revizionit të vendeve në vijim: Polonia, Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Malta, Moldavia, Republika e Maqedonisë së Veriut, Portugalia, Rumania, Serbia, Sllovakia dhe Turqia.
- 5 EUROSAT WGEA -Grupi i Punës i Revizionit Mjedisor (grupi i punës për revizionet e mjedisit jetësor të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Revizionit).

Me rregullativën ligjore në fushën është paraparë të miratohen një numër i madh strategjik i dokumenteve planifikuese dhe programuese në nivelin qendror, lokal dhe rajonal, për të cilat u konstatua se disa prej tyre nuk janë miratuar ose janë me afat të skaduar. E gjithë kjo, të udhëzon në pengesa gjatë vendosjes së sistemit integruar për menaxhimin me hedhurinat. Gjithashtu, megjithëse janë filluar aktivitete të caktuara, menaxhimi me hedhurinat rajonale ende nuk është vendosur, me çka nuk janë krijuar kushtet themelore për parandalimin e krijimit të hedhurinave dhe përpunimit të tyre.

Nuk është vendosur përzgjedhja funksionale primare dhe sekondare dhe pranimi i kthimit të hedhurinave plastike, si parakushte themelore për përpunimin e tyre. Sasia e grumbulluar e hedhurinave plastike në vend është e vogël, ndërsa i njëjti zakonisht përfundon në depo. Të dhënat nga institucionet kompetente tregojnë se sasia e mbledhur e hedhurinave plastike të zgjedhura në vend është minimale dhe përfaqëson rreth 14% të mbetjeve totale të mbledhura në një vit dhe për pjesën më të madhe është rezultat i veprimeve të ndërmarra nga vepruesit kolektivë dhe sektori joformal (mbledhësit individualë). Një nga arsytet e kësaj gjendjeje është numri i papërshtatshëm i enëve të vendosura për përzgjedhjen e hedhurinave, që është i parëndësishëm në lidhje me numrin e banorëve dhe indeksin e hedhurinave të gjeneruara. Më pak se 1% e hedhurinave totale të grumbulluara në RMV riciklohen. Gjithashtu, nuk janë ndërmarrë iniciativa dhe aktivitete për ripërdorimin e hedhurinave plastike, ndërsa i mungojnë stimuluesit e masave për të mbështetur përpunuesit e hedhurinave.

Vepruesit kolektivë kanë vend qendror në

sistemin e menaxhimit me hedhurinat plastike. Ato i lidhin prodhuesit / importuesit që vendosin në treg produktet dhe paketimet që në fund të ciklit të tyre jetësor krijojnë hedhurina që rëndojnë mjedisin jetësor, me persona juridikë dhe fizikë që mbledhin dhe transportojnë hedhurina plastike, dhe në të njëjtën kohë janë të detyruar të sigurojnë përpunimin ose asgjësimin e sasisë së marrë dhe të grumbulluar të hedhurinave plastike.



Sektori joformal i mbledhjes së hedhurinave

në RMV paraqet grup social prej disa mijëra njerëzve, duke përfshirë edhe fëmijët, të cilët mbledhin dhe vlerësojnë pjesë të hedhurinave përmes aktiviteteve të cilat nuk janë të organizuara dhe të mbështetura. Me revizionin e kryer konstatuam se në rregullativën ligjore, sektori joformal pothuajse fare nuk përmendet, përveç në pjesën e evidentimit të tyre si zbatues të tregtisë me hedhurina. Nuk janë rishikuar mundësitë për formalizimin dhe organizimin e tyre përmes ndërmarrjes sociale ose partneritetit publiko-privat, i cili do t'u siguronte të ardhura të qëndrueshme dhe legalizimin e aktiviteteve të tyre.

Në RMV, grumbullimi dhe transporti i hedhurinave komunale pothuajse tërësisht kryhet nga ndërmarrjet komunale publike të themeluara nga komunat dhe Qyteti i Shkupit, për të cilat kanë marrë leje nga ministria kompetente. Ne kemi konstatuar se NPK nuk posedon numër të mjaftueshëm të automjeteve speciale që përdoren për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinave nga paketimet (hedhurinat e selektuara), ndërsa për shkak të gjendjes

financiare në të cilën ndodhen, disa prej tyre nuk janë në gjendje të sigurojnë të reja.

Për vendosjen dhe funksionimin e sistemit të integruar për menaxhimin e hedhurinave, është e nevojshme të sigurohen mjete financiare të qëndrueshme që do të sigurojnë të ardhura të rregullta dhe të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet. Mjetet financiare të realizuara në bazë të Programit Vjetor për investime në mjedisin jetësor, si dhe tarifave të mbledhura (menaxhimi i paketimit të hedhurinave, qeset për transportin e mallrave dhe menaxhimin e hedhurinave) nuk mundëson qëndrueshmërinë e sistemit nga ana e atyre që krijojnë hedhurina, gjë që ndikon në menaxhimin e hedhurinave plastike dhe nuk lejon zbatimin e parimit "ndotësi paguan".

Shuma e vogël e kompensimit të paguar për administrimin e hedhurinave nga paketimi në llogarinë e thesarit është për shkak të mundësisë së dhënë ligjore që tatimpaguesit të lirohen nga pagesa e kompensimit nëse ata kanë lidhur marrëveshje me veprues kolektiv për të marrë përsipër detyrimet për menaxhimin e hedhurinave nga paketimi. Vepruesi kolektiv është i detyruar të përdorë fitimin e realizuar për të përmbushur qëllimet nacionale duke mbledhur dhe përpunuar ose ricikluar hedhurinat e krijuara nga paketimi. Në raportin e revizionit është konstatuar se vepruesit kolektivë, në mënyrë të pavarur, pa kufizime, vendosin

për mënyrën e përdorimit të të ardhurave të realizuara. Shuma e arkëtuar e tarifave, pavarësisht nëse paguhen në llogarinë e thesarit ose tek vepruesit kolektivë janë të ulëta, duke udhëzuar në mjete të pamjaftueshme financiare për të promovuar aktivitete për mbledhjen, transportimin, përpunimin dhe asgjësimin e hedhurinave nga paketimi.

Sistemi i vendosur i evidencave dhe informacioneve nuk ofron informacion të plotë, të saktë dhe të azhurnuar në lidhje me lejet e lëshuara, si dhe hedhurinat e grumbulluara, të përpunuara dhe të deponuara. Ka mungesë të aktiviteteve për monitorimin e menaxhimit me hedhurinat në nivel nacional dhe lokal, si dhe aktivitetet mbikëqyrëse nga institucionet kompetente nuk janë të përfaqësuara sa duhet.

Për tejkalimin e gjendjes së konstatuar revizioni dha rekomandime për përmirësimin e gjendjeve në fushën e menaxhimit, trajtimit dhe përdorimit me hedhurinat plastike në funksion të zvogëlimit të tyre dhe arritjes së qëllimeve të përcaktuara.

7.7.3 EFIKASITETI I MASAVE DHE I AKTIVITETEVE PËR LËSHIMIN E B-LEJEVE TË INTEGRUARA

Industria ka një vend të rëndësishëm në zhvillimin dhe stabilitetin e ekonomisë nacionale dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit, rritjen e eksportit dhe përmirësimin e jetës sociale të popullsisë. Ajo merr pjesë me rreth 21%⁶ në strukturën e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Degët e Industrisë më të përfaqësuara në vendin tonë janë: metalurgjia, industria kimike-farmaceutike, ndërtimtaria, industria përpunuese (prodhimi i ushqimit dhe pijeve dhe produkteve të tjera ushqimore, prodhimi i lëkurës dhe produkteve të ngjashme prej lëkure, prodhimi i letrës dhe të tjera).

Përmes veprimtarive të tyre, kapacitetet industriale emetojnë substanca ndotëse në ujë, ajër dhe tokë dhe kanë ndikim të madh në cilësinë e mjedisit jetësor, jetës dhe shëndetit të njeriut.

Masat dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor janë me interes publik, për shkak që kërkon një qasje të integruar të veprimit. Me qëllim për t'u njoftuar me gjendjen në vend nga fusha - parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes (PKIN), u krye revizioni i suksesit për t'iu përgjigjur pyetjes **"A mundësohet me B-lejet integruese ekologjike parandalimi dhe kontrolli i ndotjes së mjedisit jetësor nga aktivitetet industriale"**?

Lidhur me lëshimin e lejeve të integruara ekologjike dhe zbatimin e tyre në parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, janë përfshirë më shumë institucione, si vijon: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor - Drejtorja e Mjedisit Jetësor, Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, operatorët me instalimet dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, Qyteti i Shkupit dhe disa prej komunave kanë ndërmarrë masa dhe aktivitete për vendosjen e regjimit për lëshimin e lejeve të integruar ekologjike, por mungon sistemi efektiv për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, i cili do t'i përfshijë në tërësi kapacitetet industriale dhe mekanizmin e kontrollit i cili do të monitorojë nëse ata sipas kapacitetit të vet duhet të posedojnë Leje të Integruar Ekologjike (LIE). Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Revizionit, në vitin 2019 ka 75,914 subjekte afariste aktive që janë të shpërndarë në 19 sektorë të veprimtarisë sipas Klasifikimit Nacional të Veprimtarive, por numri i subjekteve të biznesit që kryejnë veprimtari për të cilat është e nevojshme B-LIE nuk është i njohur.

Ndikimet e pavalitshme në cilësinë e mjedisit jetësor kanë instalime të përhershme të cilat posedojnë Leje për Pajtueshmëri me Planin Operativ (LPP0) dhe ende nuk kanë përmbushur detyrimet nga planet operacionale, për shkak se te ata nuk janë krijuar kushtet për lëshimin e B-LIE. Ata edhe me tej vazhdojnë të paraqesin rrezik me aktivitetet e tyre për t'i tejkaluar vlerat e lejueshme kufitare për praninë e substancave ndotëse.

Nevojiten ndryshime në dispozitat dhe zbatimin e disa prej akteve nënligjore ekzistuese me qëllim që të sigurohet përgatitja e barabartë dhe e saktë e B-LIE, dhe kështu të arrihet mbrojtja më e madhe e mjedisit jetësor.

6 Të dhënat janë marra nga Strategjia për Mjedisin Jetësor dhe Ndryshimet Klimatike 2014 - 2020.

Në periudhën 2017 - 2019, nga ana e subjekteve lëndë e revizionit janë arkëtuar kompensime në vlerë totale prej 7,419 mijë denarë. Për shkak të interpretimeve të ndryshme dhe mënyrës së zbatimit të akteve nënligjore, janë konstatuar ndryshime në mënyrën e llogaritjes së kompensimit, që çon në trajtimin e pabarabartë të operatorëve të instalimit, të cilët janë të detyruar ta paguajnë atë. Te pjesa më e madhe e subjekteve me kërkesë nga operatorët e instalimeve nuk është vendosur evidenca e kontabilitetit, që nuk mundëson monitorimin e tyre dhe arkëtimin e rregullt. Mungesa e evidencës përkatëse nuk mundëson në rast të kërkesave të paarkëtuara, paralajmërimin në kohë ose marrjen e lejes.

Dispozitat ligjore nuk japin udhëzime të sakta për shpenzimet e dedikuara të kompensimeve të arkëtuara, ndërsa subjektet nuk dorëzuan provë për shfrytëzimin e tyre dhe pa asnjë arsye të definuar me rregullativën ligjore.

Monitorimi i brendshëm i instalimeve në pjesën më të madhe është vendosur nga ana e operatorëve, por informacionet nga ai nuk dorëzohen deri te ministria kompetente. Nuk është vendosur rrjet për monitorim në nivelin nacional dhe lokal, për shkak të të cilit nuk është e mundur të monitorohet plotësisht gjendja në lidhje me instalimet industriale, si dhe ndikimi i tyre në cilësinë dhe ndryshimet në mediumet dhe fushat e mjedisit jetësor. Aktivitetet mbikëqyrëse të institucioneve kompetente nuk janë të përfaqësuara sa duhet, që ndikon në zbulimin, parandalimin dhe kontrollimin në kohë të ndotjes së mjedisit jetësor të shkaktuar nga instalimet industriale.

Gjendja e theksuar nuk mundëson kontroll të plotë të ndotjes dhe respektimin e parimeve të mjedisit jetësor: "shkallë e lartë e mbrojtjes", "përkujdesje", "parandalim", ndërsa në të njëjtën kohë ndikojnë në respektimin e pasaktë dhe jo të plotë të parimit "ndotësi paguan".

Si rezultat i gjendjes së konstatuar, fushëveprimi dhe provat që janë siguruar përmes zbatimit të teknikave dhe metodologjive të përshtatshme të revizionit, Enti Shtetëror i Revizionit përfundoi se, masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga ana e institucioneve kompetente për lëshimin e B-lejeve të integruara ekologjike nuk janë efektive të mjaftueshme për vendosjen e sistemit të integruar për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes nga aktivitetet industriale dhe respektimin e plotë të parimit për mjedisin jetësor.

7.7.4 REVIZIONI I MASAVE TË NDËRMARRA (FOLLOW UP), PAS REKOMANDIMEVE TË DHËNA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR PËR REVIZIONIN E SUKSESIT PREJ 12.03.2019, ME TEMË "EFEKTIVITETI I POLITIKAVE, MASAVE DHE AKTIVITETEVE GJATË NDARJES SË TË DREJTAVE TË UJIT"

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna të përfshira në Raportin Përfundimtar për revizionin e kryer të suksesit për vitin 2019 me temë "Efektiviteti i politikave, masave dhe aktiviteteve gjatë ndarjes së të drejtave të ujit", me qëllim që të vlerësohet shkalla e zbatimit të rekomandimeve dhe përshtatshmëria e masave të ndërmarra.

Me revizionin e kryer është miratuar përfundimi se nga ana e subjekteve të përfshira nuk janë ndërmarrë aktivitete dhe masa për zbatimin e rekomandimeve, për të cilat ekziston nevoja për të ndërmarrë aktivitete në periudhën e ardhshëm për t'i zbatuar ato.

Revizioni konstatoi se:

- ✘ nga 19 rekomandime të dhëna subjekteve në nivelin qendror, (Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor), 1 rekomandim është zbatuar, 2 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 9 rekomandime nuk janë zbatuar, dhe zbatimi i 7 rekomandimeve është në rrjedhë;
- ✘ nga 11 rekomandime të dhëna subjekteve në nivel lokal (komuna dhe ndërmarrje publike), 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 2 rekomandime nuk janë zbatuar dhe zbatimi i 5 rekomandimeve është në rrjedhë.

Veprimi jo i plotë në lidhje me rekomandimet e dhëna në Raportin Përfundimtar të revizionit të autorizuar shtetëror shkakton mjete më pak të paguara në Buxhetin e RMV-së në vlerë prej të paktën 204,713 mijë denarë ose të shprehur në euro


prej 3.3 milion euro si kompensim i papaguar për të drejtat e ujit nga ana e ndërmarrjeve publike dhënësi i shërbimeve të ujit, ndërsa i cili u arkëtua nga përdoruesit e fundit (personat juridikë dhe fizikë).

Ndërmarrjet publike kanë shprehur detyrime për llogaritjet, ndërsa kompensimet e papaguara për të drejtën e ujit në vlerë prej të paktën 426,448 mijë denarë ose të shprehur në euro më shumë se 6.9 milion euro, që paraqet të ardhura potenciale për Buxhetin e RMV-së.

Sipas Raportit nga Ministria e Financave, është dorëzuar me kërkesë të Qeverisë së RMV-së, përfundim të marsit 2019, detyrimet e lajmëruara të 60 komunave ndaj ndërmarrjeve publike që kryejnë shërbime të ujit arrijnë në 348,365 mijë denarë ose të shprehur në euro mbi 5,6 milion euro. Uji i shpërndarë nga ndërmarrjet publike për nevojat e komunave, për ujitje të gjelbërimit dhe parqeve, shatërvanëve, larjes së rrugëve etj., nuk matet dhe nuk faturohet në bazë të konsumit real në m³, ndërsa më së shpeshti faturohet shuma paushallë në përputhje me programet vjetore të komunave.

Nga inspektimi dhe analiza e kryer e të dhënave, revizioni konstatoi se gjithsej uji i shterur/zënë në vitin 2019 është 229,017,078 metra³, nga të cilat 63% nuk është faturuar. Në këtë kontekst, u konstatua se ndërmarrjet publike në komunat vijuese regjistrojnë përqindjen më të lartë të humbjeve të ujit: Dibra - 84%, Dollneni - 82%, Gostivari - 81%, Kërçova - 77%, Ohri 72%, Krusheva - 71% dhe Koçani - 70%.

Matja e sasisë së ujit për vitin 2019



Sasitë e ujit të pafaturuar i përfshinë: humbjet fizike të ujit ,humbësit komercialë të ujit për shkak të konsumimit të paligjshëm dhe pasaktësisë së matësve të ujit dhe gabimit gjatë trajtimit me të dhënat, si dhe konsumin e ligjshëm të ujit të pafaturuar, ujit të konsumuar të matur dhe jo të matur për riparimin dhe shpëlarjen e vazhdueshme të rezervuarëve, shatërvanëve dhe çezmave dekorative publike, ujitjen e zonave të gjelbra publike, linja pemësh dhe gjelbërim në bulevard dhe larje rrugësh.

Gjendjet e theksuara tregojnë se masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga ndërmarrjet publike për të zvogëluar humbjet e ujit janë të

pamjaftueshme dhe shkaktojnë më pak të ardhura të llogaritura dhe të treguara të ndërmarrjeve publike, më pak tatim i llogaritur i vlerës së shtuar, më pak të llogaritur, kompensime të arkëtuara dhe të paguara për të drejtën e ujit në buxhetin e shtetit dhe paraqitet rezultati joadekuat financiar i ndërmarrjeve publike.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor nuk ka ndërmarrë masa konkrete për të rihulumtuar dhe plotësuar Strategjinë Nacionale të Ujit, gjegjësisht e njëjta edhe më tej nuk përmban qëllime dhe përparësi konkrete strategjike, as masa dhe aktivitete për menaxhimin e tyre.

Gjithashtu u konstatua se nuk u miratua asnjë metodologji për përcaktimin e mënyrës së llogaritjes së njësisë së dëmtimit gjatë shkarkimit të ujit, për shkak të së cilës edhe më tej nga ana e ndërmarrjeve publike nuk është llogaritur vlera e ndryshueshme e kompensimit për shkarkimin e ujit.

Me Programin për Punën e Qeverisë për vitet 2017-2020 është vendosur të themelohet Agjencia e Ujit me qëllim të gjitha të dhënat mbi burimet ujore të mbledhura nga institucionet kompetente të integrohen duke përdorur sistemin e vetëm për menaxhimin me ujë, megjithatë kjo Agjenci nuk është formuar ende.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor nuk i ka ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të rishikuar zgjidhjen ekzistuese ligjore për mënyrën e përcaktimit dhe arkëtimin

të kompensimeve të drejtave të ujit dhe sigurimin e zgjidhjes që do të mundësojë kontrollin, monitorimin dhe efikasitetin në arkëtimin e tyre.

Edhe pse në pajtim me Ligjin për ujëra, kompetencat për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese i kanë edhe shërbimet tjera të inspektimit, në periudhën e përfshirjes me revizionin, mbikëqyrja inspektuese mbi përdoruesit e të drejtave të ujit kryhet vetëm nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përmes inspektorëve të menaxhimit të ujit. Por, edhe për kundër detyrimeve të dhënë nga inspektorët e ekonomisë ujore, nga ana e ndërmarrjeve publike nuk janë ndërmarrë aktivitete të mjaftueshme për të eliminuar parregullsitë e konstatuara.

7.7.5 REVIZIONI I MASAVE TË NDËRMARRA (FOLLOW UP), PAS REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA RAPORTI PËRFUNDIMTAR ME TEMË "CILËSIA E AJRIT - REVIZIONI KOOPERATIV"

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e zbatimit të rekomandimeve të përfshira në Raportin Përfundimtar të Revizionit për revizionin e kryer të suksesit për vitin 2017 me temë "Cilësia e ajrit", me qëllim që të vlerësohet shkalla e zbatimit të tyre dhe përshtatshmëria e masave të ndërmarra.

Me revizion konstatuam se nga 10 rekomandime, 1 rekomandim është zbatuar, 3 rekomandime janë duke u zbatuar, 4 rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe 2 rekomandime nuk janë zbatuar, që siguron bazë për të shprehur përfundimin se problemi me ndotjen e ajrit kërkon qasje sistematike të integruar nga të gjitha palët e interesuar (institucionet e nivelit qendror dhe lokal, sektori privat dhe qytetarët)

në planin afatgjatë. Me aktivitetet e ndërmarra në tre vitet e fundit, megjithëse është një hap pozitiv, nuk kanë arritur efektet e dëshiruara në uljen e ndotjes së ajrit. Mbikëqyrja dhe kontrolli janë në nivel të ulët, ndërsa akoma një pjesë shumë e vogël e mjeteve të buxhetit në nivelin qendror dhe lokal janë alokuar për realizimin e masave të përfshira në dokumentet e planifikimit, për shkak të të cilave ato në pjesën më të madhe mbeten të pazbatuara.

Vendosja e re e Grupit Ndërsektorial për Cilësinë e Ajrit siguron bashkëpunim, menaxhim dhe koordinim më të mirë ndërinstytucional, ndërsa me anulimin e Komisionit për Shëndet Publik është shmang përputhja e përgjegjësive të të dyja organeve.

Institucionet që janë bartësit kryesorë për krijimin dhe zbatimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në nivelin qendror dhe lokal vazhdojnë të përballen me mungesën e kuadrit adekuat, të përhershëm dhe profesional.


Në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor, në rrjedhë janë aktivitetet e projektit për vendosjen e Sistemit Nacional të Informacionit për Mjedisin Jetësor, që do të sigurojë sistem të integruar dhe qasje në të dhënat nga mediat e shumta (ajri, uji, toka).

Janë propozuar ndryshime dhe plotësime të Ligjit për cilësinë e ajrit të ambientit, në drejtim të ndërmarrjes së masave të shpejta dhe efikase, gjetjen e përgjegjësisë dhe dënimit përkatës për moszbatimin e masave të parashikuara në dokumentet e planifikimit.

Nga numri i përgjithshëm i inspektimeve në vitet 2017, 2018 dhe 2019, janë kryer 1% që është ende i parëndësishme sipas Ligjit për cilësinë e ajrit të ambientit. Me metodologjinë

për vlerësimin e rrezikut, e cila është në fazën e provës së zbatimit, si dhe me Propozim-ligjin për inspektimin në mjedisin jetësor i cili është në procedurën e miratimit, ofrohen zgjidhje përkatëse ligjore në lidhje me funksionimin e sistemit të vetëm të inspektimit në mjedisin jetësor në të gjithë territorin e RMV-së.

Sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikës, pjesëmarrja e investimeve dhe shpenzimeve për mbrojtjen e ajrit në prodhimin e brendshëm bruto në periudhën raportuese 2017-2019 është zvogëluar në krahasim me vitet e mëparshme dhe ka arritur 0,03%, ndërsa në investimet dhe shpenzimet e përgjithshme për mjedisin jetësor ata marrin pjesë me 2% për vitet 2017 dhe 2018, përkatësisht 2.6% për vitin 2019, e cila është arsyeja pse përqendrimet mesatare vjetore të grimcave të PM₁₀ vazhdojnë të tejkalojnë shumë vlerat e përcaktuara kufitare në të gjitha stacionet matëse, përveç stacionit në Lazaropole.



Burimi: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Përveç planeve për grumbullimin e rajonit të Shkupit dhe komunave të Manastirit dhe Tetovës, në periudhën raportuese u miratuan planet edhe për komunat e Strumicës, Velesit dhe Kërçovës, por prapë për shumicën e komunave ku nivelet e ndotësve tejkalojnë vlerat kufitare nuk kanë përgatitur dokumente planifikimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit të ambientit.

Për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm administrativ të institucioneve kompetente, monitorimi i zbatimit të masave në dokumentet e planifikimit kryhet në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë, respektivisht me kërkesë të palëve të interesuara (BE, mediat dhe shoqëria civile).

Plotësia e të dhënave për Kadastrin e Ndotësve nuk është siguruar sepse më shumë se 50% e operatorëve që kanë leje ekologjike të integruara A dhe B nuk kanë paraqitur të dhëna.

Inspektorati Shtetëror për Mjedisin Jetësor dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale për: forcimin e kapacitetit administrativ, miratimin e zgjidhjeve ligjore të propozuara për cilësinë e ajrit të ambientit dhe mbikëqyrjen inspektuese në mjedisin Jetësor, vendosjen e Sistemit Nacional gjithëpërfshirës të Informacionit për Mjedisin Jetësor dhe bazën e të dhënave të plotë për Kadastrin e Mjedisit Jetësor, sistemin për përgatitjen dhe monitorimin e dokumenteve të planifikimit dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për realizimin e tyre.

7.8 KULTURË

7.8.1 MINISTRIA E KULTURËS

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë së Ministrisë së Kulturës për vitin 2019.

Me revizionin e kryer janë konstatuar gjendjet e caktuara si vijon:

✘ Transferat kapitale në NJVL nuk janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore, gjegjësisht një komune nuk i janë paguar mjetet për projektin edhe pse është dorëzuar dokumentacioni i nevojshëm, ndërsa një komune tjetër i janë paguar mjetet pa dokumentacionin e nevojshëm për projektin që në të vërtet nuk mund të realizohet deri në fund të vitit;

✘ Ministria e Kulturës nuk ka miratuar plan vjetor për realizimin e interesit nacional në kulturë, për përcaktimin e udhëzimeve të përgjithshme për realizimin e interesit nacional;

✘ Ministria e Kulturës ka paguar 406,426 mijë denarë për financimin e aktiviteteve në fushën e kulturës të përfituesve të përzgjedhur në konkursin vjetor, pa akte të brendshme të miratuara me kushte dhe kriteret të definuara për mënyrën e alokimit të mjeteve financiare për projekte me interes nacional në fushën e kulturës për vitin 2019.

Janë konstatuar më shumë parregullsi në alokimin e mjeteve financiare për projekte me interes nacional në fushën e kulturës për aktivitete të caktuara, si vijon:

- ✘ Nuk është paraparë konkurs / aplikim i veçantë për manifestime kulturore dhe artistike dhe për to nuk janë definuar kritere të veçanta për vlerësimin e manifestimeve;
- ✘ Pjesa më e madhe e shpenzimeve për projektet e financuara janë paguar si honorar për organizatorët e ngjarjes;
- ✘ Për disa aktivitete nuk është respektuar afati i paraparë për dorëzimin e raportit me propozimet e projekteve për zgjedhje nga ana e komisionit të formuar nga ministri;
- ✘ Mjetet janë paguar për projekte me dokumentacion të pakompletuar, pa raport të dorëzuar për realizimin e projektit, si dhe pagesa të mjeteve me para në shuma që tejkalojnë kufirin e lejuar ligjërisht;
- ✘ Janë shtypur 599,086 libra, të cilat janë në magazinë, ndërsa nuk janë shpërndarë tek përdoruesit përfundimtarë, për të cilat janë shpenzuar mjete në vlerë prej 378,686 mijë denarë deri më 31.12.2019.
- ✘ Në dhjetor 2018, me përfundim të Qeverisë së RMV-së, janë dhënë udhëzime që ministria të ndërmarrë hapa për ndërprerje miqësore të kontratës së prokurimit publik për punimet e ndërtimit të EN Teatri i Dramës - Shkup, sepse ky objekt nuk paraqet prioritet strategjik për Qeverinë e RMV-së, si dhe mjetet e nevojshme financiare për të, nuk janë siguruar dhe
- ✘ Ministria e Kulturës si investitor për ndërtimin e Objektivit me Kompozicion Skulpturor në Shkup, në vitin 2015 ka lidhur kontratë të prokurimit publik për ndërtimin e objektivit në vlerë prej 342 milion denarë, me periudhë ndërtimi prej 18 muaj dhe një kontratë për mbikëqyrje në vlerë prej 528 mijë denarë. Që nga gushti i vitit 2017, të gjitha aktivitetet e ndërtimit janë pezulluar nga kontraktuesi. Në janar 2019, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me një përfundim e detyron Ministrinë e Kulturës të zbatojë procedurë për shndërrim të këtij objekti dhe të shpallë konkurs publik për zgjidhje ideore.

Në pjesën e çështjeve të tjera, revizioni arriti në përfundimin se pagat e të punësuarve në kulturë janë paguar duke rritur koeficientet dhe duke ndryshuar bazën me të cilën rritet pagesa e pagës, në ndërkohë që për të njëjtën nuk është bërë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për pagesën e pagave në RMV.

Ministria e Kulturës nuk ka kryer regjistrimin e mjeteve dhe burimeve të mjeteve në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, për shkak të të cilave kontabiliteti nuk është i harmonizuar me situatën faktike.

Në pjesën e pyetjeve të theksuara për pasiguri dhe vazhdimësi, janë zbuluar gjendjet që mund të shkaktojnë implikime financiare në të ardhmen, si vijon:

7.8.2 DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2019 të Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejshëm Drejtoria) dhe janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

Drejtorja nuk ka përgatitur Raport Vjetor për punën i cili dorëzohet në Qeverinë e RMV-së, gjithashtu as Strategji Nacionale për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e cila miratohet për periudhë prej 5 vjetësh dhe e cila duhet të përmbajë bazat e politikave afatgjata për mbrojtjen dhe përdorimin e trashëgimisë kulturore.

Drejtorja për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore me buxhetin për vitin 2016 ka planifikuar projekt për hulumtimin, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rekonstruimin dhe prezantimin e Teatrit Antik

Skupi, për të cilin Qeveria e RMV-së ka dhënë pëlqimin për të zhvilluar procedurë për furnizim publik shumëvjeçar, nga viti 2016 deri në vitin 2019 në vlerë prej 522.577 mijë denarë në vëllim dhe dinamikë të përcaktuar në përputhje me mendimin e Ministrisë së Financave. Me inspektimin e buxhetit të Drejtorisë për vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019 është konstatuar se nuk janë planifikuar mjete në shumën e përcaktuar në mendimin e Ministrisë së Financave, sipas së cilës jepet pëlqimi për realizimin e procedurës për furnizim publik shumëvjeçar.

Mosigurimi i mjeteve në buxhetin e Drejtorisë për ndërtimin shumëvjeçar të Teatrit Antik Skupi, ka kontribuar që realizimi i kontratës deri në fund të vitit 2019 të jetë vetëm 7.56%.



Lokaliteti Skupi

Në librat e kontabilitetit të Drejtorisë, për pozicionin e mjeteve materiale në përgatitje, nuk janë regjistruar objektet e ndërtimit në vlerë prej 751,941 mijë denarë në periudhën kur janë në ndërtim e sipër, gjegjësisht për rindërtimin dhe adaptimin e objekteve nuk është kryer rritja e vlerës së objekteve të ndërtimit.

Drejtorja nuk ka kryer regjistrimin e mjeteve dhe detyrimeve në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, për shkak të të cilave nuk është harmonizuar gjendja e librave të kontabilitetit me gjendjen faktike.

Nga Programi i Rindërtimit të Universitetit Shën Klimenti në Pllaoshnik, në periudhën nga viti 2010 deri në ditën e revizionit, janë shpenzuar mjete në vlerë prej 748.280 mijë denarë. Për realizimin e projektit, janë lidhur dy marrëveshje themelore pas zbatimit të procedurave për furnizime publike për të cilat gjatë viteve janë lidhur më shumë anekse. Për këto procedura janë konstatuar disa dobësi në pjesën e mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për furnizime publike, Ligjit për ndërtim dhe dispozitave të kontratave të lidhura që kontribuojnë në zgjatjen e afateve për ndërtimin e objekteve si dhe shtrenjtimin e ndërtimeve për të cilat janë harxhuar më shumë mjete buxhetore në kushtet kur objektet nuk janë ende në funksion.

Në pjesën e Theksimit të çështjeve për pasigurinë dhe vazhdimësinë, janë theksuar gjendjet për:

- ✘ Procedurat gjyqësore që janë kundër Drejtorisë dhe të cilat janë në rrjedh, ndërsa për të cilat ekziston mundësia nga rezultati përfundimtar dhe mundësia e ngarkesës shtesë të buxhetit të Drejtorisë, me interes dhe shpenzime gjyqësore në periudhën e ardhshme dhe
- ✘ Ndërtimi i objektit Restaurimi i Universitetit Shën Klimenti Pllaoshnik si ndërtesë e re nuk është në kompetencën e Drejtorisë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

7.9 KOMUNIKACIONI, TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMET

7.9.1 AGJENCIA PËR KOMUNIKIME ELEKTRONIKE



Me revizionin e kryer të raporteve financiare për vitin 2019, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë tek Agjencia për Komunikime Elektronike (në tekstin në vazhdim AKE) është konstatuar nevoja për harmonizimin e aktit për sistematizimin e vendeve të punës me rregulloren, si dhe përmirësimin e procedurës për kryerjen e regjistrimit të mjeteve, kërkesave dhe të detyrimeve.

Për nevojat e revizionit, ndërsa në përputhje me nenin 27 të Ligjit për revizion shtetëror, ishin angazhuar persona të jashtëm profesionalë në fushën e ndërtimitarisë, për të përcaktuar ligjshmërinë në kryerjen e aktiviteteve ndërtimore në lidhje me ndërtimin e "Shtyllës së Antenës në Vodno - Sistemit të Antenës për kontrollimin dhe monitorimin e radio frekuencave për territorin e Republikës së Maqedonisë, pa pasur qasje dhe pa kyçje të largpërçuesit.

Aktivitetet për ndërtimin e Shtyllës së Antenës në Vodno kanë filluar në vitin 2013, bazuar në një marrëveshje të përfunduar për ndërtimin e sistemit të Antenës për kontroll dhe monitorim të radio frekuencave në territorin e Republikës

së Maqedonisë, pas së cilës aktivitetet nuk kanë përfunduar ende. Vlera e përgjithshme e kontratës dhe anekseve të kontratës deri në qershor 2020 ishte 1,142,325 mijë denarë pa TVSH, nga të cilat në nëntor 2019, u realizuan 517,751 mijë denarë.

Ishin theksuar gjendjet të cilat në të ardhmen mund të kenë implikime financiare dhe ndikim në funksionimin e Agjencisë, nga të cilat më të rëndësishme janë si vijon:

- ✘ procedura gjyqësore e iniciuar për arkëtim të kërkesave, në vlerë të përgjithshme prej 97,159 mijë denarë, rezultati i të cilave mund të ndikojë në të hyrat e Agjencisë;
- ✘ kërkesa e evidentuar nga Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, në bazë të depozitit të dhënë në vitet e mëparshme, në bankë për të cilën po zhvillohet procedura e falimentimit;
- ✘ donacionet e dhëna në vitet e kaluara për ndërtimin e objektit me interes publik, të cilin përfituesi i donacionit nuk i ka realizuar plotësisht, që mund të shkaktojë implikime financiare në periudhat e ardhshme.

Ishin shpalosur gjendjet për tejkalimin e të cilave është e nevojshme që organet kompetente të ndërmarrin aktivitete për rregullimin e rregullativës ligjore dhe nënligjore, për rregullimin e mënyrës së shpërndarjes së pjesës së të ardhurave të destinuara për financimin e Agjencisë Teknike Operative, si dhe rishqyrtimin e gjobave për të cilat organi kompetente i kundërvajtjes në përputhje me Ligjin për komunikim elektronik është Agjencia, në mënyrë që ta harmonizojë atë me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

7.10 VETËQEVERISJA LOKALE

7.10.1 NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE



Gjatë vitit 2020 është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2019, te njësitë e vetëqeverisjes lokale: Radovish, Koçani dhe Gazi Babë, gjatë së cilës janë konstatuar gjendjet si vijojnë:

Gjatë vlerësimit të sistemit të kontrolleve të brendshme, në procese të ndara, në komunat e reviduara, u përcaktua se i njëjti është pjesërisht ose jo i vendosur dhe nuk funksionon në procesin e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimin e shpenzimeve dhe në procesin e planifikimit të buxhetit të komunës, për shkak të të cilit ekziston rreziku i paplotësisë së të ardhurave nga tatimi mbi pronë dhe tarifave të shërbimeve për theksimin e kompanisë, si dhe rreziku i miratimit të buxhetit joreal.

Në Komunën e Radovishit dhe Komunën e Koçanit, ndodhja e devijimit të konsiderueshëm ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara të buxhetit është akoma e pranishme, përkundër rebalancit të miratuar të buxhetit, harmonizimi i tyre nuk është kryer.

Në komunat e Koçanit dhe Radovishit u konstatuan dobësi në pjesën e shtesave të arkëtuara për

pastërtinë publike dhe gjelbërimin publik nga ndërmarrjet publike të cilat kompensimet e arkëtuara në mënyrë të parregullt ose nuk paguajnë në llogarinë e buxhetit të komunës.

Komuna e Gazi Babës karakterizohet me paraqitjen nga periudha e marrjes së kompetencës deri në vitin 2020, fondet në bazë të tjetërsimit dhe dhënies me qira të tokës ndërtimore në pronësi të RMV-së për t'u paguar në llogarinë joadekuate të të ardhurave që rezultoi në të ardhura më të ulëta në Buxhetin e RMV-së në vlerë prej 58,546 mijë denarë. E njëjta gjë vlen edhe për arkëtimin e gjobës së dakorduar për mosrespektimin e Ligjit për tokën ndërtimore për shkak të së cilës më pak fonde janë paguar në Buxhetin e RMV-së gjegjësisht në vlerë prej 1,247 mijë denarë.

Në komunat e Radovishit dhe Gazi Babës, janë konstatuar dobësi në zbatimin e Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje dhe nuk janë përgatitur raporte vjetore për përdorimin e fondeve nga kompensimet për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje.

Në të tre komunat ka probleme në pjesën e regjistrimit të pronës dhe detyrimeve, gjendja e së cilës është aktuale me vite dhe nuk lejon

harmonizimin e gjendjes së mjeteve dhe detyrimeve ndërmjet evidencës së kontabilitetit dhe gjendjes faktike të përcaktuar me regjistrim.

Në Komunën e Gazi Babës, Këshilli Komunal nga viti 2017 nuk i miraton Planet Vjetore për punësime të propozuara nga Kryetari i Komunës për shkak të të cilave në Komunë nuk ka mundësi edhe pas pensionimit të personave të cilët janë në vende të rëndësishme të punës të pranohen persona të rinj edhe pse për shkak të pensionimit të rregullt numri i të punësuarve zvogëlohet ndjeshëm. Në komunat e Radovishit dhe Gazi Babës përmes agjencive private për punësime, më shumë njerëz janë të punësuar për të kryer detyra në punë të rregullta sipas aktit të sistematizimit që nuk janë plotësuar, dhe disa nga njerëzit punojnë në të njëjtat punë për më shumë se dy vjet, që nuk është në përputhje me Ligjin për agjenci private për punësime.

Në Komunën e Radovishit, nuk është miratuar procedura për shpërndarjen e fondeve nga bllok-dotacionet për institucionet publike komunale.

Në komunat e reviduara të Radovishit dhe Gazi Babës, janë konstatuar raste të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për shoqata dhe fondacione qytetare dhe Ligji për sport. Në të vërtetë prezent është fenomeni pa kriter ose i papërcaktuar mjetet e dhënies së shumës maksimale dhe minimale shoqërive dhe shoqatave dhe klubeve sportive.

Në Komunat e Radovishit dhe Gazi Babës tek investimet kapitale ka paraqitje të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për ndërtim, i cili kryesisht u referohet raporteve të papërgatitura për pranimin teknik të ndërtesave ose fazave ndërtimore si dhe në pjesën e zbatimit në punën e kontraktuesve.

Janë konstatuar dobësi në furnizimet publike, veçanërisht në pjesën e përgatitjes së dokumentacionit teknik në rastet kur

zbatohen çmimet për njësi pa marrë parasysh dokumentacionin e projektit dhe dokumentacionin teknik në bazë të asaj të jetë me sasi të përcaktuara gjatë së cilës jo gjithmonë sigurohet principi i ofertës më ekonomike. Dobësitë në procedurat e furnizimit publik janë konstatuar në Komunën e Radovishit dhe në Komunën e Gazi Babës.

Në pjesën e theksimit të çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë, është theksuar gjendja që ka të bëjë me forcimin e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes lokale, servisimi i borxheve dhe lehtësimi i borxhit tek furnitorët. Gjegjësisht, në nëntor 2018, nga ana e Kuvendit të RMV-së është miratuar Ligji për mbështetjen financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe njësive përfituese të krijuara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale për financimin e detyrimeve të mbetura dhe të papaguara. Për zbatimin e ligjit në fjalë, nga Buxheti i RMV-së për vitin 2018, mjetet në vlerë prej 3,023,383 mijë denarë janë transferuar në llogari të veçanta të komunave për shlyerjen e 51% nga gjithsej të raportuara të detyrimeve të papaguara.

7.10.2 TRANSFERIMET KAPITALE NGA BUXHETI I RMV-së TE NJVL-të


Qeveria e RMV-së në aktivitetet e programit, përmes përdoruesve të buxhetit që janë bartës të programeve buxhetore të qeverisë, parashikon masa dhe aktivitete që përfshijnë transferime kapitale nga Buxheti te njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL). Përmes transferimeve kapitale, komunat ndihmohen në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore, duke mundësuar zhvillim më të ekuilibruar në të gjithë territorin e vendit dhe zhvillim dhe investime në zonat rurale, me qëllim që:

- ✗ t'i zvogëlojë disproporcionet në zhvillimin e komunave individuale;

- ✗ të përmirësojë cilësinë e jetës së popullsisë në të gjithë territorin dhe
- ✗ të zvogëlojë migrimin e popullsisë nga zonat rurale në ato urbane.

Është konstatuar se në periudhën 2017-2019 nga Buxheti i RMV-së te NJVL-të për investime kapitale në infrastrukturë dhe përmirësimin e mjedisit jetësor janë transferuar gjithsej 3,038,123 mijë denarë. Pjesëmarrja e përdoruesve individualë të buxhetit në fondet totale të transferuara për investime kapitale në NJVL është paraqitur në grafikun vijues.

Pjesëmarrje në fondet totale të transferuara të përdoruesve individual të buxhetit



Duke pasur parasysh materialitetin dhe rëndësinë e fondeve të transferuara nga buxheti i shtetit te NJVL-të për investime kapitale, revizioni i suksesit kishte për qëllim t'i përgjigjej pyetjes: "A është vendosur sistemi efektiv për menaxhimin me transferimet kapitalit te NJVL-të nga Buxheti i RMV-së"?

Revizioni i suksesit u përqendrua në mënyrën e vendosjes së menaxhimit me transferimet kapitale te NJVL-të me qëllim që të vlerësohet se sa mundëson planifikimin efektiv, realizimin, monitorimin e realizimit të tyre dhe njoftimin për realizimin dhe efektet nga investimet kapitale.

Me revizion u konstatuan gjendjet si vijojnë:

- ✘ Rregullativa ligjore nuk përshkruan mënyrë të unifikuar të veprimit të përdoruesve buxhetorë në menaxhimin me dotacionet kapitale;
- ✘ Dokumentet strategjike dhe të planifikimit të miratuara nga Qeveria e RMV-së, të cilat janë baza për përgatitjen e planeve operacionale dhe programeve vjetore ose vendimeve që përfshijnë masat për transferime kapitale te NJVL-të, nuk përmbajnë vëllim të mjaftueshëm të parametrave për planifikimin vjetor pa-pengesë, monitorimin e realizimit të aktiviteteve dhe efekteve të tyre, ndërsa disa prej tyre nuk janë miratuar;
- ✘ Programet Vjetore në të cilat janë planifikuar masat dhe fondet për transferimet kapitale te NJVL-të janë miratuar me kohë, por jo dhe thirrjet publike për to;
- ✘ Kriteret për vlerësimin e projekteve të paraqitura dhe shuma e financimit të aprovuar janë të ndryshme për secilin program dhe në pjesën më të madhe nuk janë mjaft të qarta dhe të sakta;
- ✘ Disa nga vendimet për përzgjedhjen e projekteve që duhet të financohen me fonde nga programi, merren në gjysmën e dytë të vitit rrjedhës dhe jo gjithmonë bazohen në vlerësimin dhe renditjen e projekteve;

- ✘ Janë aprovuar projektet për financimin për të cilat nuk janë siguruar plotësisht fondet financiare;
- ✘ NJVL-të me qarkullime buxhetore nuk janë të informuar për shumën e fondeve të aprovuara për transferimet kapitale;
- ✘ Buxheti i RMV-së nuk jep pasqyrë të qartë të shumës totale të fondeve të dedikuara për transferimet kapitale te NJVL-të;
- ✘ Për disa nga fondet e alokuara nga vendimet e Qeverisë së RMV-së, nuk lidhen marrëveshje me përdoruesit e fondeve;
- ✘ Afati i gjatë nga shpallja e thirrjeve publike deri në lidhjen e marrëveshjeve;
- ✘ Pagesat e paradhënies, përfundimi i marrëveshjeve dhe fondeve të përealizuara për shkak të vonesës së realizimit të punëve ose mosfillimit të tyre në përputhje me marrëveshjet e lidhura për furnizimet publike të ndara;
- ✘ Fondet për dotacionet kapitale nuk transferohen gjithmonë në llogari me dedikim të veçantë;
- ✘ Monitorimi i realizimit të investimeve kapitale bëhet nga përdoruesit e buxhetit përmes të cilit transferohen mjetet, por nuk kryhet monitorimi i realizimit të dotacioneve kapitale dhe nga ana e Komisioni për monitorimin e zhvillimit të sistemit për financimin e komunave;
- ✘ Një pjesë e përdoruesve të buxhetit dhe një pjesë e komunave nuk paraqesin raporte për realizimin e fondeve të dhëna / mjeteve të pranuar për investime kapitale te dikasteret e ministrive bartëse të programeve dhe te Qeveria e RMV-së dhe
- ✘ Nuk është kryer vlerësimi i efekteve për investimet kapitale të realizuara.

Gjendjet e konstatuara me revizionin e theksuar të suksesit paraqet bazë për shprehjen e përfundimit si vijon:

Rregullativa multidisiplinare si kornizë sistematike për hartimin e dokumenteve strategjike për ndërtimin e qëllimeve, politikave dhe aktiviteteve afatgjata për sistem të qëndrueshëm për menaxhimin me transferimet kapitale në nivel shtetëror, përfshinë periudhë të ndryshme të planifikimit afatgjatë si dhe nuk ka gjithmonë qëllime të përcaktuara qartë, aktivitetet, treguesit dhe burimet e financimit, si dhe metodologjinë e pa-miratur për mënyrën e shpërndarjes së fondeve për transferimet kapitale, parandalojnë menaxhimin e integruar, e komplikojnë planifikimin, realizimin, monitorimin e efekteve të tyre dhe nuk

japin pasqyrë të qartë dhe të plotë për gjendjen e fondeve të transferuara për investimet kapitale nga Buxheti i RMV-së te NJVL-të.

Për menaxhim efektiv të transferimeve kapitale te NJVL-të, është e nevojshme që institucionet kompetente në RMV, të zbatohen aktivitete për rregullimin e zonës, përmes komunikimit dhe koordinimit më të mirë ndërmjet institucioneve kompetente, që do të kontribuojnë në përmirësimin e procesit të përgjithshëm të menaxhimit me transferimet kapitale te NJVL-të nga Buxheti i RMV-së, për planifikimin, zbatimin, monitorimin e plotë të tyre dhe efektiv, monitorimin e realizimit dhe njoftimit për efektet nga investimet kapitale.

7 . 1 0 . 3 EFIKASITETI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE NË FUNKSIONIN E REALIZIMIT TË KOMPETENCAVE BARTËSE TË CILAT JANË FINANCUAR ME MJETE TË BLOK-DOTACIONEVE

Është kryer revizioni i suksesit me temë "Efikasiteti i masave dhe aktiviteteve në funksionin e realizimit të kompetencave bartëse të cilat janë financuar me mjete nga bllok-dotacionet".

Përfshirja dhe provat të cilat janë siguruar përmes zbatimit të teknikave dhe metodologjisë nga ana e revizionit e dhanë përfundimin si vijon:

Ligji për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale parashikon që kompetencat bartëse të financohen me bllok-dotacione në arsim, kulturë, mbrojtje të hershme të fëmijëve dhe mbrojtjen e të moshuarve. Sistemi i financimit të kompetencave bartëse të komunave nuk bazohet në parimin e financimit të kompetencave (funksioneve), por në institucionet e arsimit, kopshtet e fëmijëve dhe mbrojtjes sociale dhe kulturës. Nga kjo rrjedh se me decentralizim nuk është siguruar marrëdhënie

harmonike dhe të ekuilibruar midis zhvillimit demografik, ekonomik dhe kulturor të vendit, ka ndryshime për shkak të zhvillimit të pabarabartë të komunave urbane dhe rurale, me të cilat të gjitha komunat nuk mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në proceset e decentralizimit në të gjitha fushat, veçanërisht në kulturë. Përkundër iniciativës për ridefinimin e mënyrës dhe kriterëve për bllok-dotacionet dhe dedikimet për komunat, nga ana e ministrive kompetente nuk kanë ndërmarrë veprime të mjaftueshme për ridefinimin e mënyrës dhe përcaktimin e kriterëve për bllok-dotacionet dhe dedikimet për komunat.

Gjendjet e konstatuara tek arsimit të udhëzojnë në përfundimin se nuk është bërë vlerësimi për të përcaktuar rrjetin e nevojshëm të shkollave në secilën komunë, ndërsa me to nuk siguron racionalizimin e shpenzimeve për rrogat bruto

dhe për shpenzimet tjera të nevojshme për funksionimin e secilës shkollë.

Arsimit të mesëm i mungon analiza funksionale e rrjetit të shkollave të mesme, veçanërisht profileve arsimore të cilat në të vërtet janë të nevojshme për komunat dhe shtetin.

Blllok-dotacionet për kopshtet e fëmijëve nga viti 2019 është llogaritur në përputhje me Rregulloren e re për metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e bllok-dotacioneve të miratuara për shkak të moszbatueshmërisë së metodologjisë së mëparshme, por problemi mbetet me procesin e punësimit të centralizuar dhe kompleks që është veçanërisht i rëndësishëm te kopshtet e fëmijëve në kushtet e mungesës së burimeve njerëzore.

Blllok-dotacionet në kulturë shpërndahen në bazë të kriterëve të pandryshuara në Rregulloren e theksuar, ndërsa komunat nuk kanë miratuar akte të brendshme për shpërndarjen e fondeve tek institucionet.

Në kushtet e pandemisë dhe masave të miratuara për mbrojtje nga KOVID-19, kur procesi arsimor zhvillohet në distancë, pa prani fizike, fondet për bllok-dotacionet të përcaktuara nga Buxheti i RMV-së për vitet 2020 dhe 2021 nuk janë të reduktuara, që kontribuon në llogaritë për bllok-dotacionet e komunave të mbeten fonde të pashfrytëzuara.

7.10.4 ZBATIMI I LIGJIT PËR VEPRIM ME OBJEKTE TË NDËRTUARA PA LEJE NË KOMUNËN E OHRIT DHE NË KOMUNËN E STRUGËS

Për zgjidhjen sistematike të problemit me objektet e ndërtuara pa leje në vend, në vitin 2011 u miratua Ligji për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, me të cilën rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura për evidentim, përcaktim të statusit juridik dhe sanksionim të objekteve të ndërtuara pa leje, e cila vlen deri në mars të vitit 2021.



Nevoja për legalizimin e ndërtesave pa leje në RMV lindi nga gjendja e situatës në shtet, në të cilën një numër i madh i qytetarëve nuk kishin zgjidhur statusin e objekteve të tyre, si dhe në përputhje me aktet juridike të ratifikuara ndërkombëtarisht, Me legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, shteti iu afrua zgjidhjes së problemit të kahershëm të ndërtimit, me qëllim që të vendos "rregull" në planifikimin e hapësirës.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e pajtueshmërisë të zbatimit të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje në Komunën e Ohrit dhe Komunën e Strugës, për periudhën 2011-2020, ndërsa për fusha, çështje dhe ngjarje të caktuara janë të përfshirë deri në prill 2021.

Duke inspektuar në regjistrat e kërkesave të parashtruara konstatuam:

Në Komunën e Ohrit, përfundim nga muaj shtator i vitit 2020 janë evidentuar gjithsej 15,939 kërkesa për marrjen e statusit juridik të 19,935 objekteve. Nga numri i përgjithshëm, janë aprovuar 5,806 kërkesa për objekte ose 30%, janë refuzuar 2,544 kërkesa për objekte ose 19%, ndërsa në procedurat me kërkesat për 11,585 objekte, gjegjësisht për 51% të numrit të përgjithshëm të objekteve për të cilat janë dorëzuar kërkesa ende nuk janë miratuar vendime për përcaktimin e statusit juridik të tyre.

Në Komunën e Strugës, kërkesat e paraqitura për përcaktimin e statusit juridik të objekteve pa leje janë 10,723 kërkesa nga të cilat 3,049 raste ose 28% janë zgjidhur, 4,040 kërkesa gjegjësisht 38%, në procedurë janë 2,775 kërkesa gjegjësisht 26%, ndërsa 8% gjegjësisht 859 lëndë janë me status të papërcaktuar.

Si rezultat i gjendjeve të konstatuara, përfshirja dhe provat të cilat janë siguruar përmes zbatimit të procedurave dhe metodologjisë së revizionit përkatës, revizioni e nxori përfundimin si vijon:

"Mundësia e dhënë ligjërisht për të paraqitur kërkesa jo të plota për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, të cilat zakonisht janë pa elaborat gjeodezik dhe fletëpronësi për tokën në të cilën është ndërtuar objekti pa leje, ndryshime të shpeshta të ligjit, mosrespektimi i afateve të përcaktuara në Ligjin për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara, joekipimi i kuadrit të inspektimit të ndërtimit, mosveprimi sipas përfundimeve të miratuara nga inspektorët e ndërtimit, kompleksiteti i procesit të miratimit të dokumentacionit urbanistik të planifikimit, marrja e vendimeve për pezullimin e përkohshëm të miratimit dhe zbatimi i planifikimit të dokumentacionit dhe procedurave për shkak të dobësive në rregullimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, si dhe respektimi jo i plotë i dispozitave ligjore gjatë zbatimit të procedurave për përcaktimin e objekteve të ndërtuara pa leje të cilat nuk janë në kompetencat e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, procesi ka ndikim në përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje të mos rrjedh sipas nevojës/ dinamikës së pritshmërisë që ndikon në zvarritjen e procesit dhe mosarritjes së qëllimit të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje që reflekton në mënyrë negative në zhvillimin urban dhe ruajtjen e natyrës botërore dhe trashëgimisë kulturore në Rajonin e Ohrit.

Për gjendjet e konstatuara janë dhënë rekomandime te personat kompetentë në Komunën e Ohrit, Komunën e Strugës dhe Ministrinë e Transportit dhe e Lidhjeve me qëllim tejkallimin e gjendjes.

Theksojmë se te Kuvendi i RMV-së janë dorëzuar:

- ✘ Në shtator të vitit 2020 - Propozim-ligji për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, me procedurë të shkurtuar, me të cilin në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare është dhënë propozimi për të vazhduar procedurat e filluara në përputhje me ligjin sipas së cilës kanë filluar, si dhe propozimi me të cilin ndryshon edhe përfshirja e objekteve të ndërtuara pa leje gjegjësisht me këtë propozim-ligj me objekte të ndërtuara pa leje nënkuptojnë objektet e ndërtuara përfundim më 1 tetor 2019 dhe
- ✘ Në janar 2021 - Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, me të cilën propozohet zgjatja e vlefshmërisë së ligjit deri në dhjetë vjet nga data e hyrjes në fuqi të vazhdohet për pesë vjet, gjegjësisht i njëjti të jetë i vlefshëm deri në mars 2026.

7.10.5 CILËSIA E SHËRBIMEVE QË OFROJNË NJVL-TË NËPËRMJET PORTALEVE TË TYRE TË INTERNETIT

Është kryer revizioni i sistemeve të informacionit si revizion i suksesit me qëllim për të vlerësuar pyetjen "Nëse cilësia e shërbimeve që i ofron njësia e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet portaleve të internetit sigurojnë nivelin e parimit të administratës së mirë, gjegjësisht nëse qytetarët mund të kenë të drejtë ose të kryejnë detyrime me humbje më pak të kohës dhe shpenzimeve".

Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë përgjegjëse për sigurimin e informacionit bazë për shërbimet që ata u ofrojnë qytetarëve dhe personave juridikë, në një mënyrë dhe në kushte të rregulluara me statutin e komunës. Ata duhet të jenë transparent në punën e tyre, të kenë procedura të qarta pjesëmarrëse të vendimmarrjes dhe procedura të qarta për marrjen e shërbimeve publike dhe administrative, të jenë të përgjegjshëm në përdorimin e fondeve publike dhe të përmirësojnë vazhdimisht jetën e komunitetit.

Me revizionin është përfshirë periudha nga viti 2016 deri në vitin 2020 dhe janë konstatuar gjendjet e mëposhtme:

- ✘ Problemet me disponueshmërinë e portaleve të internetit dhe monitorimin e tyre të rregullt;
- ✘ Mungesa e informacionit bazë dhe udhëzimeve për shërbimet që janë në dispozicion të qytetarëve, përkatësisht informacioni në lidhje me shërbimet e ofruara për qytetarët në faqet e internetit të NJVL-së;
- ✘ Mungon vendosja e regjistrit të plotë, përkatësisht lista e shërbimeve / e-shërbimeve të ofruara nga NJVL-ja për qytetarët dhe personat juridikë;
- ✘ Shërbimet / shërbimet elektronike që ofrojnë nuk publikohen nga të gjitha NJVL-të në portalet e internetit;
- ✘ Mungesa e formularëve për të gjitha shërbimet që ofrojnë dhe azhurnimi i tyre i vazhdueshëm, si dhe mungesa e informacionit për tarifën e shërbimit;
- ✘ Portalet e internetit nuk janë përshtatur për qasje për personat me aftësi të kufizuara;
- ✘ Mungesa e planifikimit strategjik për zhvillimin ekonomik lokal në NJVL, si dhe planifikimit strategjik për përdorimin e teknologjisë së informacionit;

- ✘ Zgjidhja jofunkionale për monitorimin e gjendjes së ofrimit të shërbimeve nga subjektet që kryejnë shërbime publike, si dhe mungesën e monitorimit të rregullt të cilësisë së shërbimeve publike në nivel lokal;
- ✘ Transparenca dhe përgjegjësia e pamjaftueshme për përdorimin e fondeve publike në portalet e internetit;
- ✘ Disa nga NJVL-të nuk ofrojnë qasje tek informacionet të karakterit publik në portalet e internetit;
- ✘ Protokoli i sigurisë HTTPS për qasje në portalet e internetit nuk është zbatuar në të gjitha NJVL-të;
- ✘ Zbatimi i pamjaftueshëm i standardeve themelore për menaxhimin me cilësinë;
- ✘ Nuk ka qasje të unifikuar / barazuar në lidhje me shërbimet e ofruara të NJVL-të përmes portaleve të tyre të internetit, NJVL-të nuk i ndjekin standardet për qasje në internet dhe portalet e internetit nuk ofrojnë navigacion të lehtë dhe qasje në shërbime dhe informacione;
- ✘ Burimet njerëzore dhe materiale të pamjaftueshme, të nevojshme për vendosjen e e-shërbimeve, si dhe mungesa e analizës dhe burimet e domosdoshme minimale të nevojshme për sigurimin e duhur të shërbimeve cilësore përmes portaleve të internetit të NJVL-së.

Bazuar në revizionin e kryer, u arrit në përfundimin se cilësia ekzistuese e shërbimeve të ofruara nga NJVL-të në portalet e internetit nuk ofron nivel parimi të administrimit të mirë, nuk siguron zbatim efektiv dhe të shpejtë të shërbimit ose detyrimit të veçantë dhe nuk ofron trajtim të njëjtë, qasje dhe disponueshmëri të barabartë për çdo qytetar.

Revizioni dhe rekomandimet në udhëzimin e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, rritja e numrit të shërbimeve elektronike publike, publikimi i informacionit dhe të dhënave të përcaktuara me ligj në portalet e internetit dhe azhurnimi i tyre i vazhdueshëm, monitorimi i standardeve, sigurimi i qasjes së barabartë, të lehtë dhe të shpejtë në shërbimet publike dhe administrative për qytetarët dhe palët tjera të interesuara dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies së NJVL-ve.

7.1.1 SHOQËRITË AKSIONARE DHE NDËR-MARRJET PUBLIKE TË THEMELUARA NGA NJVL-JA DHE SHTETI

7.1.1.1 NDËRMARRJET PUBLIKE TË THEMELUARA NGA NJVL-JA

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2019 të Ndërmarrja Publike Komunale "Vodovod" Koçani, e themeluar nga Komuna e Koçanit dhe Ndërmarrja Publike "Pllavaja" Radovish, e themeluar nga Komuna e Radovishit.

Me revizionin e kryer të raporteve financiare dhe revizionin e pajtueshmërisë të NPK "Vodovod" Koçani dhe NP "Pllavaja" Radovish për vitin 2019, janë konstatuar këto gjendje, nga të cilat, më të rëndësishmet janë:

- ✘ gjatë vlerësimit të sistemit të kontrolleve të brendshme në procesin e përcaktimit të të ardhurave dhe arkëtimit të kërkesave nga shërbimet komunale, për shkak të procedurave të shkruara dhe të pamiratuara, u konstatua se ekzistojnë rreziqe që mund të kenë ndikim në arkëtimin e kërkesave dhe në tërësinë e të ardhurave;
- ✘ Te NP "Pllavaja" Radovish, nuk është themeluar asnjë njësi e revizionit të brendshëm me të paktën një revizor të brendshëm dhe drejtues të njësisë së revizionit të brendshëm;
- ✘ ekziston gjendja e humbjes së ujit në sistemin e furnizimit me ujë që është 67.75%, në NPK "Vodovod" Koçani, respektivisht 63% në NP "Pllavaja" Radovish nga uji i furnizuar nga stacioni i filtrit në sistemin e furnizimit me ujë, për shkak të defekteve të sistemit, vjedhjeve, lidhjeve të paligjshme dhe në mënyrë të ngjashme, ndërsa një pjesë e ujit të furnizuar përdoret për larjen e filtrave në impiantin e trajtimit të ujit, ujitjen e gjelbërimit publik dhe pastrimin e zonave të trafikut publik;
- ✘ në bazë të detyrimeve për shtesën e përdorimit të ujit, shtesën për shkarkimin e ujit, shtesën për përdorimin e ujit gjeotermal, shtesën për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, shtesën

për menaxhimin me hedhurinat dhe taksën komunale për parkim, është konstatuar gjendja e një shume të konsiderueshme të mjeteve të papaguara në favor të Buxhetit të RMV-së, përkatësisht Buxhetit të komunës;

- ✘ te NP "Pllavaja" Radovish është treguar fitimi në sasi më të madhe, ndërsa në sasi më të vogël të detyrimeve në bazë të shtesave për përdorimin e ujit dhe shkarkimin e ujërave si detyrim ndaj Buxhetit të RMV-së;
- ✘ në regjistrin tregtar nuk është kryer regjistrimi i shumës kryesore të ndërmarrjeve publike. Ndërmarrjet nuk kanë përcaktuar vlerën e tregut të pronës dhe detyrimeve, ashtu që, shuma kryesore është përcaktuar në mënyrë të kontabilitetit, gjegjësisht nuk është kryer vlerësimi i kapitalit;
- ✘ te NPK "Vodovod" Koçani, kërkesat nga blerësit në vend që vijnë nga vitet e mëparshme, disa prej të cilave janë paditur, ndërsa disa janë të parashkruara dhe duhet të fshihen, nuk janë treguar te llogaria për kërkesa të dyshimta dhe të diskutueshme;
- ✘ në nivelin komunal, nuk është vendosur sistem për përzgjedhjen e hedhurinave të gjeneruara nga parakushtet për zvogëlimin e sasisë së tyre, ndërsa në funksion të mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Në çështjet tjera është theksuar gjendja me stacionin e pastrimit për trajtimin e ujërave të zeza Koçani në të cilin investitor ishte Komuna e Koçanit dhe pas përfundimit të tij, Këshilli mori vendim për përdorim dhe menaxhim të përhershëm nga NPK "Vodovod" Koçani, ndërsa për shkak se nuk është siguruar dokumentacioni nga Komuna, e njëjta nuk është evidentuar plotësisht në librat afariste të NPK "Vodovod" Koçani.

7.11.2 SHOQËRITË AKSIONARE TË THEMELUAR NGA SHTETI

Është kryer revizioni i raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë së Shoqërisë Aksionare për Ndërtime dhe Ekonomizim me Hapësirat Afariste dhe me Hapësira Afariste me Rëndësi për Republikën - Shkup, për vitin 2019.

Shoqëritë në bazë të Ligjit për transformimin e ndërmarrjes publike për ekonomizim me banesat dhe me hapësirat afariste të Republikës së Maqedonisë, në vitin 2011 është regjistruar në Regjistrin Qendror të RMV-së si pasardhës juridik i Ndërmarrjes Publike për ekonomizim me banesa dhe hapësira afariste të Republikës së Maqedonisë, në aspekt të pronës, mjeteve, punonjësve, të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me veprimtarinë për ndërtimin dhe ekonomizimin me hapësirat banesore me rëndësi të Republikës.

Me revizionin e kryer u konstatuan gjendjet si vijojnë:

- ✘ Në kushtet komplekse dhe të disperzuara të vendosjes organizative të Shoqërisë nuk është vendosur sistemi i plotë i kontrolleve të brendshme;
- ✘ Ndryshimet në evidencat e vetme të hapësirave të banimit dhe afariste të rëndësishme për Republikën, si detyrim statutor i Shoqërisë, nuk evidentohen në kohë të plotë dhe kronologjike;
- ✘ Nuk është rregulluar mënyra e faturimit, nënshkrimit, arkivimit, shtypjes dhe evidentimit të faturave mujore për qira të hapësirës afariste dhe banesore, si dhe monitorimi i realizimit në përputhje me marrëveshjet e lidhura;
- ✘ Regjistrimi vjetor i mjeteve dhe detyrimeve nuk është i plotë dhe nuk është kryer në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe aktet interne të miratuara me të cilat është rregulluar mënyra e ekzekutimit të tyre;
- ✘ Për objektet, ndërtimi i të cilave është në proces, nuk janë dorëzuar të dhëna të veçanta për secilin objekt për vlerën e marrëveshjeve të ndërtimit, vitin e fillimit të ndërtimit, si dhe për

shkallën e përfundimit të tyre;

- ✘ Evidentimi i apartamenteve, garazheve, bodrumëve dhe lokaleve të biznesit, të destinuara për shitje, nuk janë të plota.

Në pjesën e Theksimi në çështjet e pasigurisë dhe vazhdimësisë, u theksuan gjendjet që kanë ndikim në funksionimin e shoqërisë, nga të cilat më të rëndësishmet janë si më poshtë:

- ✘ Pronësia, mënyra e ekonomizimit dhe procedurat e filluara gjyqësore të rrjetit të shpërndarjes së ujit të nxehtë në Qytetin e Shkupit;
- ✘ Pasiguria në lidhje me rezultatin e procedurave të filluara gjyqësore në të cilat Shoqëria është paditëse për arkëtimin e kërkesave nga persona juridikë dhe fizikë dhe është ana e paditur, si dhe për sigurimin e kredive afatgjata nga objektet e hipotekës dhe hapësirës afariste;
- ✘ Nuk është përfunduar plotësisht ndarja ndërmjet dy shoqërive aksionare të krijuara nga transformimi i Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Banesa dhe Hapësira Afariste të Republikës së Maqedonisë në përputhje me ligjin;
- ✘ Shndërrimi i hapësirës administrative afariste në hapësirë afariste komerciale, pjesë e destinuar për shitje dhe një pjesë për të dhënë me qira;
- ✘ Procedura për rritjen e skemës kryesore të Shoqërisë, me investime përmes emetimit të aksioneve të reja nga emisioni i tretë përmes një oferte private;
- ✘ Realizimi i projektit për strehimin e grupeve në nevojë sociale, në lidhje me dinamikën, çmimin dhe afatet e emetimit të punimeve të ndërtimit.

7.12 MBIKËQYRJA E INSPEKTIMIT

7.12.1 KAPACITETET INSTITUCIONALE TË INSPEKTORËVE NË RMV

Duke pasur parasysh rëndësinë e funksionimit të sistemit efikas të inspektimit, zbatimi i papenguar i procesit të kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, veprimi parandalues, nevoja për të parandaluar dhe eliminuar parregullsitë dhe mangësitë në funksionimin e organeve, është kryer revizioni i suksesit të kapaciteteve institucionale të inspektorateve në RMV, me qëllim që të jepet përgjigje në pyetjen "A sigurojnë personeli, kapacitetet financiare, materiale dhe teknike të inspektorateve në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbikëqyrje efikase të inspektimit".

Shërbimet e inspektimit në RMV janë të organizuara si inspektorate shtetërore dhe janë organe të pavarura në përbërjen e ministrive, si njësi organizative në kuadër të organeve të administratës shtetërore ose si njësi organizative për mbikëqyrje inspektuese në përbërje të komunave. Vendorsja e shërbimeve të inspektimit dhe kryerja e mbikëqyrjes inspektuese është rregulluar me shumë ligje dhe akte nënligjore. Shërbimet e inspektimit kryejnë mbikëqyrjen në zbatimin e rreth 270 ligjeve dhe rregulloreve të tyre.

Në tetor 2013, u vendos korniza sistematike me të cilën u formua Këshilli i Inspektimit, me qëllim koordinimin e punës dhe reformave të mbikëqyrjes së inspektimit, si dhe për të siguruar pavarësinë e inspektorateve në menaxhimin e buxhetit, burimeve njerëzore dhe burimeve të tjera për funksionimin e inspektorateve.

Me revizionin e suksesit u përfshinë: Këshilli i Inspektimit, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Administratës, Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë, Inspektorati Shtetëror i Ndërtimtarisë dhe Urbanizmit, Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale, Inspektorati Shtetëror i Tregut dhe të gjitha inspektoratet e tjera të të dhënave të pyetësorit.

Lidhur me pjesën e kornizës strategjike dhe ligjore që zbatohet në punën e inspektorateve, konstatuam:

- ✘ nuk është miratuar strategjia për zhvillimin e shërbimeve të inspektimit në RMV;
- ✘ raportet vjetore për punën e shërbimeve të inspektimit nuk dorëzohen rregullisht te Këshilli i Inspektimit;
- ✘ evidentimi për numrat e licencave të lëshuara dhe aktive të inspektorëve nuk janë të plota dhe të sakta dhe
- ✘ nevoja për zbatimin e masave në Programin e Punës së Qeverisë së RMV-së për periudhën 2020 - 2024, në pjesën e shërbimeve të inspektimit.

Lidhur me pjesën e personelit, burimeve financiare, materiale dhe teknike me të cilat disponojnë inspektoratet, konstatuam:

- ✘ kuadër ekipues i pamjaftueshëm i Këshillit të Inspektimit dhe numër i pamjaftueshëm i inspektorëve në inspektoratet;

- ✘ mjetet financiare për zbatimin e detyrimeve ligjore të inspektorateve dhe të Këshillit të Inspektimit nuk janë të mjaftueshme;
- ✘ pajisjet teknike të pamjaftueshme, parashkrimi, skadimi dhe mosfunksionimi i pajisjeve të inspektorateve, që ndikon në cilësinë e kryerjes së mbikëqyrjes së inspektimit dhe
- ✘ nevoja për riorganizim dhe optimizim të shërbi-
meve të inspektimit.
- ✘ nevoja për vendosjen e sistemit për kontroll të brendshëm në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese;
- ✘ numri i pamjaftueshëm i trajnimeve për inspektorët me qëllim të rritjes së njohurive, aftësive, kompetencave të tyre;
- ✘ e gjithë procedura administrative e inspektimeve kryhet nga inspektorët.

Lidhur me pjesën / planifikimin dhe ekzekutimin e mbikëqyrjes së inspektimit nga inspektoratet, konstatuam:

- ✘ nevoja për zbatimin e metodologjive të miratuara për vlerësimin e rreziqeve gjatë planifikimit të subjekteve lëndë të mbikëqyrjes së inspektimit;
- ✘ nuk është vendosur sistemi i integruar i informacionit, me zgjidhje softuerike për shërbimet e inspektimit, e cila duhet të mundësojë lidhjen e të gjitha të dhënave në kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit;
- ✘ evidentimi jo i plotë dhe jo i azhurnuar i të dhënave të cilat rrjedhin nga realizimi i mbikëqyrjes së inspektimeve;

Për përmirësimin dhe avancimin e efikasitetit në funksionimin e inspektorateve në RMV, forcimin e personelit, kapacitetet financiare, materiale dhe teknike të inspektorateve, me qëllim krijimin e mbikëqyrjes efikase të inspektimit, nuk janë ndërmarrë të gjitha masat dhe aktivitetet e nevojshme nga institucionet kompetente në RMV, për të cilat kemi dhënë rekomandime, zbatimi i të cilave do të kontribuojë në avancimin e gjithë sistemit të inspektimit të vendit.

7.13 PARTITË POLITIKE DHE FUSHATA ZGJEDHORE

7.13.1 KOMISIONI SHETETËROR I ZGJEDHJEVE

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e raporteve financiare të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për vitin 2019, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë, duke përfshirë revizionin e fondeve të aprovuara për aktivitetet zgjedhore, zgjedhjet e zbatuara për President të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe zgjedhjet e parakohshme për kryetarët e komunave të Ohrit, Novo Sellës dhe Dibrës, 2019.

Me revizionin e kryer konstatuam gjendjen që ka të bëjë me punën e rregullt të KSHZ-së, si dhe aktivitetet e realizuara në lidhje me proceset zgjedhore, për të cilat është e nevojshme të merren masa dhe aktivitete për tejkalimin e tyre, si më poshtë:

- ✘ nuk është miratuar asnjë akt i cili do të përcaktojë standarde minimale për mjetet dhe pajisjet materiale dhe teknike, akomodimin hapësinor dhe burimet njerëzore për shkak të kryerjes së sigurt, të pandërprerë dhe ekonomike të kompetencave në lidhje me ruajtjen;
- ✘ mospërputhjet në mënyrën e përdorimit të hapësirave të magazinës që i përdor KSHZ-ja;
- ✘ veprimi i papërshtatshëm gjatë kryerjes së aktiviteteve të regjistrimit të mjeteve dhe burimeve të fondeve dhe miratimi i akteve për pranimin e tij;

- ✘ mungesa e dokumentacionit përkatës të plotë, të rregullt dhe të besueshëm për pagimin e shtesave për personat e përfshirë në procesin zgjedhor;
- ✘ pamundësia për të kryer krahasimin e të dhënave të futura nga Komisionet Komunale të Zgjedhjeve me të dhënat e theksuara nga vendimet për pagimin e shtesave për anëtarët e organeve zgjedhore, të cilat janë miratuar nga KSHZ-ja;
- ✘ gjatë mënyrës së llogaritjes së shtesava për personat e angazhuar në trupat ndihmëse dhe administratën zgjedhore, zbatohen kritere që nuk janë përcaktuar në mënyrë cilësore dhe të matshme dhe
- ✘ mospërputhjet gjatë veprimit në mënyrën e zbatimit të procedurave gjatë ndarjes së marrëveshjeve për furnizime publike për punën e rregullt dhe për zbatimin e procesit zgjedhor.

Në pjesën e çështjeve në lidhje me vazhdimësinë e punës së KSHZ-së, e zgjidhëm procedurën për furnizimin e ri publik dhe azhurnimin e zgjidhjeve ekzistuese softuerike, të cilat KSHZ-ja i ka zbatuar për nevojat e zbatimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2020 dhe të cilat mund të kenë implikime financiare dhe ndikim në punën e KSHZ-së në të ardhmen.

7.13.2 PARTITË POLITIKE - PUNA E RREGULLT

Enti Shtetëror i Revizionit, në përputhje me Ligjin për financimin e partive politike, është organ kompetent për revizionin e punëve të rregullta të partive politike, përmes sistemit të njoftimit financiar.

Duke filluar nga viti 2005, Enti Shtetëror i Revizionit kryen revizionin e punës së partive më të mëdha politike në RMV, gjegjësisht kryen revizionin e raporteve financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë, në përputhje me procedurat dhe metodologjinë për kryerjen e revizionit shtetëror.

Partitë politike, mjetet për punën e tyre i fitojnë në kushte dhe mënyra të përcaktuara me Ligjin për financimin e partive politike. Sipas ligjit të theksuar, partitë politike financohen nga:


- ✘ burimet publike të financimit, përkatësisht mjetet financiare të parapara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ✘ burimet private të financimit nga anëtarësia, kreditë, donacionet, dhuratat, kontributet, dotacionet, sponsorizimet, trashëgimitë, shitja e materialit promovues dhe propagandistik.

Fondet totale për financimin vjetor të partive politike janë në vlerë prej 0.15% të të ardhurave totale burimore të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat partitë politike mund t'i përdorin ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve të tyre të përcaktuara me ligj, statut dhe akte tjera të partisë.

Në vitin 2019, përmes ndarjeve të Ministrisë së Drejtësisë, te partitë politike për financimin vjetor të partive politike dhe për formimin e qendrave kërkimore-partiake janë paguar mjete në vlerë totale prej 315,334 mijë denarë. Këto fonde janë për 12.28% më shumë krahasuar me vitin 2018, e cila është rezultat i rritjes së të hyrave totale të burimeve të Buxhetit të RMV-së.

Me analizën e kryer të të hyrave sipas llojeve të burimeve të financimit të katër partive më të mëdha politike, konstatuam se vazhdon trendi i rritjes së pjesëmarrjes së të ardhurave nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me burimet private të financimit të partive politike, të paraqitur në grafikun vijues:

Të ardhurat e realizuara të partive politike nga anëtarësimet, donacionet dhe nga Buxheti i RMV-së



Me revizionet e kryera, konstatuam gjendje për të cilat organet kompetente të partive politike janë të nevojshme për të ndërmarrë aktivitete për tejkalimin e tyre, veçanërisht në pjesën e zbatimit të regjistrimit në përputhje me rregullativat ligjore, vendosjen e mënyrës së mbledhjes, pagesës dhe evidentimit të të ardhurave në bazë të anëtarësisë për shkak të konfirmimit të plotë të së njëjtës, si dhe evidentimin e plotë të pronës me të cilat disponojnë partitë.

Gjithashtu, me revizionet e kryera në vazhdimësi, theksojmë se sistemi i dobësive të caktuara të Ligjit për financimin e partive politike, të paraqitura në detaje në pjesën e "Dobësitë sistemike" të këtij raporti dhe për të cilat është e nevojshme të ndërmerren masa për tejkalimin e tyre.

7.13.3 PARTITË POLITIKE - FUSHATA ZGJEDHORE

Enti Shtetëror i Revizionit është përgjegjës për monitorimin e financimit të fushatës zgjedhore përmes sistemit të raportimit financiar të vendosur nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore, në përputhje me metodologjinë e përshkruar në pajtim me Ligjin për revizion shtetëror dhe standardet ndërkombëtare të revizionit.


Në vitin 2020, të pesëmbëdhjetë (15) pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Deputet në Kuvendin e RMV-së, të mbajtura në korrik 2020, u reviduan.

Me revizionin e kryer u konstatuan gjendjet e zbatimit jokonsistent të afateve për njoftim dhe mbylljen e llogarive të transaksioneve, të parapara në Kodin Zgjedhor, financimin e fushatës zgjedhore me fonde nga burime të paparashikuara për financimin e fushatës zgjedhore, si dhe dokumentacionin përkatës të plotë të pasiguruar për pjesën nga faturat për shpenzimet e bëra.

Në pajtim me Kodin Zgjedhor, fushata zgjedhore u financua me mjete nga Buxheti i RMV-së, nga anëtarësia e partive politike, donacionet e partisë politike, donacionet nga personat fizikë në vlerë prej 3,000 euro në kundërvlerë të denarit, personat juridikë në shuma prej 30,000 euro në kundërvlerë të denarit dhe kreditë për partitë politike të destinuara për fushatën zgjedhore.

Nga analizat e kryera të burimeve totale të financimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020, konstatuam se ajo është financuar në shumën totale prej 317,772 mijë denarë, dhe struktura e burimeve të financimit nga pjesëmarrësit tregohet në grafikun më poshtë.


ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARË PËR DEPUTET NË KUVENDIN E RMV-SË 2020



Me analizën e të ardhurave sipas llojeve të burimeve të financimit, konstatuam se fushata zgjedhore financohet me 62% me mjete nga Buxheti i RMV-së, ndërsa 38% janë të hyra nga burime të tjera të financimit.


Mjetet financiare për reklamimin politik me pagesë janë siguruar nga Buxheti i RMV-së, gjatë procesit zgjedhor që i paguan Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Për fushatën zgjedhore në vitin 2020, mjetet janë paguar në vlerë totale prej 196,358 mijë denarë, veçmas nga pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, të treguar në grafikun më poshtë.

Mjete të paguara nga Buxheti i RMV-së për reklamimin politik me pagesë për Zgjedhjet Parlamentare 2020



Nga mjetet e përgjithshme financiare për reklamimin politik me pagesë janë siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 85.86% u janë paguar tre partive më të mëdha politike nga pozita dhe opozita, ndërsa 14.14% për 12 pjesëmarrësit tjerë në procesin zgjedhor të cilët në zgjedhjet e fundit parlamentare nuk fituan mjaft deputetë për të formuar grup parlamentar, si dhe për partitë politike / kandidatët të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, me revizionet e kryera në vazhdimësi, sugjerojmë se dobësitë e sistemit të caktuar të Kodit Zgjedhor të paraqitura në detaje në pjesën e "Dobësitë sistemike" të këtij raporti dhe për të cilat është e nevojshme të ndërmerren masa për tejkalimin e tyre.



8 DOBËSITË E SISTEMIT

Ne, punonjësit në Entin Shtetëror të Revizionit, duke kryer kompetencat e përcaktuara me ligj dhe standardet për ISR, vlerësojmë vazhdimisht, ndër të tjera, shkallën e përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore dhe nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e tyre. Në këtë seksion ne nxjerrim në pah dobësitë sistematike për të cilat ekziston nevoja për të ndërmarrë veprime nga autoritetet kompetente të pushtetit ekzekutiv / legjislativ për t'i tejkaluar ato.

Rregullativa	Propozimi për ndryshim / miratim
Ligji për transformim në marrëdhënie të rregullt pune	Në përputhje me nenet 8 dhe 9 - të Ligjit për transformim në marrëdhënie të rregullt pune, institucionet mund të punësojnë persona në bazë të kontratës për kryerjen e punës fizike ose intelektuale, më shumë se 1% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në fund të vitit të kaluar, për periudhë më të gjatë se 24 muaj, bazuar në pëlqimin e marrë nga Ministria e Financave. Në këtë mënyrë, nuk përcaktohet përqindja maksimale e personave që mund të punësohen, për shkak të së cilave subjektet lejohen të punësojnë persona me kontratë pune mbi maksimumin e përcaktuar ligjërisht, gjë që vë në pikëpyetje arsyetimin e miratimit të Ligjit për transformim në marrëdhënie të rregullt pune.
LIGJI PËR EVIDENTIMIN E LIBRAVE TË GJENDJES CIVILE	Është e nevojshme të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për evidentimin e librave të gjendjes civile për shkak të gjendjes si vijon: <ul style="list-style-type: none">- nuk parashihen dispozita për mënyrën e përcaktimit të shumës së kompensimeve për certifikatat e lëshuara dhe shërbimet e tjera të kryera nga Drejtoria dhe- afati për lëshimin e dokumenteve të kërkuara nga Drejtoria nuk është përcaktuar, që krijon rrezik të lëshimit në kohë të qytetarëve të dokumenteve dhe plotësimin e nevojës për të cilën është paraqitur kërkesa. Për shkak të situatës së krijuar, Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë në bashkëpunim me ministrinë kompetente duhet të ndërmarrë aktivitete për të tejkaluar dobësinë sistematike të konstatuar.

Kodi Zgjedhor

Të rishqyrtojë dhe qartësojë dispozitat e nenit 83 paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me fonde nga llogaria e rregullt e partisë politike dhe nga donacionet nga një parti politike, në pjesën e limiteve individuale dhe totale të mjeteve të financuara / dhuruara nga personat fizikë dhe juridikë.

Me ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Zgjedhor në vitin 2018, neni 71 u ndryshua, i cili shtoi mundësinë e depozitimit të fondeve në llogarinë e transaksionit për fushatën zgjedhore nga llogaria e partisë politike për punë të rregullta dhe nga llogaritë speciale për fondet e siguruara nga kredia, për shkak të së cilës është e nevojshme të ndryshohet dhe plotësohet neni 26 i Ligjit për financimin e partive politike, i cili do të rregullojë transferimin e fondeve nga llogaria për funksionimin e rregullt të partisë dhe nga llogaritë speciale për fondet e siguruara përmes kreditit për llogarinë e transaksionit të hapur për procesin zgjedhor.

Të rregullojë mënyrën në të cilën donatorët do të dëshmojnë / konfirmojnë se ata nuk janë "persona të lidhur" të parashikuar në nenin 75, me radiodifuzer, mediat e shkruara dhe mediat elektronike (portalet e internetit) gjatë financimit ose dhënies së donacioneve për partitë politike.

Rregullativa ligjore e dispozitave të nenit 85 të Kodit Zgjedhor, në pjesën e mënyrës së veprimit për rastet kur në Raportin e Plotë Financiar tregohen fondet e tepërta të mbledhura në llogari për fushatën zgjedhore, si dhe kur ekziston mungesa e fondeve për financim dhe tregohen më shumë shpenzime se të ardhurat, d.m.th. ka detyrime të papaguara.

Ekziston nevoja për përcaktimin e kriterëve të qarta dhe të sakta që do të zbatohen gjatë shpërndarjes të fondeve për reklama politike të paguara të financuara nga Buxheti i RMV-së dhe ata midis dy partive më të mëdha politike në pozitë, opozitës si dhe partive që nuk fituan mjaft deputetë për të formuar grup parlamentar ose nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e RMV-së.

Përcaktimi i detyrimit për dorëzimin e raportit për reklamat dhe billboardet e përdorura nga komunat në RMV dhe Qytetin e Shkupit.

Të ndërmerren aktivitetet për rregullimin e mëtejshëm të Kodit Zgjedhor në pjesën e përcaktimit të organit kompetent për monitorimin dhe raportimin për prezantimin mediatik zgjedhor të mediave elektronike (portalet në internet).

Rregullimi i mënyrës së organizimit, pagimit, monitorimit dhe raportimit tek autoritetet kompetente për prezantimin në internet të bërë nga pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore përmes rrjeteve sociale.

Rregullativa	Propozimi për ndryshim / miratim
Kodi Zgjedhor	<p>Për të rishqyrtuar afatin e caktuar për pagimin e donacioneve, d.m.th. është e nevojshme të përcaktohet donacionet që do të paguhen jo më vonë se dita e përfundimit të fushatës zgjedhore.</p> <p>Rregullimi i nenit 84-b, paragrafi 8 i Kodit Zgjedhor me të cilën do t'i mundësojë Ministrisë së Financave me akt nënligjor të rregullojë mënyrën e mbajtjes së librave afariste dhe përgatitjen e raportit financiar / financimet për fushatën zgjedhore, duke pasur parasysh të gjitha llojet / burimet e financimit të fushatës zgjedhore, veçanërisht kur ato jo gjithmonë shkaktojnë të hyra me para në llogarinë e transaksionit.</p> <p>Rregullimi i Kodit Zgjedhor, me çka në pjesën e gjobave dhe dispozitave të kundërvajtjes do të sigurojë gjoba edhe për mediat elektronike (portalet elektronike) në rast të mosparaqitjes së Raportit mbi hapësirën e reklamave të përdorura nga secili pjesëmarrës në fushatën zgjedhore dhe fondeve të cilat janë paguar dhe kërkojnë me atë qëllim.</p> <p>Rregullimi nomoteknik i Kodit Zgjedhor meqë disa nene nuk kanë rend dhe dispozitat e disa neneve kanë referencë të gabuar.</p> <p>Kuvendi i RMV-së të detyrojë Komisionin Juridik Ligjvënës të përcaktojë tekst të konsoliduar të Kodit Zgjedhor dhe ta harmonizojë atë terminologjikisht me Kushtetutën dhe me sistemin juridik.</p> <p>Për shkak të burimeve të mëdha njerëzore dhe financiare të nevojshme për të kryer zgjedhjet në DCO, pavarësisht pjesëmarrjes së parëndësishme të qytetarëve të cilët përkohësisht punojnë ose qëndrojnë jashtë vendit gjatë zgjedhjeve, është e nevojshme të rishqyrtohen dispozitat e Kodit Zgjedhor që rregullojnë kushtet dhe mënyrën e votimit në diasporë në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet e shtetit për organizimin e zgjedhjeve dhe krijimin e mënyrës së përshtatshme të ushtrimit të së drejtës kushtetuese për të votuar qytetarët të cilët përkohësisht punojnë ose banojnë jashtë vendit gjatë zgjedhjeve.</p>
Ligji për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse	<p>Është e nevojshme të ndërmerren aktivitete për ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore me të cilat rregullohet mënyra e udhëheqjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse, me të cilat do të sigurojnë respektim të qëndrueshme të parimit të kontabilitetit të "ndodhjes së modifikuar të ndryshimeve afariste, respektivisht transaksioneve".</p>
Ligji për financimin e partive politike	<p>Të miratojë udhëzime më specifike për rregullimin e mënyrës së pagesës, evidentimin dhe pagesën e anëtarësisë si burim i financimit të partive politike me qëllim të njëtrajtshmërisë në mënyrën e evidentimit të tyre të kontabilitetit dhe konfirmimin e limitit të përcaktuar ligjërisht për secilin anëtar veç e veç, duke pasur parasysh financimin e fushatës zgjedhore për një proces të caktuar</p>

Rregullativa

Propozimi për ndryshim / miratim

Ligji për të punësuarit në sektorin publik

Në pajtim me nenin 14 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, sektori publik në RMV, përbëhet nga punonjës që kanë statusin e nëpunësve administrativë, si dhe punonjës që kanë statusin e personave ndihmës - teknikë. Në pajtim me të, për punonjësit në sektorin publik zbatohen dispozitat nga ky ligj, dispozitat e ligjeve të veçanta, rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji dhe ligjet e veçanta dhe marrëveshjet kolektive. Shuma e pagave dhe shtesave tjera të nëpunësve administrativë përcaktohen në përputhje me Ligjin për nëpunës administrativë, ndërsa për personat që kryejnë punë teknike dhe ndihmëse, të shpërndarë në grupe, nëngrupe të inkuorpuara në aktin e sistematizimit, nuk ka ndonjë dispozitë që rregullon metodën e llogaritjes së pagave.

Mungesa e dispozitave për përcaktimin e pagave të punonjësve që kryejnë punë teknike dhe mbështetëse shkakton shumëllojshmëri në llogaritjen dhe shumën e pagave të kësaj kategorie të punonjësve.

Në Gjykatën Kushtetuese të RMV-së, llogaritja e pagës për këtë kategori të punonjësve është rregulluar me kontratat e lidhura për punësime përmes përcaktimit të numrit të pikëve për vendin e punës përkatës. Shuma e vlerës së pikës në vitin 2019 është përcaktuar nga Vendimi për përcaktimin e vlerës së pikës për pagat e punëtorëve ndihmës nga Sekretari i Përgjithshëm, sipas të cilit vlera e pikës për llogaritjen e pagës përcaktohet në shumën e vlerës së nëpunësit administrativ.

Për tejkalimin e gjendjes së konstatuar organet e administratës shtetërore në bashkëpunim me ministrinë kompetente duhet të ndërmarrin aktivitete për të filluar ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe aktet nënligjore dhe për të përcaktuar kriteret për llogaritjen e pagës së punonjësve që kryejnë punë teknike dhe ndihmëse.

Ligji për veprim me objektet të ndërtuara pa leje

Nevoja për të miratuar ligj të ri paraqitet për shkak të efekteve që nuk ishin arritur me Ligjin e mëparshëm. Ndryshimet e shpeshta të Ligjit për veprim me objekte të ndërtuara pa leje, veçanërisht në pjesën e mundësisë së dhënë për paraqitjen e kërkesave jo të plota, si dhe incizimin ajror fotogrametrik jo të kryer të hapësirës në të gjithë territorin e vendit, mungesa e koordinimit ndërmjet komisioneve dhe inspektorëve të ndërtimit dhe asnjë veprim i inspektorëve lokalë të ndërtimit çon në shfaqjen e ndërtimit të objekteve të reja ose zgjerimeve dhe përmirësimeve të objekteve pa leje ndërtimi për të cilat ekziston rreziku i legalizimit të tyre në shumë aspekte dhe janë ndërtuar pas miratimit të Ligjit.

Rregullativa	Propozimi për ndryshim / miratim
Ligji për komunikim elektronik	<p>Me revizionin e kryer të AEK-ut, revizioni konstaton nevojën për të shqyrtuar nenin 29-a të Ligjit për komunikime elektronike, sipas të cilit Agjencia është e detyruar të transferojë një pjesë të fondeve të realizuara nga të hyrat nga tarifatat si mjete të destinuara për financim e veprimtarisë së OTA-së, në mënyrë që të sigurojë burime të përshtatshme financiare, njerëzore dhe teknike për zbatimin e kompetencave të saj, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 50% e të ardhurave totale të realizuara që Agjencia i ka realizuar për vitin e kaluar kalendarik nga të ardhurat nga kompensimet vjetore që operatorët paguajnë për mbikëqyrjen e tregut dhe - 10% e të ardhurave totale të realizuara që Agjencia realizoi për vitin e kaluar kalendarik nga të ardhurat nga kompensimet vjetore për përdorimin e radiofrekuencave nga mbajtësit e aprovimeve për përdorimin e radiofrekuencave. <p>Duke pasur parasysh që Agjencia përdor si bazë për llogaritjen e pjesës së të ardhurave që u referohet vetëm kërkesave të arkëtuara nga rrjedha, ndërsa jo dhe nga vitet e mëparshme, revizioni është i mendimit se është e nevojshme të rregullohet qartë mënyra e shpërndarjes së pjesës së të ardhurave që do të dedikohet për financimin e OTA-së.</p> <p>AKE-ja është organ kompetent për kundërvajtje për kundërvajtjet e caktuara në nenin 182 deri 185 të Ligjit për komunikime elektronike. Në bazë të nenit 183 të LKE-së, i cili nëse personi juridik ose tregtari i vetëm nuk i përmbush detyrimet në lidhje me pagimin e kompensimeve brenda afateve ose shumave të përcaktuara ligjërisht, për kundërvajtje parashikohet gjobë në vlerë prej 10,000 euro në kundërvlerë me denarë.</p> <p>Duke pasur parasysh që shumica e të ardhurave të realizuara nga operatorët, si dhe fondet që ata paguajnë për Agjencinë ndryshojnë në varësi të madhësisë së operatorëve, revizioni konsideron se gjoba e përcaktuar në këtë mënyrë nuk është proporcionale me shumën e kundërvajtjes. Prandaj, ka nevojë që ligjvënësi të rishqyrtojë gjobën në fjalë, në drejtim të harmonizimit të tij me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.</p>
Ligji për Byronë e zhvillimit të arsimit	<p>Në nenin 14 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit përcakton detyrimin e Byrosë për vendosjen e sistemit të informacionit dhe bazës së të dhënave për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm, arsimin special, arsimin për nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimin e të rriturve.</p> <p>Duke pasur parasysh rëndësinë e sistemit të informacionit për sigurimin e të dhënave në fushën e arsimit dhe kontributin e tij në përmirësimin e sistemit arsimor në vend, revizioni tregon nevojën për të ndërmarrë aktivitete për t'i definuar qartë përmbajtjen e tij, mënyrën e mbledhjes, futjes, përdorimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe të dhënave me institucionet kompetente, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin dhe avancimin e të gjithë veprimtarisë edukative-arsimor në RMV.</p>

Rregullativa	Propozimi për ndryshim / miratim
Ligji për tatim mbi vlerën e shtuar	Ligji për tatim mbi vlerën e shtuar nuk rregullon përjashtimin e TVSH-së në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve, dhe as Ministri i Financave ka miratuar akt nënligjor për mënyrën e veprimit gjatë tatimit me tatim mbi vlerën e shtuar të qarkullimit të fletëve të votimit dhe materialit zgjedhor të nevojshëm për zbatimin e zgjedhjeve, duke pasur parasysh faktin se fondet sigurohen plotësisht nga Buxheti i RMV-së.
Ligji për shërbim gjyqësor dhe Ligji për pagat e gjykatësve	<p>✘ Me Ligjin për shërbim gjyqësor është konstatuar se puna e mëparshme vlerësohet në shumën prej 0.5% në pjesën e pagës bazë që vlerëson arsimin dhe shtesën e pagës për titullin, për çdo vit të kryer të përvojës së punës, ndërsa më së shumti deri në 20%, ndërsa në Ligjin për pagat e gjykatësve vlerësohet me çdo vit të filluar.</p> <p>E theksuara shkakton rregullim të ndryshëm të të drejtave të njëjta të punonjësve në të njëjtin institucion, për shkak të të cilave është e nevojshme të ndërmerren masa për barazimin e këtyre dispozitave ligjore.</p> <p>✘ Me dispozitat e këtyre ligjeve rregullohen në mënyrë të ndryshme të drejtat e caktuara të gjykatësve dhe nëpunësve të gjykatave. Gjegjësisht, shuma maksimale që gjykatësit mund të arrijnë për shtesa për kushte të veçanta të punës, ekzistencës së rrezikut të lartë dhe konfidencialitetit është 35% e pagës bazë të gjykatësve, ndërsa për të njëjtat shtesa nëpunësit e gjykatës mund të arrijnë 25% të pagës bazë.</p> <p>Revizioni konsideron se ekziston nevoja për të rishqyrtuar zgjidhjet ligjore në lidhje me harmonizimin e tyre në mënyrë që të barazohen të drejtat e punonjësve në përputhje me Kushtetutën e RMV-së.</p>

Rregullativa	Propozimi për ndryshim / miratim
Ligji për gjyqë dhe Ligji për shërbim gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ✘ Në pajtim me dispozitat e këtyre ligjeve, shërbimi gjyqësor përbëhet nga nëpunësit gjyqësorë, personat e punësuar në gjykata që kryejnë punë teknike dhe ndihmëse dhe policia gjyqësore. ✘ Neni 3 paragrafi 2 i Ligjit për shërbim gjyqësor është rregulluar se punonjësit në gjykata që kryejnë punë teknike dhe ndihmëse nuk kanë statusin e nëpunësit gjyqësor dhe Ligji për nëpunësit në sektorin publik dhe rregulloret e përgjithshme për marrëdhëniet e punës zbatohen për ta. Shuma e pagave dhe shtesave të tjera të nëpunësve gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave përcaktohet me ligj dhe me marrëveshje kolektive në përputhje me nenin 109 të Ligjit për gjykata. ✘ Sistemi i pagës dhe kompensimeve të pagës të nëpunësve gjyqësorë përcaktohet nga dispozitat e Ligjit për shërbim gjyqësor. ✘ Në bazë të nenit 78 të Ligjit për shërbim gjyqësor, përcaktohet që pagat e punonjësve që kryejnë punë teknike dhe ndihmëse në gjykata janë në kuadër të pagave të përcaktuara për nëpunësit e gjykatës administrativo-teknike në varësi të nivelit të arsimit, vendit të punës në të cilën caktohen, në pajtim me aktet për sistematizimin dhe përvojën e punës, pa rregulluar mënyrën e përcaktimit të pagave të kësaj kategorie të të punësuarve. ✘ Mungesa e dispozitave për përcaktimin e pagave të punonjësve në gjykatat që kryejnë punë teknike dhe ndihmëse, shkakton shumëllojshmëri në llogaritjen dhe shumën e pagave të kësaj kategorie të punonjësve.
Ligji për organizimin e organeve të administratës shtetërore	<p>Në vitin 2004, për kryerjen e veprimtarive administrative, profesionale dhe aktiviteteve të tjera në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e themeloi Drejtorinë si organ në përbërje të Ministrisë së Kulturës. Puna e Drejtorisë është rregulluar me nenin 144, 144-a, 144-b, 144-c dhe me nenin 145 të ligjit. Në Ligjin për organizimin e organeve të administratës shtetërore, Drejtoria nuk është paraparë si organ në përbërjen e ministrisë, për shkak të së cilës ka përplasje të Ligjit për organizimin e organeve të administratës shtetërore me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.</p>
